

AUTORITETI I MEDIJE AUDIOVIZIVNE

RAPORT VJETOR 2019

Mars 2020

Tabela e lendes

1	MESAZHI I KRYETARIT.....	4
2	HYRJE.....	8
3	Këshilli i Ankesave	12
4	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT PËR VITIN 2018.....	13
5	STRATEGJIA E AUTORITETIT.....	26
6	MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT	29
6.1	Auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit "Mbi performancën e internetit në Administratën Publike ..	29
6.2	Rekomandime nga Komisionieri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	29
7	REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT.....	30
7.1	PROGRES RAPORTI	30
7.2	Raportime të tjera	31
8	KËSHILLI I ANKESAVE.....	32
8.1	Veprimtaria e KA	32
8.2	Shqyrtimi i ankesave	33
8.3	Gjuha e shenjave në transmetimet audiovizive	35
9	AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR TREGUN AUDIO/AUDIOVIZIV	36
9.1	Autoriteti në përmbushje të zbatueshmërisë ligjore	36
9.2	Analizimi dhe monitorimi i përmbajtjeve audio/audiovizive	Error! Bookmark not defined.
	Pasqyrimi i fushatës zgjedhore - Qershor 2019	48
9.3	Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave	53
9.4	Mbikqyrja e tregut audio/audiovizivë	59
9.5	Autoriteti si nxitës i zhvillimit të sektorit audio/audioviziv	66
10	DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE	69
10.1	Administrimi i procesit të kalimit në transmetimet numerike.....	69
10.2	Mbështetje nga projekti i Bankës Botërore	71
10.3	Fushata e informimit të publikut.....	74
10.4	Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit	74
11	Autoriteti në përmbushje të transparencës dhe rritjes së imazhit institucional	78
11.1	Organizimi i brendshëm i institucionit.....	78
11.2	Programi i transparencës	79
11.3	Botime të autoritetit.....	81
11.4	Bashkëpunimi me institucionet dhe partnerët	82
11.5	Menaxhimi i performances së burimeve njerëzore	85

12	Treguesit financiarë dhe menaxhimi i burimeve	86
12.1	Realizmi i burimeve të financimit në vitin 2019	87
	Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetfinancimit për “Të Ardhurat korente të periudhës” dhe “Të ardhura nga debitorët e vitit kaluar”	87
12.2	Detyrimet financiare të OSHMA-ve	89
12.3	Financime nga Buxheti i Shtetit	92
12.4	Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2019	92
	Shpenzimet dhe investimet të mbuluara me vetfinancim:	92
12.5	Ecuria e Investimeve:	93
12.6	Pasqyrat financiare	94
13	Anekse.....	96

1 MESAZHI I KRYETARIT

**I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar të Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë**

Duke bërë bilancin faktik për vitin 2019, njëkohësisht jemi dhe në kushtet e përfundimit të një mandati 5 vjeçar – një periudhë kohore skanimi i së cilës na krijon një tablo më të qartë dhe të kuptueshme mbi dinamikën e një institucioni rregullator, si AMA.

-Mjafton të kujtojmë se në fund të vitit 2014 tregun audioviziv e kemi gjetur në një situatë kaotike dhe të parregulluar. Numri i subjekteve që ushtronin veprimtari pa licensën përkatëse nga autoriteti ishte i lartë, duke favorizuar kështu fenomenin e konkurrencës së pandershme. Mosrespektimi i ligjit dhe mungesa e vullnetit kishin sjellë problematika në funksionimin e tregut audio dhe audioviziv. Kjo reflektohej edhe në Raport Progreset për Shqipërinë të përgatitura nga Komisioni Evropian dhe rekomandimet përkatëse.

-Transmetime televizive numerike të paautorizuara kanë ofruar 9 operatorë, duke përdorur në total 16 kanale frekuencore. E thënë thjesht, kjo do të thotë 16 kanale të zëna në mënyrë të jashtëligjshme, për të cilat operatorët nuk kryenin asnjë detyrim financiar ndaj AMA-s dhe rrjedhimisht në buxhetin e shtetit. Gjithashtu kanë ofruar transmetime në mënyrë të jashtëligjshme edhe 8 operatorë të cilët transmetonin në analog. Tashmë në fund të mandatit, nuk ka asnjë operatorë në treg që përdor frekuenca në mënyrë të jashtëligjshme dhe të gjithë operatorët shlyejnë detyrimet financiare konform ligjit.

-Gjatë periudhës 2014-2019 u bë i mundur zbatimi i plotë i dispozitave të ligjit organik, përmes miratimit të legjislacionit sekondar, duke përmbushur plotësisht detyrimet që burojnë prej ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Është kryer finalizimi i procedimeve administrative për rinovimin e licencave dhe autorizimeve të mbetura pezull prej vitit 2013, për shkak të mungesës së kuadrit të nevojshëm nënligjor. Deri në fund të vitit 2014, rreth 70 subjekte tv/radio ushtronin aktivitet pa vendim të organit kolegjal mbi rinovimin e licencës së tyre, situatë e cila mori zgjidhje në fillim të muajit shkurt 2015, me miratimin e aktit të nevojshëm nënligjor.

-Në fund të vitit 2014, numri i subjekteve të pajisur me autorizim për shërbim progami kabllor ka qenë 109, shumica e të cilëve ushtronin veprimtari duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi. Për shkak të mungesës së një politike të autoritetit, në këtë periudhë ka patur rritje pa kriter të numrit të subjekteve të pajisur me licencë për veprimtari kabllore, mungesë efektive të kontrollit të kushteve të licencës/autorizimit nga subjektet e fushës. Prej vitit 2015 e në vijim, autoriteti ka ndërmarrë një sërë

veprimesh për rregullimin aktivitetit të operatorëve kabllorë: duke rritur/intensifikuar kontrollet në terren; duke përmirësuar dhe rishikuar kuadrin nënligjor për aktivitetin e subjekteve kabllorë; duke rishikuar periodikisht kriteret për marrjen e autorizimit për këtë shërbim, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit kabllor; nga digjitalizimi i shërbimeve kabllore, që ndikojnë në cilësinë e transmetimit dhe gamën e gjerë të shërbimeve që ofron kjo teknologji.

-Në vitin 2014, pranë Autoritetit mbërritën vetëm 4 ankesa, ndërkohë që nga 2016 dhe në vijim, Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe u ka dhënë përgjigje, sipas standardit ligjor rreth 190 ankesave, duke u tërhequr vëmendjen operatorëve për më shumë se 70 raste të evidentuara si shkelje dhe mosrespektim të ligjit. Këshilli i Ankesave ka intensifikuar bashkëpunimin me organizata të ndryshme dhe aktorë të shoqërisë, por edhe me operatorët audiovizive, në përpjekje për t'i sensibilizuar ata për adresimin e shkeljeve të normave ligjore dhe etike në transmetimet audiovizive, ashtu si dhe sensibilizimin e vetë OSHMA-ve për të zbatuar ligjin për mediat audiovizive dhe Kodin e Transmetimit. Këshilli ka rritur bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe ka organizuar aktivitete dhe tryeza diskutimi të përbashkëta me Grupin e Deputetëve "Miq të Fëmijëve", me organizata të ndryshme të shoqërisë civile që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti, mbrojtjen e të drejtave të të miturve. Falë nxitjes nga Këshilli i Ankesave është bërë e mundur ngritja e bordeve profesionale brenda vetë televizioneve kombëtare dhe rajonale për trajtimin e ankesave.

-Në zbatim të detyrimit ligjor për mbikëqyrjen e tregut, AMA ka rritur kapacitetet e saj të monitorimit të programeve. Nëse në vitin 2014 monitoroheshin vetëm 14 subjekte audiovizive tashmë monitorohen 48 subjekte. Kjo ka ndikuar dhe në zgjerimin e monitorimit të mbulimit të fushatave elektorale nga operatorët audio dhe audiovizivë, sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor të vendit tonë. Po ashtu ky shërbim është vënë në dispozicion të shumë kërkesave të vazhdueshme nga individë apo institucione, duke bërë të mundur zgjidhjen e shumë konflikteve gjyqësore.

-AMA ka ndërtuar dhe forcuar partneritetin me disa institucione publike, akademike dhe shoqërinë civile, një praktikë e panjohur deri në 2014, në sinergji për realizimin e projekteve që fokusohen në tri drejtime bazike: studime dhe analiza të tregut audioviziv; trajnime dhe kualifikime të redaksive audiovizive për përmirësimin e raportimit; si dhe për përkthimin në shqip të literaturës së huaj mbi këtë fushë. Ndër partnerët më të rëndësishëm konsiderojmë Departamentin e Gazetarisë dhe të Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Janë rreth 650 gazetarë, reporterë, redaktorë dhe bashkëpunëtorë nga redaksitë audiovizive, si dhe studentë nga Departamenti i Gazetarisë që janë përfshirë në periudhën 2015 – 2019 në trajnime dhe workshope. Mbi 60% e tyre janë nga redaksitë audiovizive në rrethe.

-AMA në 5 vitet e fundit ka intensifikuar më shumë bashkëpunimin me institucioneve të tjera publike. Koordinimi dhe bashkëveprimi i AMA-s me këto institucione ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e standardeve dhe kushteve për një treg audioviziv të lirë

dhe efektiv, sipas përvojës evropiane. Autoriteti ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione: Ministria e Kulturës (Drejtoria e të Drejtave të Autorit); Autoriteti i Konkurrencës; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave; Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve; Inspektoriati Shtetëror i Punës si dhe me institucionin e Avokatit të Popullit.

-Deri në vitin 2014 AMA nuk publikonte të dhëna periodike mbi performancën e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë, përveç një liste të subjekteve audio dhe audiovizive të licencuar me kontaktet e tyre. Nga viti 2016 AMA, publikon periodikisht buletin periodik, në faqen web dhe në formë të shtypur, i cili përmban një set treguesish (ekonomiko-financiar, tekniko-teknologjikë, burimet njerëzore të angazhuara, aspekte pronësore, përmbajtësore), duke ndikuar kështu edhe në rritjen e transparencës së institucionit dhe subjekteve audiovizive. Një seksion i vecantë në Buletin Periodik të AMA-s i kushtohet edhe angazhimeve fitimprurëse të subjekteve mediatikë në aktivitete të tjera tregtare.

-AMA si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve ka qenë një ndër objektivat e realizuara përgjatë 5 viteve të fundit. Nëse në vitin 2014 të ardhurat vjetore ishin rreth 62 milion lekë, një vit më pas niveli u dyfishua, në rreth 112 milion lekë.

Rritja gjatë këtij 5 vjeçari ka qenë e qëndrueshme: Në vitin 2016 ishte 140 milion lekë; në 2017 ishte 157 lekë; në 2018 ishte 177 milion dhe vitin e kaluar arriti në 183 milion lekë. Përmes një investimi me fondet e veta, AMA në vitet 2016 -2017 ndërtoi një godinë me kushte funksionale dhe bashkëkohore, ku është instaluar një infrastrukturë teknike moderne në përmbushje të funksioneve të saj.

-Një ndër arritjet kryesore të AMA-s për periudhën 5 vjeçare, ka qenë diversifikimi dhe rritja e konkurrencës ndërmjet operatorëve prodhues të kontentit audioviziv në Shqipëri. Në vitet e mëparshme kishim vetëm dy kompani (Digitalb dhe Tring), që prodhonin dhe shpërndanin kontent televiziv në vendin tonë. Kjo sillte si pasojë reduktimin e mundësive dhe të përzgjedhjes së programacionit nga ndjekësit. AMA përmes dhënies së 5 licensave kombëtare televizive, si dhe hartimit të rregulloreve të ndryshme gjatë këtyre viteve, ka bërë të mundur që operatorë të tjerë të hyjnë në tregun audioviziv. Shtimi i këtyre operatorëve ka sjellë rritjen e numërit të programeve, gjë që ju ka mundësuar shikuesve mundësi përzgjedhjeje të operatorëve në tregun audioviziv. Në vitin 2019 numri i operatorëve që prodhojnë dhe shpërndajnë kontent televiziv është 6: (Tring, Digitalb, RTSH, Abcom, Klan dhe RTL). Kjo larmishmëri programesh, lejon publikun të ketë një gamë më të madhe zgjedhjeje në programe, si dhe rrit konkurrencën në treg, duke i ardhur në ndihmë qytetarëve të kenë larmishmëri zgjedhjeje si dhe kosto më të favorshme.

-Kalimi nga sinjali analog në atë digjital ka bërë të mundur që numri i kanaleve falas të rritet në mënyrë të ndjeshme. Në secilin nga allotmentet ku ka përfunduar

digjitalizimi ka pasur dyfishim të numrit të kanaleve.
Kështu:

ALLOTMENTI	SINJAL ANALOG	SINJAL DIGJITAL
KORÇË	12 PROGRAME	34 PROGRAME
FIER	15 PROGRAME	31 PROGRAME
BERAT	8 PROGRAME	32 PROGRAME
TIRANË-DURRËS	21 PROGRAME	39 PROGRAME

Kjo situatë ka bërë të mundur që qytetarët të kenë një shërbim më cilësor të figurës dhe zërit në pajisjet e tyre.

-Në shkurt të vitit 2018 u realizua lirimi i brezit DD1, duke bërë të mundur përdorimin e tij për shërbimet mobile të internetit me shpejtësi të lartë, si një kërkesë në rritje e qytetarëve në mbarë botën. Ky brez okupohej tërësisht nga operatorët ekzistues analog dhe operatorët e palicencuar që ofronin transmetime numerike. Mbas një procesi intensiv koordinimi me operatorët audiovizive si dhe me autoritetet homologe të vendeve fqinje është arritur eliminimi i interferencave në brezin audio dhe audioviziv.

-Për herë të parë, AMA, hartoi një dokument strategjik ku përcaktoi objektivat dhe prioritetet për periudhën 2017 – 2019. Dokumenti përcaktoi objektivat strategjike në përmbushje të funksioneve, misionit, vizionit dhe vlerave që formësojnë AMA-n , si dhe informojnë qasjen ndaj funksionit të saj rregullator.

Hartimi i këtij dokumenti strategjik u krye dhe me ekspertizën e ofruar nga Këshilli i Evropës.

Qëllimet strategjike kryesore ishin:

- Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
- Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies
- Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm
- Përforcimi i mirëqeverisjes dhe zhvillimi i Autoritetit

-Me përmbushjen e objektivave të caktuar, gjetën zgjidhje shumë procese të rëndësishme të lidhur me mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut audioviziv. Kjo mundësoi që në hartimin e strategjisë për vitet 2020 – 2022 fokus të veçantë të marrin procese që lidhen më shumë me aspektet cilësore të rregullimit të tregut si:

- Përmirësimi i inovacionit dhe qëndrueshmërisë sektoriale
- Fuqizimi i audiencës
- Arritja e ekselencës dhe llogaridhënies në sektorin e transmetimeve

Autoriteti, me profilin e një institucioni rregullator me ecuri të qëndrueshme është i gatshëm në përballimin e sfidave në këtë periudhë të zhvillimit të shpejtë teknologjik dhe përhapjes në shkallë të gjerë të internetit. Duke shfrytëzuar maksimalisht kooperimin dhe bashkëveprimin me institucione dhe aktorë të tjerë të fushës audiovizive, brenda dhe jashtë vendit. Sikundër dhe është prezantuar në materialin e

raportit për aktivitetin e AMA-s në vitin 2019, ndihma dhe mbështetja e Kuvendit të Shqipërisë ka qenë e jashtëzakonshme. Veçanërisht suporti dhe bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në orientimin drejt prioriteteve në angazhim. Me qëllimin e pandryshueshëm, që publiku të ketë të prekshme produkte dhe shërbime të shumëllojshme dhe cilësore nga operatorët audio dhe audiovizivë në të gjithë territorin e vendit tonë.

Ju falenderoj për vëmendjen!

2 HYRJE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s të përcaktuara në Ligjin 97/2013, Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, gjatë vitit 2019, Autoriteti është angazhuar maksimalisht t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Duke patur parasysh rëndësinë e madhe që ka media jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë, Maqedoni dhe kudo ku ka Shqiptar, roli i AMA.s bëhet edhe më i rëndësishëm.

AMA gjatë vitit 2019 ka pasur si prioritet të punës së saj rekomandimet e lëshura në Rezolutën e Kuvendit për të cilat ka raportuar periodikisht (3 raporte) në përputhje me ecurinë e realizimit të tyre. Në zbatim të kësaj rezolute, Autoriteti ka ndërtuar një agendë të ngjeshur takimesh me OSHMA-të, Kuvendin, botën akademike, organizatat dhe institucione të tjera qeveritare, të cilat kanë sjellë përmbushjen e rekomandimeve të lëshuara. Gjithashtu, vlen të theksohet mbështetja e dhënë nga Kryetari i Kuvendi, dhe intensifikimi i bashkëpunimit me deputetët që janë pjesë e grupit “Miq të Fëmijëve”, si dhe me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Fokusi gjatë vitit 2019, sa i takon procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive ka qenë finalizimi i këtij procesi në dy qarqet me popullsi më të madhe në vend, në qarqet Tiranë dhe Durrës. AMA e konsideron sfidë dhe arritje finalizimin e këtij procesi më 1 tetor 2019, duke pasur parasysh problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar si dhe impaktin që do të sillte ky proces tek publiku shqiptar. Aktualisht për qytetarët e këtyre qarqeve ofrohen 39 kanale të lira (pa pagesë), më shumë se në çdo vend tjetër të rajonit.

Informojmë gjithashtu se operatori publik shqiptar (RTSH) ka shtruar infrastrukturën digjitale në të gjithë vendin dhe operatorët privatë numerik kanë implementuar rrjetet e tyre në pjesën më të madhe të qarqeve të mbetura. Për pasojë, mbi 80% e popullsisë në vend tashmë aksesojnë transmetimet televizive digjitale, të cilat sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë.

Në mbështetje të operatorëve lokalë/rajonale audiovizivë është miratuar ligji 34/2017 për kompensimin e pjesshëm të tyre lidhur me tarifën e mbështetjes në një nga rrjetet kombëtare numerike. AMA ka vijuar zbatimin e këtij ligji për operatorët që ofrojnë shërbime audiovizive në zonat ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, duke lehtësuar në këtë mënyrë tranzicionin e tyre në teknologjinë e re digjitale.

AMA gjithashtu, në kuadër të procesit të digjitalizimit ka zhvilluar një fushatë të gjerë informuese për publikun përmes të gjithë kanaleve të komunikimit si dhe ka asistuar me strukturën Call Center për të informuar të gjitha shtresat e popullsisë, përfshirë moshën e tretë, të cilët kanë akses të kufizuar në

teknologjitë e reja. Gjatë vitit 2019, në zbatim edhe të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës fushata e ndërgjegjësimit është diversifikuar me qëllim që të jetë sa më e qartë dhe më e kuptueshme për qytetarët (publikuar spoti publicitar në 14 portale online, spote publicitare në radio dhe TV, City Lights, Billboard, etj)

Në kuadër të planifikimit dhe administrimit të frekuencave, AMA kryen periodikisht monitorime të shfrytëzimit të spektrit audio/audi vizivë. Monitorimet janë intensifikuar gjatë vitit 2019, duke pasur parasysh edhe ndjekjen e zbatimit të procesit të digjitalizimit.

Nga rezultatet e monitorimit konstatohet se në të gjithë vendin nuk ka transmetime të jashtëligjshme audio apo audi vizive. Gjithashtu gjatë vitit 2019 nuk janë konstatuar dhe nuk janë raportuar ankesa për interferenca të dëmshme nga operatorët audio/audi vizivë.

Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2019 është fokusuar më së shumti në diversifikimin dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet operatoreve prodhues të kontentit audioviziv në Shqipëri.

Krahasuar me vitin 2014 ku kishte vetëm dy operator në treg (Digit-Alb dhe Tring), sot tregu audioviz në Shqipëri ka tashmë 6 (gjashtë) operatorë të cilët ofrojnë këtë shërbim (Tring, Digitalb, RTSH, Abcom, Klan dhe RTL). Kjo larmishmëri krijon mundësi publikut të ketë një gamë më të madhe zgjedhjeje në programe si dhe rrit konkurrencën në treg, duke i ardhur në ndihmë qytetarëve të kenë më shumë mundësi zgjedhje.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar shqyrtime tematike të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, duke u fokusuar më shumë në tri prioritetet të përcaktuara nga Bordi i AMA-s në mbledhjen e parë të këtij viti si: mbrojtja e fëmijëve, reklamat e fshehura që përfshihen në edicionet e lajmeve si dhe reklamat dhe komunikimet tregtare për shërbimin shëndetësor dhe medikamentet. Nga të dhënat tona rezulton se reklama e fshehur në programet televizive mban numrin më të lartë të rasteve.

Nga komunikimi intensiv dhe informimi OSHMA-ve, si dhe nga bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, AKU, fokus prioritar për monitorimin e përmbajtjeve të transmetuara ka qenë rekomandimi i Kuvendit për reklamat e pijeve të gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të sheqerit. AMA zhvilloi Tryezën e Diskutimit “Fëmijët dhe reklamat në median audiovizive”, ku një nga aspektet kryesore ishte ky aspekt. Falë rekomandimeve dhe këmbënguljes së Autoritetit na rezulton se nuk është evidentuar asnjë rast shkeljeje gjatë vitit 2019.

Autoriteti në vijim të këtij angazhimi realizoi në muajin shtator 2019 Tryezën e Diskutimit “Fëmijët dhe reklamat në median audiovizive”, ku një nga aspektet më kryesore që u vu në qendër të aktivitetit ishte reklamat dhe komunikimet tregtare të pijeve energjike, si dhe ato të cilat janë të gazuara dhe përmbajnë sasi të tepërt të sheqerit.

AMA u investua, edhe gjatë vitit 2019, në çështjen e rregullimit ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive. Tryeza e Dytë, ku ishin të ftuar të gjitha grupet e interesit, kishte si objektiv nxitjen për hedhjen e hapave konkretë në konceptimin dhe realizimin e një praktike ligjore dhe administrative, që garanton siguri dhe kushte më të mira në redaksitë audiovizive, duke u bazuar në marrëdhënie të qëndrueshme mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, në trajtimin dinjitoz dhe konform kuadrit ligjor shqiptar, por dhe atij ndërkombëtar. AMA ka vlerësuar dhe vlerëson se në ushtrimin e profesionit nga gazetarët, redaktorët, reporterët a bashkëpunëtorët, merr një rëndësi shumë të madhe respektimi i standardeve të marrëdhënieve të punës, duke i lidhur këto drejtpërdrejt me nivelin e lirisë, pavarësisë dhe integritetit të medias.

Gjatë vitit 2019, AMA zhvilloi konferencën mediatike “Radiot fetare në gjuhën shqipe”, ku ishin ftuar rreth 100 përfaqësues nga radiot fetare, ekspertë dhe studiues të medias, deputetë dhe drejtues të institucioneve publike, klerikë të religjioneve, gazetarë etj. Konferenca synoi që, përmes prezantimeve dhe diskutimeve nga të pranishmit, të nxirrte në pah rolin dhe kontributin e redaksive fetare të komunitetit, në promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës mes besimeve.

Për vitin 2019, që përkonte me 20 vjetorin e institucionit, u realizuan 2 konferenca ndërkombëtare, si dhe studime e analiza mbi përshtatjen e legjislacionit shqiptar me ndryshimet e Direktivës Evropiane për shërbimet audiovizive, për respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar si dhe për barazinë ligjore.

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar partneritetin me organizata dhe institucione të ndryshme që angazhohen në fushën e medias, duke mbështetur projekte që kanë në fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, studime dhe analiza të fenomeneve dhe trendeve të zhvillimit, përmirësimin e raportimit dhe trajtimit të temave në programet e transmetuara, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median etj. Në këtë drejtim janë organizuar projekte të përbashkëta me organizata të shoqërisë civile, një prej të cilëve kishte si temë: *“Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve”*.

Projektet e tjera, të përmbyllura gjithashtu, trajtuan tema mbi barazinë gjinore dhe rolet gjinore në median audiovizive. Projektet, në përfundim të tyre, sollën studime për temat përkatëse, rekomandime dhe botime të ndryshme, të cilat janë publikuar në faqet zyrtare në internet të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa botimet si broshura do t’u shpërndahen operatorëve audiovizivë dhe grupeve të interesit.

Bazuar në Kontratën mes AMA-s dhe RTSH-së, gjatë vitit 2019, AMA realizoi dy shqyrtime të kësaj Kontrate. Shqyrtime të kryera në fund të 6-mujorit të parë dhe një në fund të vitit, kishin si fokus

buketën programore, mbulimin me sinjal transmetimi të territorit të vendit, si dhe plotësimin e Kontratës me anekset teknike.

Është evidentuar në mënyrë të përsëritur që, në buketën programore të Transmetuesit Publik, vijon të mungojë kanali RTSH FËMIJË 2. AMA vlerëson se është domosdoshmëri prezenca e dy kanaleve për fëmijë në buketën e RTSH-së, si një hapësirë pozitive dhe tejet e dobishme për përmbushjen e angazhimeve të Transmetuesit Publik.

Vërejmë se ka reflektim nga RTSH për përdorimin e shenjave paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, në ato fasha orare kur ata mendohet se janë para ekranit. Ndërkaq, njëri nga kanalet gjeneraliste (RTSH 1) ofron një edicion lajmesh në gjuhën e shenjave.

Ndërkohë, nuk mund të themi të njëjtën gjë për 3 (tre) operatorët e tjerë kombëtarë, të cilët nuk e kanë respektuar ende këtë detyrim ligjor, për të pasur një edicion informativ të transmetuar me gjuhën e shenjave për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Gjatë vitit raportues, përmes plotësimit të kuadrit nënligjor me akte të miratuara rishtazi, si dhe me përmirësim të akteve ekzistuese, është bërë e mundur përmbushja e objektivave të autoritetit rregullator, duke garantuar shumëllojshmërinë e shërbimeve audiovizive, rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve dhe nxitjen e zhvillimeve teknologjike përmes ofrimit të shërbimeve të reja audiovizive.

Miratimi i legjislacionit sekondar është pasuar me lehtësimin dhe eliminimin e barrierave administrative, sidomos në proceset e licencimit dhe autorizimit, aplikimeve për rinovimet e

licencave/autorizimeve, duke reduktuar në maksimum afatet e procedimeve administrative në respekt të ligjit organik dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Adresimi i problematikave, të hasura në praktikë, në aktet rregullatore, ka sjellë ndërgjegjësim të subjekteve të fushës në respektimin nga ana e tyre të kërkesave ligjore dhe kushteve të licencës/autorizimit.

Në funksion të përmbushjes së misionit të tij, Autoriteti ka ndërmarrë iniciativën dhe ka nënshkruar disa marrëveshje ndër-institucionale, të cilat i shërbejnë krijimit të hapësirave për të rritur bashkëpunimin për realizimin e kërkesave të ligjit. Institucioni, gjithashtu, ka mbajtur marrëdhënie të mira dypalëshe me autoritetet rregullatore në rajon dhe me organizma e platforma rajonale dhe evropiane të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA etj.

Gjatë këtij viti raportues, Autoriteti është investuar edhe në rritjen dhe trajnimin e burimeve njerëzore, duke i kushtuar rëndësi bashkëpunimit me ekspertë të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti, AMA u auditua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit "Mbi performancën e internetit në Administratën Publike", dhe ka vijuar komunikimin mbi rekomandimet e lëna nga ky institucion për sa i takon masave administrative.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrave të Rezolutës së vitit të kaluar të Kuvendit të Shqipërisë, është evidente rritja e arkëtueshmërisë së të ardhurave, duke ndjekur kryerjen e pagesave prej subjekteve të licencuara për detyrimet financiare të lindura nga AMA në vitin 2019.

Si një institucion i pavarur publik, Autoriteti i Mediave Audiovizive funksionon në përputhje me standardin e transparencës, duke siguruar, gjatë veprimtarisë së saj, zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit 119/2014, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë vitit 2019, në vijim të Rekomandimit nr. 43, dt.14/10/2019, të Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA ka kryer rishikim të Programit të Transparencës.

Ky raport është i organizuar në 9 kapituj, të cilët reflektojnë, në thelb, veprimtarinë e institucionit në zbatim të përcaktimeve ligjore të lartpërmendura.

Blloku i parë i këtij raporti shtjellon në mënyrë të detajuar detyrimet dhe rekomandimet e lëshuara për Autoritetin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nga institucionet e tjera të pavarura kushtetuese, si dhe angazhimet që lindin nga Progres Raporti i BE-së.

Blloku i dytë, përqendrohet te puna e bërë nga Këshilli i Ankesave në zbatim të detyrave që i rrjedhin nga ligji për median audiovizive dhe Kodi i Transmetimit. Gjithashtu, në këtë bllok, raportohet në mënyrë të detajuar për detyrat e Autoritetit si rregullator që licencon, planifikon dhe monitoron tregun audioviziv.

Blloku i tretë ndalet në raportimin për sa i takon detyrimeve që i lindin Autoritetit nga ligje të tjera të Republikës së Shqipërisë, siç është ligji për buxhetin dhe ligji për transparencën.

3 KËSHILLI I ANKESAVE

Këshilli i Ankesave është një strukturë shumë e rëndësishme e Autoritetit. Duke qenë se fëmijët janë prioritet i AMA-s, kjo është reflektuar automatikisht dhe në punën e Këshillit të Ankesave. Në këtë drejtim, nga KA, në bashkëpunim me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve”, në Kuvendin e Shqipërisë, u organizua tryeza me temë “Fëmijët në median audiovizive”. Këshilli i Ankesave, pasi prezantoi studimin me temë “*Mbrojtja e fëmijëve, në fokusin kryesor të AMA-s*”, shpjegoi arsyet pse fëmijët, mbrojtja dhe interesi më i lartë i tyre, janë prioritet i punës së Autoritetit dhe Këshillit. Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ishte krijimi i një hapësire të dobishme për të diskutuar me të gjithë grupet e interesit, mbi aspekte të mbulimit të problematikave që lidhen me raportimin e fëmijëve në median audiovizive.

Gjatë vitit 2019, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, janë adresuar më shumë se 90 ankesa nga individë, organizata të ndryshme të shoqërisë civile, institucionet publike dhe jopublike etj. Në raport me vitet e kaluara, gjatë vitit 2019, u adresuan më shumë ankesa, çka dëshmon rritjen e besimit të publikut te veprimtaria e Autoritetit. Vlerësojmë se përmirësimi i procedurës, shqyrtimi dhe përgjigja ndaj çdo ankese, si dhe sensibilizimi, rriti besimin tek Autoriteti për të adresuar shkeljet e ligjit dhe të Kodit në transmetimet audiovizive, duke dëshmuar edhe rritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve ndaj shkeljes së normave ligjore dhe etike.

Këshilli ka vërejtur përmirësim në transmetimet audiovizive për fëmijët dhe rreth fëmijëve, falë edhe ndërgjegjësimit të operatorëve audiovizivë, në lidhje me raportimet/transmetimet për të miturit dhe rreth tyre.

Duke krahasuar ankesat sipas viteve, që nga krijimi i Këshillit të Ankesave në prill të vitit 2016, kemi një panoramë si më poshtë:

Viti 2016 (nga muaji prill deri në dhjetor)

Viti 2017	35 ankesa 70 ankesa
-----------	---------------------

Viti 2018

Viti 2019	50 ankesa 93 ankesa
-----------	---------------------

Rreth 40 për qind e tyre, çdo vit, kanë si objekt fëmijët, shkeljen e të drejtave të tyre, pasuar nga ankesat me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, normave ligjore dhe etike, komunikimet tregtare dhe një pjesë tjetër janë ankesa të ndryshme.

Këshilli i Ankesave u kujdes për të ndjekur nga afër ngritjen e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, sipas udhëzimit të miratuar “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv”. Në vitin 2019, televizionet kombëtare dhe ato informative, të cilat rezultojnë edhe OSHMA-të me ankesat më të shumta, kanë ngritur Bordin e Shqyrtimit të Ankesave. Sipas udhëzimit, këto borde vihen në lëvizje edhe nga Këshilli i Ankesave për çdo ankesë të mbërritur në Autoritet, duke u kërkuar atyre pretendimet/shpjegimet për rastet e ankuara. Televizionet me licencë kombëtare dhe ato informative kanë krijuar tashmë bordet e tyre, të cilat janë funksionale.

4 ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT PËR VITIN 2018

- 1. Të vijojë fushatën e informimit të qytetarëve deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, fushatë e cila duhet të përmbajë informacione sa më praktike, me gjuhë sa më të thjeshtë, ilustrime konkrete dhe imazhe mbi teknologjinë që duhet përdorur dhe duke theksuar se tregu i dekoderave DVB –T2 është treg i hapur dhe këta dekoderë mund të sigurohen në çdo pikë shitjeje të pajisjeve elektronike.**

Në zbatim të këtij rekomandimi, gjatë vitit 2019, AMA ka vijuar fushatën e informimit të publikut në forma nga më të ndryshmet, sikurse në portalet online, nëpërmjet spoteve në televizione, City Lighs dhe Billboards, në faqen zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit, nëpërmjet qendrës Call Center etj.

Informacion më të detajuar lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi do ta gjeni në kapitullin 8 DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE, pika 8.2 “Fushata e informimit të publikut”¹.

- 2. Të bëjë një analizë të plotë të situatës së krijuar nga mbyllja e transmetimeve analoge, në shtator 2018, situatë e cila krijoi vështirësi për qytetarët shqiptarë, ku u identifikuan radhë të gjata në pikat e shitjeve të dekoderave dhe paqartësi lidhur me teknologjinë e dekoderave.**

¹ Në lidhje me rekomandimet e lëshura në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është raportuar periodikisht nëpërmjet përpunimeve me vendimin e Kuvendit nr. 49/2017. “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe të krijuara me ligj”.

AMA ka raportuar periodikisht pranë Kuvendit, lidhur me analizën e kryer sa i takon situatës së krijuar nga mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës në shtator 2018, si dhe ka raportuar veprimtaritë e kryera me qëllim shmangien e situatave të tilla në vijim.

Si rezultat i analizës së kryer si dhe hapave të ndërmarra nga AMA, më datë 1 tetor 2019, u realizua me sukses mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës, duke mos u shfaqur asnjë problematikë e ngjashme me atë të shtatorit 2018 apo edhe problematika të tjera.

- 3. Të marrë masat e nevojshme, duke bërë një vlerësim paraprak të situatës, në mënyrë që në afatin e ri të vendosur për mbylljen e transmetimeve analoge, të mos kemi përsëritje të situatës së vështirë që u krijua për qytetarët në shtator 2018 dhe qytetarët të jenë të parapërgatitur dhe të mirinformuar, pasi bëhet fjalë për qarqet ku është përqendruar numri më i madh i popullsisë.**

Aktivitetet dhe masat ndërmarra nga AMA, gjatë vitit 2019, lidhur me mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, kanë qenë si më poshtë:

- a) AMA ka kryer sondazhe në qarqet Tiranë, Durrës për të bërë një analizë dhe vlerësim të situatës në lidhje me informimin e qytetarëve për procesin e digjitalizimit, pajisjet me të cilat ata ndjekin transmetimet audiovizive (teknologjinë e përdorur), aparatet marrës, si dhe afatet e mbylljes së procesit.
 - b) AMA është angazhuar për verifikimin e aparateve marrëse televizive (TV) në treg, duke monitoruar në terren pikat e shitjeve kryesore të tyre. Nga analiza e tregut rezultoi se të gjithë televizorët e tregtuar janë të pajisur me dekoder të tipit DVB-T2, të inkorporuar.
 - c) AMA ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Statistikave në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave mbi numrin e aparateve marrëse televizive me dekoder të inkorporuar si dhe numrin e dekoderave të importuar.
 - d) Në kuadër të vlerësimit të sasisë së dekoderave në treg, AMA ka vendosur korrespondencë, në mënyrë të përsëritur, me operatorët tregtarë, si dhe operatorët audiovizivë që tregtojnë dekodera DVB-T2, duke i kërkuar informacion mbi numrin e dekoderave që kanë tregtuar, si dhe numrin e dekoderave gjendje në magazinat e tyre.
- 4. AMA të bashkëpunojë me institucionet përkatëse, shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë në arritjen e rezultateve konkrete për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të**

drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, shqetësim i cili theksohet në mënyrë të veçantë edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare (rekomandime të BE-së, raporti *Freedom House 2018, Reporters Without Borders* etj.), si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

AMA organizoi, më 19 nëntor 2019, në Tiranë, Tryezën e Dytë të Diskutimit “Rregullimi ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive”. Tryeza e Parë mbi këtë çështje është zhvilluar po nga AMA, në bashkëpunim me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në Kuvendin e Shqipërisë, në maj të vitit 2018. Pikërisht propozimet e sugjerimet konkrete, që janë bërë nga komuniteti i gazetarëve në Tryezën e Parë, ishin pikënisja e diskutimit, ku u përfshinë përfaqësues nga OSHMA-të, shoqatat dhe organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre, ligjvënës dhe zyrtarë e ekspertë nga institucionet publike, që kanë në fokus marrëdhëniet e punës, profesorë dhe kërkues nga shkencat e komunikimit dhe gazetarisë, përfaqësues nga OSBE etj.

Objektivi kryesor i Tryezës ishte nxitja e shoqatave dhe organizatave të gazetarëve audiovizivë, si dhe institucioneve përgjegjëse, për ta çuar përpara procesin e konceptimit dhe realizimit të një praktike ligjore dhe administrative, që garanton siguri dhe kushte më të mira në redaksitë audiovizive, duke u bazuar në marrëdhënie të qëndrueshme mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, në trajtimin dinjitoz dhe konform kuadrit ligjor shqiptar, si dhe akteve ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë ose ka nënshkruar.

AMA përçoi në Tryezë vlerësimin e saj se, në ushtrimin e profesionit nga gazetarët, redaktorët, reporterët a bashkëpunëtorët, merr një rëndësi shumë të madhe respektimi i standardeve të marrëdhënieve të punës, duke i lidhur këto drejtpërdrejt me nivelin e lirisë, pavarësisë dhe integritetit të medias. Duke konfiguruar dhe miratuar një sistem rregullator të qëndrueshëm, që jep ndikim pozitiv në performancën, rolin dhe përgjegjësitë e redaksive audiovizive. Pse jo, duke nxitur një proces të natyrshëm zinxhir të reflektimit dhe reagimit mbi marrëdhëniet e punës, për të gjithë pjesët e tregut mediatik.

Në emër të Kuvendit të Shqipërisë, deputeti në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Musa Ulqini, pasi ka vlerësuar iniciativën e AMA-s, shprehu gatishmërinë se do të vlerësohet çdo propozim apo kërkesë, që do të bëjnë shoqatat dhe organizatat e medias, duke i shndërruar këto në amendime dhe rregullime, të cilat e bëjnë sa më funksional kuadrin ligjor, që fokusohet në marrëdhëniet e punës.

Nga diskutantët në Tryezë u theksua nevoja e përmirësimeve ligjore, në favor të marrëdhënieve më të mira të punës së gazetarëve, duke nxitur në mënyrë të veçantë një proces vetërregullimi për këtë aspekt.

5. AMA të përmbushë detyrimet ligjore dhe të bashkëpunojë ngushtë me operatorët audiovizivë në treg dhe të mbajë të informuar në mënyrë periodike Kuvendin e Shqipërisë për mbylljen e transmetimeve analoge.

Në zbatim të këtij rekomandimi, AMA ka informuar në mënyrë periodike Kuvendin e Shqipërisë mbi ecurinë e procesit të digjitalizimit në vendin tonë.

Informacion të detajuar lidhur me këtë proces do të gjeni, gjithashtu, në kapitullin 9 “Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive”.

6. Të konkretizohet bashkëpunimi me AKEP-in dhe institucionet të tjera ligjzbatuese kundër piratërisë online.

Në zbatim të rekomandimit të Kuvendit, gjatë vitit 2019, janë zhvilluar takime me përfaqësues të AKEP-it, me qëllim draftimin e marrëveshjes së bashkëpunimit. Dokumenti, në të cilin u reflektua dhe u dakordësuan propozimet e AMA-s dhe AKEP-it, nuk u arrit të nënshkruhej brenda vitit raportues.

Me qëllim finalizimin e tekstit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis AMA-s dhe AKEP-it, në muajin tetor, AMA ka përcjellë në formë elektronike draft-marrëveshjen me AKEP-in, duke kërkuar dhe një takim me përfaqësues të këtij autoriteti, për të vijuar më tej me nënshkrimin e këtij dokumenti.

AMA e konsideron tejet të rëndësishëm bashkëpunimin me AKEP-in në koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për parandalimin dhe/ose ndalimin e piratërisë audiovizive, në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarive dhe funksioneve të të dy palëve.

Aktiviteti i paligjshëm, i kryer prej subjekteve audiovizive, kryesisht platforma kabllore, përveçse i shkakton dëm ekonomik buxhetit të shtetit, u sjell, po ashtu, dëm edhe interesave ekonomike dhe tregtare të subjekteve të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë televizive, duke ndikuar, në këtë mënyrë, në shtrembërimin e konkurrencës së ndershme dhe mungesën e ekuilibrit në tregun mediatik. AMA, duke e konsideruar çështje tejet problematike informalitetin në fushën e mediave audiovizive, veprimtari që monitorohet prej autoritetit tonë rregullator, me shkresën nr. 2957 prot, datë 01.08.2019, ka kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si dhe me operatorët kombëtarë.

7. Të marrë masa për transpozimin (reflektimin) e ndryshimeve të miratuara në legjislacionin e BE-së në fushën e mediave, në legjislacionin e brendshëm, me qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së.

Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. (Direktiva 2018/1808), datë 14.11.2018).

Ligji nr. 97/2013 është tërësisht i përafruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, dhe në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit edhe me

ndryshimet e saj, AMA ka filluar punën parapërgatitore për t'u njohur me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni evropian në fushën audiovizive.

Referuar parashikimeve të Direktivës së ndryshuar, shtetet anëtare ngarkohen për miratimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, për të qenë në pajtueshmëri me këtë akt, në shtator 2020.

Në vijim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, AMA ka ngritur një grup pune, për njohjen me ndryshimet në direktivën AVMS 2010/13, i cili, në përfundim të analizës së thelluar të dokumentit, do të përgatitë relacion informues mbi ndryshimet kryesore të këtij akti; çështjet e juridiksionit, mbrojtjes së të miturve në komunikimet tregtare, masat mbrojtëse në platformat e shpërndarjes së videove etj., që do të bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm. Nga ana tjetër, në takimet e zhvilluara në kuadër të procesit screening, përfaqësuesit e AMA-s kanë kërkuar informacion mbi implementimin e këtij akti në legjislacionin e brendshëm të vendeve anëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit që ka AMA me institucione apo organizata të ndryshme, që punojnë në fushën e mediave audiovizive, është mbështetur dhe projekti “Analizë dhe propozime për një kuadër të ri rregullator mbi mediat online” i Institutit për Studimet Publike dhe Ligjore. Projekti ofroi ekspertizë në nxitjen e debatit që bëhet aktualisht në Shqipëri apo vende të tjera, për të përshtatur Direktivën Evropiane të shërbimeve audiovizive me realitetet e reja, kur mediat bazuar në internet kanë një zhvillim të pandalur dhe efekt të jashtëzakonshëm në industrinë mediatike. Studimi ofroi një pamje të përgjithshme të instrumenteve kyçe, të cilat i kanë dhënë formë kuadrit rregullator audioviziv të BE-së, fushës së tyre të zbatimit, objektivave thelbësore të politikave të tyre, parimeve dhe marrëdhënieve të tyre, si dhe ka vlerësuar nëse aktet normative për median mund të gjejnë zbatim edhe për mediat online.

- 8. Bazuar në ndryshimet ligjore të vitit 2018, në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar, të ketë në fokus monitorimin e publicitetit për pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, krahas fokusit të AMA-s në tre fushat kryesore: atë të monitorimit të reklamave tregtare në lajmet informative, produkteve mjekësore dhe mbrojtjes së fëmijëve.**

Nisur nga zbatimi i kërkesave të ligjit 97/2013, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe i prioriteteve të vendosura për aspektet e monitorimit dhe vlerësimit të përmbajtjeve të transmetuara, AMA për vitin 2019 ka evidentuar këto raste për tërheqje vëmendjeje të OSHMA-ve:

Nr.	Nr. prot.	OSHMA	Programi	Shkaku
1	464	NEWS 24	Edicionet e lajmeve	Reklamë e fshehur
2	708	Report TV	Edicionet e lajmeve	Reklamë e fshehur
3	750	Top Channel	“Hipokrati”	Reklamë e fshehur

4	751	News 24	“Klinika 24”	Reklamë e fshehur
5	752	TV Klan	“Rudina”	Reklamë e fshehur
6	1026	TV Klan	“Zonë e Lirë”	Reklamë e fshehur
7	1105	News 24	Edicion i lajmeve 16.30	Reklamë e fshehur
8	1106	Ora News	Edicion i lajmeve 12.30	Reklamë e fshehur
9	1092	ABC News	“Thumb”	Reklamë e fshehur
10	1091	Top Channel	“E diell”	Reklamë e fshehur
11	1254	News 24	“Klinika 24”	Reklamë e fshehur
12	1225	Top Channel	“Hipokrati”	Reklamë e fshehur
13	1391	RTSH 1	“Trupi dhe Shëndeti”	Reklamë e fshehur
14	1490	Klan	“Opinion”	Reklamë e fshehur
15	1563	Klan	Edicion i lajmeve 19.30	Reklamë e fshehur
16	1589	Klan	Edicion i lajmeve 19.30	Reklamë e fshehur
17	1690	Klan	“E diela shqiptare”	Reklamë e fshehur
18	1804	RTSH 1	Edicion i lajmeve 20.00	Reklamë e fshehur
19	1711	Report TV	Edicion i lajmeve 15.00	Reklamë e fshehur
20	1768	Klan Plus	“Eliksir”	Reklamë e fshehur
21	1785	Klan	“E diela shqiptare”	Reklamë e fshehur
22	1848	Digitalb Sha (dy kanalet muzikore My Music dhe Melody)	Transmetim tërësor	Mbrojtja e fëmijëve
23	1849	BBF	Transmetim tërësor	Mbrojtja e fëmijëve
24	1912	Supersonic	Programi tërësor	Mbrojtja e fëmijëve
25	1691/1	RTSH1	Edicion i lajmeve	Përgjigje reagimi për reklamë e fshehur
26	1955	Klan Plus	“Elixir”	Reklamë e fshehur
27	2014	News 24	Programi tërësor	Reklamë politike
28	2015	Fax News	Programi tërësor	Reklamë politike
29	2044	News 24	Edicion i lajmeve	Reklamë e fshehur
30	2101	Klan	Edicion i lajmeve	Reklamë e fshehur

31	2267	News 24	Edicion i lajmeve	Reklamë e fshehur
32	2268	Top Channel	“Hipokrati”	Reklamë e fshehur
33	2337	TV Klan	“Histori shqiptare”	Reklamë e fshehur
34	2774	RTSH 2	Emisioni pakicave	Përmbajtje e papërshtatshme për fqinjësinë dhe miqësinë mes popujve
35	2869	News 24	Edicionet informative	Mbrojtja e fëmijëve
36	2870	Fax News	Edicionet informative	Mbrojtja e fëmijëve
37	2871	Ora News	Edicionet informative	Mbrojtja e fëmijëve
38	3065	Vizion Plus	Serial televiziv	Mbrojtja e fëmijëve
39	3190	AdriaNet TV	Emisioni “Besimi i krishterë ortodoks”	Mosrespektim i lirisë së besimit dhe tolerancës fetare

Duke ju referuar të dhënave më sipër, vlerësimi statistikor sipas natyrës së shkeljeve të evidentuara është:

Raste të evidentuara	Përqindje	Tipologjia
12	31%	Reklamë e fshehur (edicionet)
16	41%	Reklamë e fshehur (programet)
7	18%	Mbrojtja e fëmijëve
4	10%	Të tjera ²
39 Total	100 %	-

Për monitorimin dhe vlerësimin e rasteve të shkeljeve të kërkesave ligjore për reklamat e pijeve të gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të sheqerit, në zbatim të ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar, AMA vijon procesin e komunikimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, AKU. Në fokus të komunikimit është vlerësimi i atyre produkteve që reklamohen nga subjektet audiovizive dhe që janë pije të gazuara, duke marrë informacion të specializuar mbi nivelin e përmbajtjes së sheqerit në to. Duke pasur këtë informacion, AMA ndjek në mënyrë konstante përputshmërinë ligjore në transmetimin e këtij formati të reklamave dhe komunikimeve tregtare.

Duhet theksuar se nga monitorimet që janë zhvilluar gjatë vitit 2019, nuk është evidentuar ndonjë rast shkeljeje të kërkesave ligjore për pijet e gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të sheqerit. Në fokus të vëzhgimit kanë qenë përmbajtjet e OSHMA-ve kombëtare si dhe ato rajonale e lokale. Pavarësisht

² “Reklamë politike”, 2 raste; “Përmbajtje e papërshtatshme për fqinjësinë dhe miqësinë mes popujve”, 1 rast dhe “Mosrespektim i lirisë së besimit dhe tolerancës fetare”, 1 rast.

kësaj, AMA vijon sistematikisht monitorimin dhe vlerësimin e përmbajtjeve audiovizive të transmetuara për këtë kategori reklamash.

E rëndësishme është konsideruar nga AMA informimi dhe ndërgjegjësimi i OSHMA-ve për ndryshimet që i janë bërë gjatë vitit të kaluar ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, duke kërkuar zbatimin e tij. Për këtë, në mes të muajit shtator 2019, AMA organizoi Tryezën e Diskutimit me temë “Fëmijët dhe reklamat në median audiovizive”. Një nga aspektet më kryesore që u vu në qendër të aktivitetit ishte reklamat dhe komunikimet tregtare të pijeve energjike, si dhe ato të cilat janë të gazuara dhe përmbajnë sasi të tepërt të sheqerit.

Të pranishëm në këtë Tryezë ishin dhe përfaqësues nga OSHMA-të, nga Grupit i Deputetëve “Miq të Fëmijëve”, nga organizatat jo qeveritare që kanë në fokus të punës së tyre liritë dhe të drejtat e fëmijëve, nga institucionet publike, ekspertë të fushës, etj. Qëllimi ishte krijimi i një hapësire të dobishme për të diskutuar me të gjithë grupet e interesit, mbi aspekte të mbulimit në reklamat audiovizive të problematikave që lidhen me fëmijët.

Gjatë Tryezës dolën në pah angazhimet e AMA-s përmes shqyrtimeve analitike dhe vlerësimit të ankesave të qytetarëve dhe subjekteve por dhe me vëmendjen për përmirësime në kuadrin rregullator që të reflektojnë dukuri dhe problematika konkrete që evidentohen nga transmetimet e përmbajtjeve audio dhe audiovizive, përfshirë këtu dhe reklamat dhe komunikimet tregtare. Të pranishmit përmendën dhe nevojën e koordinimit të institucioneve në evidentimin e rasteve të shkeljeve, si dhe mundësinë e organizimit të fushatave efikase dhe kapilare të informimit dhe ndërgjegjësimit me redaksitë audiovizive por edhe me vetë prindërit dhe komunitetin e fëmijëve.

9. Të monitorohen më shumë në televizionet shqiptare rastet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të bashkëpunojë me organizata të ndryshëm dhe shoqërinë civile për përmirësimin e raportimit për fëmijët.

AMA mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, e në veçanti rastet e dhunës ndaj tyre. Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ndjek dhe shqyrton me rigorozitet ankesat për çështje të tilla.

AMA bashkëpunon ngushtësisht me organizata të ndryshme, me shoqërinë civile dhe partnerë të tjerë vendas e të huaj për zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe përmirësimin e raportimit për fëmijët.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, AMA ka intensifikuar bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, si një agjenci e cila ndjek drejtpërdrejt problemet që lidhen me fëmijët, duke i referuar pranë Këshillit të Ankesave rastet e evidentuara në mediat audiovizive.

Gjithashtu, Këshilli i Ankesave ka trajtuar një rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, gjatë një emisioni televiziv. Në qendër të emisionit ishte dhuna brenda familjes, por pavarësisht interesit publik të shfaqjes së videos dhe kujdesit të treguar për të mos identifikuar fëmijët, transmetimi i videos ishte në shkelje të Kodit të Transmetimit dhe mund të sjellë pasoja afatgjata psikologjike për fëmijët e përfshirë. Ofruesit të shërbimeve të mediave audiovizive iu tërhoq vëmendja për të mos përsëritur raste të tilla dhe për të respektuar të drejtat themelore të njeriut, e në veçanti të drejtat e fëmijëve, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të tyre.

10. Të finalizojë marrëveshjen e bashkëpunimit me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së institucionit, në lidhje me reklamat dhe me konsumatorët, si dhe përmirësimin e standardeve për një treg audioviziv të lirë dhe në përputhje me standardet evropiane.

Në muajin qershor 2019, AMA nënshkroi, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, marrëveshjen e bashkëpunimit për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të konsumatorëve në fushën e mediave audiovizive, gjatë praktikave tregtare të ofrimit të shërbimeve nga operatorët.

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe parashikimeve të marrëveshjes, AMA, rast pas rasti, ka përcjellë për kompetencë pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK) ankesa për çështje që bien brenda fushës së kompetencës së këtij organi.

AMA, me qëllim garantimin e të drejtave të konsumatorëve, me shkresën nr. 2980 prot., datë 06.08.2019, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK) duke i përcjellë për trajtim ankesën e ardhur në AMA për mungesën e sinjalit të televizionit kombëtar “TV Klan” dhe “TV Klan Plus”, në platformën private Satelitor “Digit-Alb”. Më tej, AMA ka vijuar komunikimin me këtë institucion dhe me shkresën nr. 2980/1 prot., datë 09.09.2019, i ka përcjellë gjithë dokumentacionin ligjor lidhur me ankesën në fjalë.

Pas më shumë se 3 muajsh, ky institucion ka kthyer përgjigje duke mos e adresuar çështjen, por duke rikërkuar nga ana jonë informacion dhe të dhëna shtesë, të cilat i janë vendosur në dispozicion.

11. Një bashkëpunim më të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Autoritetin e Konkurrencës, veçanërisht në kushtet kur edhe në disa raporte ndërkombëtare theksohet që pronësia e mediave elektronike është përqendruar në duart e disa biznesmenëve të mëdhenj, si dhe ndikimit të interesave ekonomikë dhe politikë, në media etj. Gjithashtu, shfuqizimi i nenit 62, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që përcaktonte kufizimin e sasisë së aksioneve, bën të domosdoshëm një bashkëpunim më të ngushtë me AK-në.

Në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit lidhur midis AMA-s dhe Autoritetit të Konkurrencës, që ka si qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e konkurrencës së lirë në tregun mediatik audio dhe/ose audioviziv, si dhe në vijim të rekomandimeve të Kuvendit, në datën 16 shtator 2019, është zhvilluar takim me përfaqësues të këtij institucioni.

Gjatë këtij takimi u dakordësua mbi marrjen e disa masave konkrete për parandalimin e problematikave të tregut mediatik mbi përqendrimin e pronësisë së mediave dhe ndikimit të interesave ekonomikë dhe politikë në media. Konkretisht, u ra dakord që autoriteti ynë t’i kërkojë mendim Autoritetit të Konkurrencës gjatë hartimit të legjislacionit sekondar, në zbatim të ligjit organik për përmirësimin e standardeve dhe kushteve për një konkurrencë të lirë dhe efektive në përputhje me standardet evropiane.

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe parashikimeve të memorandumit të mirëkuptimit lidhur me AK, AMA ka kërkuar mendim prej Autoritetit të Konkurrencës për disa akte nënligjore.

Konkretisht, për projekt rregulloren “ Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio për nevoja të përkohshme dhe nevoja institucionale”, si dhe projekt rregulloren “Për procedurat dhe krirret për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, duke pasur si qëllim përmirësimin e standardeve dhe kushteve për një konkurrencë të lirë dhe efektive, në përputhje me standardet evropiane.

Po ashtu, midis institucioneve tona gjatë kësaj periudhe ka patur korrespondencë mbi ndryshime të ndodhura në strukturën e pronësisë së subjekteve të pajisur me autorizim apo licencë nga AMA.

12. Vëmendje maksimale për çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, për t'i dhënë përgjigje, duke i vlerësuar me seriozitet dhe për t'i shërbyer interesit publik në transmetimet audiovizive shqiptare.

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ndjek dhe shqyrton çdo ankesë që adresohet pranë Autoritetit për shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit. Procedura e shqyrtimit të ankesave deri në shpalljen e konkluzioneve është një proces dinamik që është realizuar dhe po realizohet në vijimësi brenda afateve të parashikuara nga ligji.

Gjatë periudhës së raportimit, Këshilli i Ankesave ka trajtuar mbi 90 ankesa me objekt: cenim të dinjitetit, shkelje të të drejtave të fëmijëve në media, cenim të konkurrencës etj. Të gjitha ankesat janë adresuar dhe shqyrtuar me seriozitet dhe brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Pas shqyrtimit të tyre, Këshilli i Ankesave ka dalë në konkluzionet përkatëse përfundimtare. Në 20 raste, operatorëve audiovizivë iu tërhoq vëmendja, në 5 raste Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s vendosjen e sanksionit gjobë, dhe në 4 raste Këshilli i Ankesave u ka kërkuar operatorëve ndalimin e transmetimit të një reklame (programet që përfshijnë edhe komunikime tregtare) dhe të disa pamjeve të rënda filmike.

13. Për të garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive edhe pas kalimit në transmetimet numerike, AMA duhet të jetë më aktive në zgjidhjen e problematikave lidhur me subjektet audiovizive që mbështesin programin e tyre në rrjetin e RTSH-së, të cilat pretendojnë se tarifën e miratuara për mbështetje në rrjetin numerik të RTSH-së janë të pabazuara në kostot reale të RTSH-së.

AMA, në kuadër të zgjidhjes së problematikave të ngritura nga operatorët lokalë/rajonalë audiovizivë, lidhur me tarifën e mbështetjes së programeve të tyre në rrjetin e RTSH-së, ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), janë depozituar disa kërkesa nga subjekte analogë privatë ekzistues, të licencuar për të ofruar shërbim analog në allotmentet Tiranë dhe Durrës, të cilët kërkojnë ndërmjetësim me operatorin publik (RTSH) për anulimin e faturës së shërbimit të mbështetjes së programeve të tyre në rrjetin e RTSH-së, faturë, e cila është lëshuar nga RTSH për muajin shtator 2019.

AMA, duke mbajtur parasysh se, me Vendimin nr. 20, datë 15.02.2019, i ka propozuar RTSH-së të mos faturojë shërbimin për mbështetjen në rrjetin e tij numerik të programeve televizive të subjekteve analogë vendorë, që ofrojnë shërbim në qarqet Tiranë-Durrës, deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge në këto qarqe. AMA, në këtë vendimmarrje, ka mbajtur parasysh se operatorët analogë lokalë/rajonalë nuk duhet të ngarkohen me detyrime të dyfishta, pra, të paguajnë për të dy shërbimet njëkohësisht, analoge dhe numerike, si dhe për faktin që mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës ishte parashikuar fillimisht në datën 01 shtator 2019 dhe, më pas, AMA, me Vendimin nr. 119, datë 29.08.2019 “Mbi marrjen e masave në kuadër të procesit të digjitalizimit në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë”, vendosi shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në këto qarqe me 30 (tridhjetë) ditë, pra në datën 01 tetor 2019, me vendimin nr. 158, datë 07.11.2019 vendosi t’i propozojë Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) të mos faturojë për muajin shtator, subjektet analogë vendorë, që ofrojnë shërbim në qarqet Tiranë, Durrës për mbështetjen e programeve të tyre në rrjetin e RTSH-së. RTSH të vijojë me respektimin e Vendimit të AMA-s, nr. 20, datë 15.02.2019, duke qenë se transmetimet analoge janë mbyllur në datën 01 tetor 2019.

Ndërkohë, AMA, në zbatim të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 34/2017, “Për lirimin e frekuencave të Digjital Dividendit”, të ndryshuar, mori Vendimin nr. 38, datë 07.03.2019, me të cilin u përcaktua lista e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonalë, që përfitojnë nga kompensimi financiar. Referuar listës së subjekteve përfitues dhe vlerës së parashikuar për kompensim, në masën totale 1,000,000 euro, këto subjekte audiovizive do të kompensohen në masën 53,87% të pagesës së kryer, për 1 vit.

Lista e operatorëve lokalë/rajonalë, përfitues të kompensimit financiar, mund të pësojë ndryshime, pasi në listën e miratuar nga AMA janë përfshirë edhe subjektet, licencat e të cilëve janë shpallur të pavlefshme, dhe vendimmarrjet e Autoritetit janë apeluar në instancat gjyqësore, apo subjekte, veprimtaria e të cilëve është me status “të pezulluar”. Në këtë rast, vlera e kompensimit paracaktuar për këtë kategori subjektesh, do të rishpërndahet te të gjithë operatorët përfitues.

Me urdhrin e brendshëm nr. 102, datë 04.04.2019, është ngritur një grup pune për zbatimin e ligjit nr.34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Digjital-Dividendit”, i ndryshuar.

Procesi i kompensimit financiar për subjektet audiovizive analogë lokalë/rajonalë, për qarqet ku janë mbyllur transmetimet analoge (Berat, Korçë dhe Fier), ka filluar në muajin korrik 2019. Për qarqet Tiranë dhe Durrës ka filluar në muajin nëntor 2019.

Me subjektet e këtyre qarqeve, AMA mban korrespondenca të vazhdueshme shkresore, postë elektronike dhe telefonike, në mënyrë që të përmbushin kërkesat e ligjit nr. 34/2017, të ndryshuar, për të përfituar kompensimin financiar. Deri tani kanë paraqitur dokumentacion në AMA dhe janë kompensuar financiarisht 8 subjekte, për faturat që kanë likuiduar për RTSH-në.

14. Shtimin dhe intensifikimin e tryezave tematike, dëgjësive me grupe të ndryshme interesi mbi përmbajtjen e Kodit të Transmetimit, sensibilizimin për ta respektuar atë, si dhe për tema që rrjedhin nga zhvillime të ndryshme teknologjike dhe mediatike. Sinergji midis KA-së dhe organizatave qeveritare në mbrojtje të fëmijëve, si dhe me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” etj.

AMA, në bashkëpunim me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve”, në Kuvendin e Shqipërisë, më datë 12.07.2019, organizoi një tryezë të gjerë diskutimi me temën “Fëmijët në median audiovizive”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha grupet e interesit, UNICEF-it, organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare me objekt mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ishte krijimi i një hapësire të dobishme për të diskutuar me të gjithë grupet e interesit, mbi aspekte të mbulimit të problematikave që lidhen me raportimin e fëmijëve në median audiovizive.

Në këtë takim, të zhvilluar në funksion të zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për AMA-n, u prezantuan gjetjet e studimit të kryer nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në bashkëpunim me UNICEF-in mbi “Portretizimin e fëmijëve në media”.

Gjatë takimit u nënvizua rëndësia e monitorimit të përmbajtjeve audiovizive, kryesisht me fokus dhunën ndaj fëmijëve dhe reklamat për pijet energjike e pijet e gazuara me sheqer të shtuar, si produkte të dëmshme për mirërritjen e fëmijëve. U theksua nevoja për bashkëpunim ndërinstitucional dhe me median në mënyrë që të vijojë ndërgjegjësimi i publikut dhe medias në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

15. Ndjekjen në vijim deri në zbatimin e tij të plotë të detyrimit ligjor të operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave.

AMA është në kontakte të vazhdueshme me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Vetëm operatori publik e ka plotësuar këtë detyrim, ndërsa operatorët e tjerë ende jo. Këta të fundit janë njoftuar përsëri, përmes shkresave zyrtare, për marrjen e masave urgjente për konkretizimin e transmetimeve me gjuhën e shenjave.

Në shkresat më të fundit, datë 11.09.2019, dërguar televizioneve kombëtare “Top Channel”, “Klan” dhe “Vizion +”, AMA ka vënë në dijeni operatorët përkatës se përmbushja e detyrimit ligjor për transmetimet me gjuhën e shenjave do të jetë ndër pikat kryesore të raportimit të radhës nga AMA në Kuvendin e Shqipërisë.

16. Vijimin e punës për hartimin dhe miratimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor, përmes miratimit të akteve të reja rregullatore, apo hartimin e ndryshimeve ose shtesave në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator në fuqi; Të garantohet barazi dhe transparencë në trajtimin e aplikimeve, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në aspekte të veçanta, si për transparencën dhe konkurrencën në median elektronike.

AMA, si rregullator i tregut mediatik për të hartuar akte nënligjore në zbatim të ligjit, është duke punuar për hartimin apo ndryshimin e rregulloreve, me qëllim që brenda kuadrit ligjor të mbështetet dhe lehtësohet veprimtaria e subjekteve të fushës.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese, AMA ka plotësuar kuadrin nënligjor me miratimin e akteve të mëposhtme nënligjore:

- Rregulloren “Për transmetimin e raporteve të lajmeve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi për publikun”;
- Vendimin për miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun;
- Rregulloren “Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit”, me Vendimin nr. 152, datë 11.10.2019;
- Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese, AMA ka hartuar projektet e akteve të mëposhtme, të cilat pritet t’i nënshtrohen procesit të këshillimit publik:

- Rregullore për kriteret dhe masat që rregullojnë bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të transmetuesit publik”;
- Udhërrëfyes (rregullore) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik.

Ndërkohë, AMA ka hartuar projektregulloret “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv” dhe “Për dhënien e licencave të transmetimit për periudhë të përkohshme dhe për nevoja institucionale”, të cilat, pasi kanë kaluar fazën e këshillimit publik, janë miratuar nga AMA në fillim të muajit janar 2020.

17. Konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me KPM-në e Kosovës dhe me vendet shqipfolëse.

Autoritetet rregullatorë të Shqipërisë dhe Kosovës kanë zhvilluar më 6 mars 2019 një takim pune mbi Autoritetet rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës kanë zhvilluar, më 6 mars 2019, një takim pune mbi monitorimin dhe vlerësimin e programeve audiovizive. Takimi u realizua në mjediset e

Autoritetit të Mediave Audiovizive në Tiranë, ku ishin prezentë përfaqësues nga njësitë e programacionit dhe monitorimit të dy autoriteteve rregullatorë të Shqipërisë dhe Kosovës.

Përfaqësuesit e AMA-s dhe Komisionit të Pavarur të Medias, KPM, u fokusuan më shumë te problematikat e përmbajtjeve të emetuar, si dhe në procedimin e vlerësimit të tyre në përputhje me kuadrin legjislativ në fuqi. Kjo, duke u parë në funksion të garantimit të pluralitetit në transmetimet audiovizive, të shumëllojshmërisë dhe cilësisë së programeve që emetojnë televizionet, radiot, platformat digjitale, kabllorët etj. Takimi ishte konceptuar si një shkëmbim përvoja nga dy rregullatorët, në angazhimin e tyre për të respektuar standardet e transmetimeve në lidhje me mbrojtjen e të miturve, të evitimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit të çdo forme, për reklamat

e komunikimet tregtare, për ndjekjen e të drejtave autoriale të prodhimeve audio dhe audiovizuale, nivelin e veprave evropiane etj.

AMA dhe KPM po shohin mundësinë e përmirësimit të aplikimeve dhe programeve kompjuterike në dobi të monitorimit sa më cilësor dhe publikimit sistematik të të dhënave nga performanca e tregut audioviziv. Këto pritet të jenë objekt për takime të tilla pune, që do të vijojnë të organizohen dhe në të ardhmen në Tiranë dhe Prishtinë, për shkëmbimin e eksperiencave dhe gjetjen e modeleve më efikase në monitorimin dhe vlerësimin e programeve audiovizive, si dhe nevojës për të ndërhyrë në përmirësimin e akteve nënligjore për këtë aspekt.

5 STRATEGJIA E AUTORITETIT

Viti 2019 përkon me përfundimin e “Strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive”, miratuar me vendimin nr. 28, datë 29.03.2017, dokument në të cilën ishin parashikuar qëllimet kryesore dhe aktivitetet në përmbushje të objektivave të AMA-s.

a) Objektivat strategjike të vendosur nga AMA:

1. Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit - Lehtësimi i ofrimit të një game të shumëllojshme përmbajtjeje audiovizive nga shërbimet e transmetimit dhe sigurimin e pluralizmit në transmetim.
2. Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies - Mbikqyrja dhe monitorimi i zbatimit nga transmetuesit sipas statutit dhe kontratës
3. Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm në drejtim të përmirësimit të përmbajtjeve audio dhe audiovizive - Bashkëpunim me personat dhe organizatat për të përforcuar kapacitetet e tyre për përmbushjen e nevojave të publikut
4. Përforcimi i qeverisjes dhe zhvillimi i organizatës - Për të qenë një organizatë e shërbimit publik e zhdërvjellët, efikase, që evoluon vazhdimisht

Referuar Strategjisë dhe Planit të veprimit për periudhën 2017-2019, AMA është fokusuar në përmbushjen e objektivit strategjik, siguri i diversitetit dhe pluralizmit, duke miratuar 5 akte nënligjore, duke e plotësuar tërësisht këtë objektiv. Akti nënligjor më i rëndësishëm është rregullorja “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”, miratimi i së cilës erdhi pas një procesi të gjatë pune, konsultimesh me ekspertë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Përfaqësuese për lirinë e medias (OSBE) dhe duke marrë në të njëjtën kohë edhe mendimet e subjekteve të fushës.

Me qëllim sigurimin e diversitetit dhe pluralizmit, bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive 2017-2019, autoriteti ka realizuar kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike në qarqet Tiranë, Durrës, më datë 1 Tetor 2019. Në këtë mënyrë arriti në 5 numri i qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit (Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Durrës). Tashmë rreth 80% e popullsisë në vend aksesojnë transmetimet televizive digjitale, të cilat sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë. Aktualisht në qarqet Tiranë, Durrës ofrohen 39 kanale televizive të lira (pa pagesë).

Në zbatim të kësaj strategjie, gjatë vitit 2017, Këshilli i Ankesave, bashkë me njësitë e tjera në AMA, u përfshi në një proces 9-mujor konsultimi me grupet e interesit, ekspertë vendas e të huaj, për përmirësimet e Kodit të Transmetimit, aktin nënligjor më të rëndësishëm për mediat audiovizive. Kodi kaloi në vlerësimet për amendime, ndryshime dhe saktësime nga një seri konsultimesh të drejtpërdrejta dhe virtuale. Teksti final, që u miratua nga AMA në fund të vitit 2017, përfshiu dhe pjesën më të madhe të 75 vërejtjeve dhe propozimeve konkrete të institucioneve dhe organizatave vendase, si edhe nga ekspertiza e detajuar që dërgoi Këshilli i Evropës.

Në fund të vitit 2017, Këshilli i Ankesave miratoi Rregulloren “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes”, një rregullore që sanksionon skemën e brendshme për një trajtim sa më efikas dhe profesional të ankesave. Ndërsa në muajin maj 2018, kjo Rregullore u pasua me miratimin e Udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)”. Rregullorja, bashkë me Udhëzimin përkatës iu dërgua të gjithë OSHMA-ve për zbatim.

Në funksion të arritjes së qëllimit strategjik të organizatës i cili ka të bëjë me forcimin e qeverisjes dhe zhvillimi organizativ, veprimtaria dhe energjia e institucionit janë fokusuar në këto tre drejtime kryesore si më poshtë:

1. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore nëpërmjet implementimit të Manualit të Politikave të Burimeve Njerëzore.
2. Hartimi i rregullave dhe udhëzimeve të brendshme procedurale dhe të funksionimit bazë.
3. Zhvillimi organizativ.

Një pikë e rëndësishme e kësaj strategjie që rrjedh nga objektivi strategjik në lidhje me forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, është edhe mbikëqyrja e të gjithë transmetuesve të licensuar nga Autoriteti sipas statutit dhe kontratës, duke siguruar që ata të funksionojnë në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, licencave dhe të gjitha statuteve përkatëse të tyre.

Megjithëse, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, AMA përfshihet në luftën kundër piraterisë nëpërmjet internetit. Për arsye të zhvillimeve teknologjike të shpejta dhe për shkak të kapaciteteve në burime

njerëzore kjo pikë kërkon një veprimtari të shtuar në këtë pikë. Duke e parë si një problematike gjithnjë e më prezentë të shfaqur këto vite, Autoriteti ka vendosur që këtë pikë të vijojë ta ketë si prioritet edhe në strategjinë e ardhshme.

Në zbatim të kësaj strategjie u miratua vendimi *“Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/ autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”*. Ky vendim arriti të përmbledhë në një akt të vetëm administrativ të gjitha llojet dhe masat e pagesave për tu zbatuar nga AMA. Në të, u reflektuan nevojat e AMA-s për rritje të nivelit të vetëfinancimit për të mbuluar shpenzimet e nevojshme të institucionit; rishikimi i masave të pagesave për OSHMA-të sipas ndarjes së re administrative dhe nivelin e inflacionit; masat e pagesave për shërbime të reja audio/audiovizive të cilat ofrohen për shkak të zhvillimeve në fushën teknologjike.

b) Autoriteti i Mediave ka nisur punën për hartimin e Strategjisë së re të institucionit 2020-2022.

Dokumenti i ri i strategjisë bazohet në statusin e përmbushjes së objektivave 2017-2019 si dhe përcakton objektivat strategjike për periudhën 2020-2022 me fokus të veçantë në:

- a. Ecurinë e proceseve rregullatorë dhe mbikëqyrëse të Autoritetit
- b. Përcaktimet në dokumentin e përditësuar të Direktivës Evropiane për Shërbimet Audiovizive (AVMSD)
- c. Zhvillimet teknologjike në fushën e shërbimeve Audiovizive
- d. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë
- e. Rekomandime të dala nga forume ndërkombëtare të organizatave të Bashkimit Europian në fushën e medias (EPRA, ERGA, MNRA etj.)

Dokumenti strategjik përmban një plan pune trevjeçar ku për çdo objektiv strategjik janë përcaktuar proceset përkatëse, për të cilët janë zbërthyer fushat e veprimit, veprimtaritë me përparësi dhe rezultatet e pritshme.

6 MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT

6.1 Auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit "Mbi performancën e internetit në Administratën Publike"

Gjatë vitit raportues, AMA u auditua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit "Mbi performancën e internetit në Administratën Publike". KLSH rekomandoi marrjen e disa masave organizative, që lidhen me parandalimin e sulmeve ose hyrjeve të paautorizuara në pajisjet e institucionit, menaxhimin e riskut lidhur me infrastrukturën TIK si dhe menaxhimin e shërbimeve Helpdesk.

AMA, bazuar në raportin paraprak të grupit të auditimit, ka parashikuar në buxhetin e vitit 2020 blerjen një serveri *back-up* replikim me serverin kryesor, brenda gjashtëmujorit të parë. Aktualisht, janë konfiguruar filtra të cilët bllokojnë faqe adult dhe faqe të tjera të rrezikshme, që dëmtojnë dhe rrezikojnë pajisjet dhe rrjetin TIK në AMA. Sektori TIK çdo javë monitoron lojet e *firewall*-it, në qoftë se janë tentuar të hapen këto faqe.

Në vijim të përmirësimit dhe standardizimit të akteve rregullatore mbi administrimin e sistemeve dhe proceseve TIK, sipas nevojës, AMA ka qenë në proces të hartimit të aktit rregullator lidhur me ruajtjen dhe analizimin e log-eve. Aktualisht, ky draft ka përfunduar dhe do të miratohet brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020.

Sektori Teknik në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK po punon për analizimin e nevojave mbi sasinë dhe cilësinë e shërbimit të internetit, duke monitoruar, gjatë një muaji, të gjitha veprimet operacionale që stafi i AMA-s kryen për detyrat e tij. Monitorimi po kryhet përgjatë orarit zyrtar dhe do të paraqitet në bazë ditore nëpërmjet grafikëve. Nga analizimi i monitorimit të kryer do të përcaktohen edhe nevojat e institucionit për shërbimin internet.

6.2 Rekomandime nga Komisionieri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Si një institucion i pavarur publik Autoriteti i Mediave Audiovizive funksionon në përputhje me standardin e transparencës duke siguruar gjatë veprimtarisë së saj zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit 119/2014, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë vitit 2019, në vijim të Rekomandimit nr.43 dt.14/10/2019 të Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA ka kryer rishikim të Programit të Transparencës.

Në procedurën e rishikimit janë vlerësuar të gjitha problematikat e shfaqura prej miratimit dhe publikimit për herë të parë të programit të transparencës duke u fokusuar në:

- Informacioni i bërë publik në faqen zyrtare tashmë është i ndërlidhur në programin model të transparencës;

- Informacioni për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit është i publikuar në faqe dhe i ndërlidhur në programin model të transparencës;
- Është publikuar çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në cfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik
- Publikimi në një nënmenu të veçantë i vendimeve të Anëtarve të AMA-s.

Bazuar në shkresën e ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale nr. 2897 prot., datë 30.07.2019 në lidhje me “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve për të drejtën e informimit”, si dhe bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili funksionon si një bazë shtetërore të dhënash sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 13.03.2018 është kryer siguri i instalimit të “Regjistrat elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve për të drejtën e informimit” bazuar në platformën PyetShtetin.al.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë bërë në përputhje e në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Kjo mënyrë vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti rrit transparencën nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit të sipërcituar.

7 REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT

7.1 PROGRES RAPORTI

Në progres raportin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2019, në kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe Media” rekomandohet:

“Shqipëria duhet të finalizojë procesin e vonuar të kalimit në transmetimet numerike,”

Ndërkohë mbi rekomandimin e dhënë në Kapitullin 23 “Liria e shprehjes” ku:

- “Shqipëria inkurajohet të përfshijë në legjislacion reklamën shtetërore në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare për të rritur transparencën”, AMA në mënyrë të përsëritur ka raportuar se veprimtaria e saj mbështetet në ligjin nr. 97/2013, i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre. Në dispozitat e ligjit, jepen përkufizimet e reklamave politike dhe institucionale dhe nuk parashikohen rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të tyre. AMA në kuptim të tagrave dhënë prej ligjit organik monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive ndërkohë që është jashtë sferës së veprimtarisë së AMA-s, kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore të cilat aktualisht prokurohen nga secili institucion publik. AMA si autoriteti monitorues i programeve që emetohen prej subjekteve audio dhe audiovizive raporton mbi volumin që zënë reklamën, përfshirë reklamën institucionale (në kohë dhe në numër).

7.2 Raportime të tjera

AMA ka raportuar periodikisht në kuadër të Komitetit të Stabilizim Asociimit, Nënkomitetit “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, Nënkomitetit “Për Drejtësi, Liri dhe Siguri” si dhe Nënkomiteti “Lira e Shprehjes” lidhur me rekomandimet si më poshtë:

- a) *“Shqipërisë i kërkohet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të përfunduar zbatimin e kalimit në transmetime numerike”.*
- b) *“Shqipëria inkurajohet të lirojë brezin e frekuencave për rrjetet mobile deri në vitin 2020 dhe të finalizojë një marrëveshje ndërkufitare me Italinë për të shmangur ndërhyrjen midis vendeve”*
- c) *“Shqipëria inkurajohet të përfshijë në legjislacion reklamën shtetërore në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare për të rritur transparencën.”*

Lidhur me rekomandimin e parë (a), AMA ka raportuar si më poshtë:

AMA në zbatim të ligjit 97/2013 dhe në përmbushje të detyrave të përcaktuara në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike ka ndjekur në vijimësi procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

AMA ka vijuar koordinimin me operatorët analogë lokalë/rajonale dhe kombëtarë në kuadër të përmbushjes së këtij detyrimi, ka zhvilluar fushatën e informimit duke e diversifikuar atë në formë nga më të ndryshmet (fushatë indoor dhe outdoor), ka monitoruar në terren në mënyrë të vazhdueshme për të verifikuar mbulimin me sinjal numerik, ka monitoruar procesin e mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare numerike etj.

Sa i takon shtrimin të infrastrukturës numerike, informojmë sikurse edhe më parë se infrastruktura numerike e operatorit publik shqiptar (RTSH) ka përfunduar plotësisht në të gjithë vendin. Ndërkohë operatorët privatë kombëtarë vijnë shtrimin e infrastrukturës edhe në ato pak qarqe të vendit, kryesisht në veri të Shqipërisë ku edhe terreni është më i vështirë.

Lidhur me mbylljen e transmetimeve analoge, bëjmë me dije se më 1 Tetor 2019 janë mbyllur transmetimet analoge në qarqet Tiranë, Durrës që janë edhe qarqet me popullsinë më të madhe në vend, duke çuar në 5 numrin e qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit (Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Durrës. Tashmë rreth 80% e popullsisë në vend aksesojnë transmetimet televizive digjitale, të cilat sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë. Aktualisht në qarqet Tiranë, Durrës ofrohen 39 kanale televizive të lira (pa pagesë).

Procesi i mbylljes së transmetimeve analoge po vijon me qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë ku infrastruktura numerike është prezente, ku aktualisht bashkëekzistojnë si transmetimet analoge ashtu edhe ato digjitale. Afati për mbylljen e transmetimeve analoge në këto qarqe është 31 mars 2020. Pas mbylljes të transmetimeve analoge në këto qarqe Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë procesi i digjitalizimit do të vijojë në qarqet e mbetura (Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë).

Lidhur me rekomandimin e dytë (b) AMA ka raportuar si më poshtë:

Lidhur me procesin e lirimit të brezit 700 MHz, informojmë se AMA ka qënë pjesë e disa takimeve të organizuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë qëllim. Nisur nga situata aktuale e tregut audioviziv kur rreth 33% e këtij brezi është në përdorim nga operatorët privatë kombëtarë numerike, si dhe bazuar në procedurat e nevojshme për implementimin e këtij procesi (nevoja për proces konsultimi, ndryshime të kuadrit ligjor dhe rregullator, procesi i migrimit të frekuencave etj) AMA e konsideron të vështirë realizimin e tij brenda vitit 2020.

Në takimin e organizuar në Romë më 16-17 tetor 2019 me përfaqësues të vendeve të Adriatikut dhe Jonit (Shqipëri, Kroaci, Mali i Zi, Slloveni, Bosnje-Hercegovinë, Itali), më qëllim koordinimin e frekuencave të brezit VHF, ndër të tjera u diskutua edhe nënshkrimi i marrëveshjes së Jonit&Adriatikut nga ana e Shqipërisë. Në këtë takim, Shqipëria u shpreh e gatshme se do të bëjë të gjitha përpjekjet për të respektuar vendimin e BE-së 2017/899 sa i takon lirimit të brezit DD2 dhe se do të nënshkruajë marrëveshjen midis vendeve të Jonit dhe Adriatikut sa më shpejt të jetë e mundur. Deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje administrata shqiptare i kërkoi Italisë të merrte në konsideratë shmangien e interferences së shkaktuar nga ana e saj në transmetimet audiovizive shqiptare në kanalën Ch 46.

Italia u angazhua se do të marrë të gjitha masat për eliminimin e interferencës gjatë periudhës tranzitore deri në lirimin e brezit DD2.

Lidhur me rekomandimin e tretë (c) AMA ka raportuar si në pikën 6.1 më sipër.

8 KËSHILLI I ANKESAVE


Gjatë vitit 2019, Këshilli i Ankesave shqyrtoi në total 93 ankesa të ardhura nga individë, organizata dhe institucione, duke shënuar numrin më të madh të tyre, që nga ngritja e Këshillit, në vitin 2016. Vlerësojmë se përmirësimi i procedurës, shqyrtimi dhe përgjigjja ndaj çdo anese, si dhe sensibilizimi, rriti besimin tek Autoriteti për të adresuar shkeljet e ligjit dhe të Kodit në transmetimet audiovizive, duke dëshmuar edhe rritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve ndaj shkeljes së normave ligjore dhe etike.

Këshilli i Ankesave u kujdes për të ndjekur nga afër ngritjen e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, sipas udhëzimit të miratuar “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv“. Në vitin 2019, televizionet kombëtare dhe ato informative, të cilat rezultojnë edhe OSHMA-të me ankesat më të shumta, kanë ngritur Bordin e Shqyrtimit të Ankesave. Sipas udhëzimit, këto borde vihen në lëvizje edhe nga Këshilli i Ankesave, për çdo ankesë të mbërritur në Autoritet, duke u kërkuar atyre pretendimet/shpjegimet për rastet e ankuara. Televizionet me licencë kombëtare dhe ato informative kanë krijuar tashmë bordet e tyre, të cilat janë funksionale.

8.1 Veprimtaria e KA

Gjatë vitit 2019, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, kanë ardhur më shumë se 90 ankesa nga individë, organizata të ndryshme të shoqërisë civile, institucionet publike dhe jopublike etj. Në raport me vitet e kaluara, gjatë vitit 2019 u adresuan më shumë ankesa. Duke krahasuar ankesat sipas viteve, që nga krijimi i Këshillit të Ankesave, në prill të vitit 2016, kemi një panoramë si më poshtë:

Viti 2016 (nga muaji prill deri në dhjetor)	35 ankesa
Viti 2017	70 ankesa
Viti 2018	50 ankesa
Viti 2019	93 ankesa



Për sa i përket objektit të ankesave, rreth 40 për qind e tyre, çdo vit, kanë si objekt fëmijët, shkeljen e të drejtave të tyre, pasuar nga ankesat me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, normave ligjore dhe etike, komunikimet tregtare dhe një pjesë tjetër janë ankesa të ndryshme.

Megjithatë, pavarësisht numrit thuajse konstant të ankesave, vit pas viti, si edhe për periudhën raportuese, vërehet përmirësim në transmetimet audiovizive për fëmijët dhe rreth fëmijëve, falë edhe ndërgjegjësimit të operatorëve audiovizivë në lidhje me raportimet/transmetimet për të miturit dhe rreth tyre.

8.2 Shqyrtimi i ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në përmbushje të detyrave, angazhimeve dhe objektivave të përcaktuara, si dhe të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2019, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe të rregulloreve të

miratuara nga AMA, ka shqyrtuar me vëmendje maksimale, seriozitet dhe profesionalizëm ankesat e adresuara në AMA, si dhe ka shtuar tryezat tematike dhe projektet e përbashkëta për çështje që lidhen me zbatimin e ligjit, të Kodit të Transmetimit, e në veçanti, për mbrojtjen e fëmijëve nga transmetimet e dëmshme audiovizive.

Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe propozuar masat përkatëse për dhjetëra ankesa të adresuara pranë Autoritetit nga qytetarë, institucione dhe organizata të ndryshme, mbi probleme të evidentuara në përmbajtjet audiovizive. Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave të adresuara përmes postës zyrtare, postës elektronike apo faqes së internetit të AMA-s, kishin si objekt të tyre çështje të ndryshme, si shkelje e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenim të dinjitetit, si dhe disa ankesa me fokus komunikimet me natyrë tregtare. Në çdo rast, ankuesit kanë marrë një përgjigje paraprake dhe janë njohur më tej me konkluzionet përfundimtare të Këshillit të Ankesave brenda afateve të parashikuara ligjore.

Në tërësi, gjatë gjithë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar mbi 90 ankesa. Pjesa më e madhe e tyre janë dërguar pranë Autoritetit nga individët, por ka pasur rritje edhe të numrit të ankesave të dërguara nga subjekte, shoqata dhe organizata të shoqërisë civile. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Këshilli i propozoi Bordit në 5 raste vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë. Gjithashtu, Këshilli i Ankesave u ka tërhequr vëmendjen operatorëve në 21 raste, ndërsa, në një rast, i ka kërkuar operatorit audioviziv heqjen e një reklame nga transmetimi. Në 2 raste të tjera është kërkuar ndalimi i transmetimit të programeve me natyrë tregtare dhe po në dy raste ndalimin e menjëhershëm të transmetimit të pamjeve të rënda, përkatësisht për një aksident automobilistik me pasojë vdekje dhe ekzekutimin me armë zjarri të një personi.

Në fillim të muajit prill 2019, Autoriteti i Mediave Audiovizive, mori një fluks ankesash mbi mungesën e sinjalit për dy televizione (“Klan” dhe “Klan Plus”) në platformën satelitore “Digitalb”, e për pasojë mungesën e sinjalit edhe në shërbimin IPTV, në rastin konkret në shërbimin përkatës të “Albtelekom”.

AMA i trajtoi të gjitha ankesat dhe ndërmoi hapat e duhur për adresimin e situatës së krijuar tek institucionet që sigurojnë konkurrencën në treg, për shmangien e situatave të ngjashme në të ardhmen.

Në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, ky i fundit kërkoi ndërhyrjen e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK) pranë kësaj ministrie, me qëllim garantimin e të drejtave të konsumatorëve.

Bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA i kërkoi shoqërisë “Digitalb” sh.a., paraqitjen e pretendimeve/shpjegimeve lidhur me këtë situatë. Në vijim të këtyre përpjekjeve dhe komunikimeve, shoqëria “Digitalb” sh.a. paraqiti pranë AMA-s shpjegimet rreth kësaj situate, duke sqaruar se: “Shoqëria ofron shërbime me akses të kushtëzuar për abonentët e saj në platformën satelitore të transmetimit, kundrejt pagesës dhe abonimit përkatës, në bazë të kushteve dhe termave të rëna paraprakisht dakord në kontratën fillestare të lidhur

midis abonentit dhe 'Digitalb'. Bazuar në këtë kontratë, klientit, në asnjë moment, nuk i garantohet prania e përhershme e ndonjë kanali të cituar shprehimisht, pasi kjo është diçka që nuk mund të përcaktohet për sa kohë kushtet e tregut ndryshojnë vazhdimisht dhe për sa kohë interesat e shoqërive tregtare që zotërojnë kontrollin e televizioneve mund të ndryshojnë. Ndër të tjera, në kontratën e nënshkruar ndërmjet abonentit dhe 'Digitalb' citohet shprehimisht se 'Digitalb' mund të ndryshojë përmbajtjen e programeve të tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, sipas politikave dhe programacionit që vendos 'Digitalb'. Autoriteti i kërkoi shoqërisë "Digitalb" sh.a. depozitimin e kontratës tip që kjo shoqëri lidh me abonentët/pajtimtarët.

Kontrata e depozituar nga shoqëria "Digitalb" iu dërgua Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit. AMA do ta bëjë të ditur vendimin e Komisionit, sapo të ketë një të tillë nga KMK.

Me hapat e ndërmarrë, AMA beson se e ka kryer rolin e saj ligjor për këtë çështje. Gjithsesi, mbetet e angazhuar, edhe në të ardhmen, në zbatimin e ligjit për mediat audiovizive në Shqipëri, mbrojtjen e interesit më të lartë publik dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve, përmes bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse.

Gjatë vitit raportues, bazuar dhe në prioritetet e vendosura nga Bordi i Autoritetit, në fillim të vitit 2019, disa çështje janë iniciuar kryesisht nga Këshilli i Ankesave, pas monitorimit dhe vëzhgimit të përmbajtjeve audiovizive, në raport me respektimin e normave ligjore dhe etike. Shkeljet kryesore të konstatuara, për të cilat u propozuan masat përkatëse, lidhen kryesisht mosrespektimin e parimeve të Kodit të Transmetimit gjatë kronikave për fëmijët dhe rreth fëmijëve, intervistimit të tyre; shkeljen e të drejtave të njeriut dhe cenim i dinjitetit të tyre; transmetimin e reklamave të ndaluara me ligj, të reklamave të fshehta, transmetimin e përmbajtjeve të papërshtatshme etj.

8.3 Gjuha e shenjave në transmetimet audiovizive

Këshilli i Ankesave ka iniciuar një kërkesë për të gjithë operatorët kombëtare që të përmbushin detyrimin ligjor për informim në gjuhën e shenjave. Përveç operatorit publik kombëtar, tre operatorët e tjerë kombëtarë nuk e kanë respektuar ende këtë detyrim ligjor, për të pasur një edicion informativ të transmetuar me gjuhën e shenjave për "komunitetet me nevoja të veçanta shqisore" ("Komunitet me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e të drejtës së informimit" - ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kapitulli "Përkufizime", pika 10). Këshilli i Ankesave po e ndjek në vijimësi zbatimin e kësaj norme ligjore.

9 AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR TREGUN AUDIO/AUDIOVIZIV

9.1 Autoriteti në përmbushje të zbatueshmërisë ligjore

Gjatë vitit raportues, përmes plotësimit të kuadrit nënligjor me akte të miratuara rishtazi, si dhe me përmirësim të akteve ekzistuese, është bërë e mundur përmbushja e objektivave të autoritetit rregullator, duke garantuar shumëllojshmërinë e shërbimeve audiovizive, rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve dhe nxitjen e zhvillimeve teknologjike, përmes ofrimit të shërbimeve të reja audiovizive.

Miratimi i legjislacionit sekondar është pasuar me lehtësimin dhe shmangien e barrierave administrative, sidomos në proceset e licencimit dhe autorizimit aplikimeve për rinovimet e licencave/autorizimeve, duke reduktuar në maksimum afatet e procedimeve administrative në respekt të ligjit organik dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Adresimi i problematikave të hasura në praktikë në aktet rregullatore ka sjellë ndërgjegjësim të subjekteve të fushës, në respektimin, nga ana e tyre, e kërkesave ligjore dhe kushteve të licencës/autorizimit.

9.1.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit

AMA e ushtron veprimtarinë rregullatore në bazë e për zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe zbatim të tij.

Si institucion publik, AMA, gjatë ushtrimit të funksioneve ligjore bazohet edhe në kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

9.1.2 Vendimmarrja mbi licencat/ autorizimet

AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator të veprimtarisë së shërbimeve audio/audiovizive, gjatë vitit 2019, ka ushtruar veprimtarinë vendimmarrëse, në bazë dhe zbatim të ligjit organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Vendimmarrja është fokusuar, kryesisht, në shqyrtimin e aplikimeve për marrje licence/autorizimi për ushtrim veprimtarie audio/audiovizive, shqyrtimin e aplikimeve për rinovimin e licencave/autorizimeve të OSHMA-ve të subjekteve të ndryshme, shqyrtimit të kërkesave për heqje dorë nga licenca/autorizimi, njoftimeve për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesat për marrje licence dhe/ose autorizimi, shqyrtimi i ankimeve administrative ndaj sanksioneve administrative.

Po ashtu, AMA, bazuar në kompetencat e dhëna prej ligjit organik, ka vijuar, edhe gjatë këtij viti, punën për plotësimin e kuadrit rregullator me legjislacion sekondar, me miratimin e vendimeve për çeljen e procedurave të lëshimit të licencave, në varësi të gatishmërisë së kapaciteteve të lira teknike.

Gjatë vitit 2019, AMA, pas studimit të planit të përdorimit të frekuencave radio, që shfrytëzohen për transmetime audio, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur garën për lëshimin e 2 licencave të transmetimit audio analoge. Njoftimet për çeljen e garës janë publikuar në faqen e internetit të AMA-s dhe në organet e shtypit, që shpërndahen në zonën e mbulimit të licencës së transmetimit. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit. Për dhënien në përdorim të frekuencave si pasuri kombëtare e fundme përdoret procedura e hapur, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Pas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara në vijim të shpalljeve publike, AMA me vendimin nr. 121, datë 30.09.2019 lëshoi licencën private lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Sol” sh.p.k., për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë dhe Durrës.

Një tjetër kategori subjektesh, veprimtaria audio e të cilëve rregullohet prej autoritetit rregullator, janë subjektet audio të komunitetit. AMA, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 55, datë 04.04.2016, “Për miratimin e rregullores për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”, në muajin prill 2019 shpalli, në mënyrë publike, procedurën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit në zonën e ofrimit të shërbimit Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Vlorë. Në përfundim të procedimit administrativ, AMA, me Vendimin nr. 99, datë 11.07.2019 vendosi pranimin e kërkesës së shoqatës “Radio Maria”, licencuar për subjektin audio të komunitetit “Radio Maria” për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Vlorë”.

Në kuadër të procesit të digjitalizimit, AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”, miratuar me Vendimin nr. 100, datë 07.06.2017, ka çelur procedurën e lëshimit të 1 licence private lokale transmetimi audioviziv, për qarkun Elbasan.

Digjitalizimi i rrjeteve analogë vendorë ekzistues përbën detyrim, që buron nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Strategjisë për Kalimin nga Transmetimet Analoge në ato Numerike. Në nenin 139, të ligjit të lartpërmendur, përcaktohet si alternativë për kalimin në transmetimet numerike edhe aplikimi bashkërisht për një licencë rrjeti numerik vendor, brenda një zone të planifikuar për t’u mbuluar nga një rrjet SFN, sipas planit të frekuencave numerike. Në rastin e zgjedhjes së kësaj alternative, operatorët ekzistues analogë, që përfshihen brenda një allotmenti, duhet të negociojnë për përgatitjen e marrëveshjes midis tyre për ndërtimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit. Në rastin e arritjes së marrëveshjes, AMA miraton

dhënien e licencës për transmetime numerike lokale, shoqërisë së re, të krijuar nga bashkimi i subjekteve ekzistuese, pa kaluar në procesin e konkurrimit.

Në kuadër të procedimeve dhe komunikimeve shkresore me subjektet analogë të licencuar për transmetime analoge në qarkun Elbasan, pranë AMA-s, nga subjektet e kësaj zone, janë depozituar kërkesa për ndërtim rrjeti numerik lokal pa iu nënshtrohet procesit të konkurrimit publik.

Pas shqyrtimit të kërkesave dhe disponibilitetit të frekuencave të përcaktuara për shërbim audioviziv, AMA, me vendimin nr.120, datë 30.09.2019, miratoi çeljen e procedurës për dhënien e një licence lokale të transmetimit audioviziv numerik për qarkun Elbasan. Në zbatim të ligjit organik dhe rregullores që rregullon këtë procedurë licencimi, subjektet që ftohen për të aplikuar për marrje licence lokale nuk i nënshtrohen procesit të konkurrimit publik.

Pas përfundimit të procedurave të shpalljes publike dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjektet e interesuara, AMA, me vendimin nr. 186, datë 19.12.2019, vendosi dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv, shoqërisë “Era Digital” sh.p.k., të përbërë nga:

a) 11 licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe

b) licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të rrjeteve numerike tokësore lokale në teknologjinë DVB-T-2, me standardin e kompresionit MPEG-4.

Gjatë ecurisë së deritanishme të procesit të digjitalizimit të transmetimeve televizive, është rasti i parë që subjektet e licencuar për transmetime audiovizive analoge kanë rënë dakord për ndërtimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit numerik lokal në një allotment.

Po në kuadër të procesit të kalimit në transmetimet numerike, AMA, gjatë vitit 2019, ka pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv 18 subjekte të licencuar për transmetime analoge, pas depozitimit nga ana e tyre të kontratave të mbështetjes në njërin nga rrjetet numerike, publik ose privat.

AMA, mbështetur në kompetencat e veta, ka miratuar edhe vendime për mosdhënie licencash/autorizimesh dhe mosrinovim licencash/autorizimesh dhe heqje licencash/autorizimesh për disa subjekte, që nuk kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në licencë/autorizim.

Lidhur me vendimmarrjet për aplikimet për pajisje me autorizim, të cilat lëshohen pa kaluar në proces konkurrimi, gjatë vitit 2019, rezulton se kanë shfaqur interes për marrje autorizimi 12 subjekte nga të cilët, 5 subjekteve iu është dhënë autorizimi, 7 subjekteve iu është rrëzuar aplikimi.

Ndërkohë, konstatohet se një numër i konsiderueshëm subjektesh, të autorizuar për shërbim kabllor, kanë hequr dorë nga ushtrimi i aktivitetit, ndërkohë që, po ashtu, është rritur numri i subjekteve kabllore që kanë kërkuar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit. Po ashtu, një fenomen i vërejtur gjatë 2 viteve të fundit, është edhe kalimi i të drejtave të autorizimit në subjekte të tjerë kabllorë, duke

bërë të mundur në këtë mënyrë zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjekteve kabllorë, që u kanë kaluar të drejtat.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet e licencuar/autorizuar kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtit subjekt tregtar.

AMA, për të siguruar respektimin e dispozitave të ligjit për strukturën e pronësisë së kontraktuesve të transmetimit, në mënyrë periodike, ka verifikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat mbi ndryshimet e kryera prej ofruesve të shërbimit mediatik audio/audioviziv, për të cilat nuk ishte njoftuar autoriteti rregullator.

Në vijim të kontrolleve të kryera, AMA ka ndërmarrë procedimet administrative ndaj OSHMA-ve, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim, si dhe rast pas rasti, duke vendosur sanksionet përkatëse.

Për vitin 2019, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 6 subjekte, 4 prej të cilave janë miratuar (2 janë në proces). Ndërkohë, 19 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë dhe kalimin e të drejtave të licencës/autorizimit, ndryshime të cilat janë miratuar nga AMA.

Theksojmë se, në shumicën e rasteve, ndryshimet kanë ndodhur brenda vetë strukturës së ortakëve, por ka edhe raste të kalimit të të drejtave nga person fizik në person juridik, të cilat janë iniciuar nga AMA.

AMA vëren një ndërgjegjësim më të madh të subjekteve audio/audiovizive për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi për njoftimin e ndryshimeve, pasi gjatë periudhës raportuese rezulton se pjesa më e madhe e subjekteve kanë njoftuar autoritetin mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor, 30 ditë nga kryerja e tyre.

Vendimmarrjet e autoritetit, gjatë vitit 2019, për aplikimet për licencë/autorizim:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge për 1 subjekt, zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të 1 subjekti audio të komunitetit;
- Dhënien e licencës së transmetimit audioviziv lokal numerik për 1 subjekt,
- Dhënien e autorizimit për 7 subjekte për përsëritje shërbimi programi, për 3 subjekte ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv, si dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 9 subjekte të autorizuar;

- Rinovimin e licencës për transmetime audio për 13 subjekte, pajisjen me licencë shërbimi programi audioviziv për 18 subjekte dhe rinovimin e autorizimit për 18 subjekte.
- Heqjen e licencës për transmetime televizive dhe radio për 3 subjekte, mosdhënien e autorizimit për 8 subjekte, mosrinovimin e licencës/ autorizimit apo konstatimin e pavlefshmërisë së licencës për 27 subjekte.
- Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e ndodhura në kërkesën për marrje licence/autorizimi për 23 subjekte duke përfshirë në këtë numër edhe kalimin e të drejtave të licencës/autorizimit (15 subjekte)

9.1.3 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për funksionimin e autoritetit

Në funksion të rritjes së zbatimit të kërkesave ligjore, AMA ka përmbushur detyrimet e parashikuara në ligj, dhe strategjinë e AMA-s 2017-2019, përmes miratimit të një sërë aktesh normative, përfshirë këtu edhe rishikimin e akteve nënligjore në fuqi. Nga ana tjetër, AMA ka hartuar edhe akte të tjera, të cilat janë në proces miratimi nga autoriteti.

Procesi i plotësimit të kuadrit nënligjor, është shoqëruar me realizimin e një procesi të gjerë këshillimi publik, në të cilin janë përfshirë, si palë interesi, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, institucione publike dhe organizata joqeveritare. Gjatë vitit 2019 janë miratuar 4 akte nënligjore, nga të cilat 3 janë rregullore dhe një akt nënligjor, vendim.

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Vendimi “Për miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar”, vendimi nr. 21, datë 15.02.2019. Nëpërmjet këtij vendimi, AMA synon të përcaktojë shprehimisht ngjarjet të cilat konsiderohen se kanë rëndësi të madhe për publikun, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të përcaktojë mënyrën e transmetimit pa pagesë të një ngjarjeje me rëndësi të madhe, nëse duhet të transmetohet direkt, i regjistruar apo në të dyja mënyrat dhe në të gjithë ose një pjesë të territorit të vendit. Ky vendim, përpara miratimit i është përcjellë për mendim Ministrisë së Kulturës, Sportit, Turizmit, Këshillit të Ankesave, Komisionit për median dhe mjetet e informimit publik etj.

- Rregullorja "Për transmetimin e raporteve të lajmeve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 41, datë 07.03.2019", objekt i së cilës është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave për transmetimin e raporteve të lajmeve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun, si dhe kohëzgjatjen e transmetimit të tyre, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Qëllimi i kësaj rregulloreje është realizimi i së drejtës së transmetimit të njoftimeve të shkurtra, me qëllim garantimin e së drejtës së informimit për ngjarjet me rëndësi të madhe për publikun.
- Rregullorja "Mbi procedurat dhe kriteret për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 152, datë 11.10.2019, në të cilin përcaktohen rregullat dhe afatet për ofrimin e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit, si një shërbim shtesë që ofrohet prej subjekteve të licencuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive nga autoriteti. Akti specifikon listën e kërkesave juridike, teknike, programore, kërkesat lidhur me mbikëqyrjen dhe burimet njerëzore për aplikimet për ofrimin e shërbimit audio dhe/ose audiovizive sipas kërkesës së përdoruesit.
- Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren "Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 55 datë 04.04.2016, me vendimin e AMA-s, nr. 184, datë 19.12.2019, duke ndryshuar afatin e licencës së transmetimit audio të komunitetit, nga 3 (vjet) në 5 (pesë) vjet, me qëllim unifikimin e afatit të vlefshmërisë së licencës së të gjithë subjekteve audio.

Po ashtu, AMA ka hartuar projektregulloret "Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv" dhe "Për dhënien e licencave të transmetimit për periudhë të përkohshme dhe për nevoja institucionale", të cilat, pasi kanë kaluar fazën e këshillimit publik, janë miratuar nga AMA në fillim të muajit janar 2020.

Ndërkohë që janë hartuar projektet e akteve të mëposhtme, të cilat pritet t'i nënshtrohen procesit të këshillimit publik:

- Rregullore për kriteret dhe masat që rregullojnë bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të Transmetuesit Publik";
- Udhërrëfyes (rregullore) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik.

Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik, dhe në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit,

hartimi i kuadrit nënligjor është shoqëruar me kryerjen e një procesi të gjerë konsultimi dhe këshillimi publik, duke u bërë objekt diskutimi me palët e interesuara. Miratimi dhe hyrja në fuqi e akteve të mësipërme i ka shërbyer zbatimit efektiv të kërkesave të ligjit organik për përmbushjen e objektivave të autoritetit rregullator, për sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve nga OSHMA-të publike e private; përmbushjen e objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive.

9.1.4 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit

Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 Mars 2010 “Për koordinimin e Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila është e transpozuar plotësisht në ligjin nr. 97/2013, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. (Direktiva 2018/1808), datë 14.11.2018). Këto ndryshime përfshijnë, ndër të tjera, disa rregullime të reja, që synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve; ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare, rregulla të reja për platformat online, promovimin e veprave evropiane etj.

Referuar parashikimeve të Direktivës së ndryshuar, shtetet anëtare ngarkohen për miratimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore për të qenë në pajtueshmëri me këtë akt, në shtator 2020. Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*” është detyrim për Shqipërinë. Në këto kushte, prioriteti i ardhshëm do të jetë transpozimi i ndryshimeve të miratuara në legjislacionin e brendshëm kombëtar me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së.

Në vijim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, AMA ka ngritur një grup pune për njohjen me ndryshimet në direktivën AVMS 2010/13, i cili në përfundim të analizës së thelluar të dokumentit do të përgatitë relacion informues mbi ndryshimet kryesore të këtij akti; çështjet e juridiksionit, mbrojtjes së të miturve në komunikimet tregtare, masat mbrojtëse në platformat e shpërndarjes së videove etj, që do të bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm. Nga ana tjetër, në takimet e zhvilluara në kuadër të procesit “screening”, përfaqësuesit e AMA-s kanë kërkuar informacion mbi implementimin e këtij akti në legjislacionin e brendshëm të vendeve anëtare.

- a) organizimin e brendshëm të institucionit, duke përfshirë strukturën dhe organigramën;
- b) të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë fondet e përfituara nga donatorë, nëse ka pasur;
- c) listë të kallëzimeve penale dhe proceset gjyqësore në vijim, nëse ka;

(Informacion i detajuar mbi proceset gjyqësore ku është palë AMA, jepet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Raporti.)

- d) analizën e zbatimit të Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes nga ana e funksionarëve publikë, të emëruar si titullarë të institucioneve në monitorim ose si anëtarë të bordeve apo këshillave mbikëqyrës të institucioneve në monitorim.

Gjithashtu, ligji organik mbi të cilin mbështetet veprimtaria administrative e autoritetit raportues, gjatë vitit 2019, nuk ka pësuar shtesa apo ndryshime. Gjatë kësaj periudhe, përmes legjislacionit sekondar është plotësuar kuadri ligjor me akte rregullatore që synojnë krijimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive.

Ndërkohë, në fund të vitit 2018, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ndërmarrë iniciativa ligjore, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Objekt i ndryshimeve është normimi i shërbimeve të publikimeve elektronike, duke përfshirë në kontekstin e ligjit nr. 97/2013 edhe rregullimin e mediave elektronike.

Projektligji është iniciuar si bashkëpropozim i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është hartuar nga grupi i punës, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe ekspertë të fushës.

Gjatë periudhës së konsultimit publik (dhjetor 2018- janar 2019), AMA ka organizuar 4 takime publike, ku kanë marrë drejtues të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, Avokati i Popullit, institucioneve të tjera publike, përfaqësues të mediave elektronike, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, si dhe të shoqatave që në fokus të punës së tyre kanë median, por edhe të drejtat e njeriut.

Mendimet dhe propozimet e palëve dhe grupeve të interesit janë përcjellë zyrtarisht në Ministrinë e Drejtësisë (me shkresat nr. 316, prot., datë 16.01.2019 dhe nr. 218 prot., datë 14.01.2019). Po ashtu, AMA ka përcjellë në formë elektronike mendimet dhe propozimet e ardhura për projektin e propozuar.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e organit kolegjal, me vendimin nr. 169, datë 18.11.2019, ka dhënë mendim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, duke u shprehur kundër projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Shumica e anëtarëve të AMA-s, u shprehën kundër në parim për propozimin e ardhur, duke theksuar se këto ndryshime bien ndesh me kuadrin kushtetues dhe cenojnë lirinë e shprehjes. Në vlerësim të tyre, përmes këtij projektligji të propozuar nga qeveria, synohet të eliminohet dhe të cenohet veprimtaria e lirë e mediave online dhe ndryshimet e propozuara e shndërrojnë AMA-n, nga një organ

rregullator dhe mbikëqyrës të mediave audiovizive, në një organ prokurorie si dhe e zgjerojnë fushën e veprimit të këtij organi në kategori subjektsh që duhet të ushtrojnë veprimtari lirshëm në treg.

Propozimet e qeverisë ndrydhnin lirinë dhe zhvillimin e medias informative online. Propozimet e qeverisë anashkalojnë një nga parimet më të rëndësishme të medias së shkruar, atë të vetërregullimit, ndërkohë që aktet ndërkombëtare dhe, veçmas, direktiva e BE për mediat audiovizive inkurajon edhe vetë rregullatorët t'i japin përparësi këtij parimi.

Sipas tyre, ndryshimet në ligj nuk janë mbështetur mbi këto praktika të vendeve të lira dhe demokratike, duke i dhënë AMA-s, një institucioni të pavarur parlamentar, ndër të tjera, edhe kompetenca për vlerësimin e përmbajtjes editoriale të mediave.

Zgjerimi i kompetencave të Këshillit të Ankesave, që tashmë monitoron respektimin e kërkesave të Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të transmetimit, në një organ që monitoron respektimin e kërkesave të ligjit e shndërron këtë organ këshillimor në organ me fuqi vendimmarrëse. Detyrimet e vendosura për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, për njoftimin dhe regjistrimin e tyre pranë autoritetit rregullator, nënkuptojnë vendosjen e barrierave dhe pengesave për ushtrimin e lirë të veprimtarisë.

Ndërsa pakica u shpreh parimisht dakord me propozimin për ndryshimet ligjore, duke qenë se mediat online po zënë vend gjithnjë edhe më shumë në hapësirën mediatike shqiptare dhe veprimtaria e tyre duhet të rregullohet edhe nga ana ligjore. Këta anëtarë theksuan se përfshirja e kategorisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike dhe detyrimet e vendosura për ta, janë në të njëjtën linjë me rregullimet që tashmë aplikohen dhe zbatohen edhe për subjektet audio dhe audiovizive.

Vendimi i sipërcituar i AMA-s, iu përcoll në mënyrë zyrtare Kuvendit të Shqipërisë.

9.2 Analizimi dhe monitorimi i përmbajtjeve audio/audiovizive

Nga komunikimi intensiv dhe informimi i OSHMA-ve, si dhe nga bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, AKU, fokus parësor për monitorimin e përmbajtjeve të transmetuara ka qenë rekomandimi i Kuvendit për reklamat e pijeve të gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të sheqerit. AMA zhvilloi Tryezën e Diskutimit “Fëmijët dhe reklamat në median audiovizive”, ku një nga problematikat kryesore ishte ky aspekt. Nga rezultatet e monitorimit nuk është evidentuar asnjë rast shkeljeje gjatë vitit 2019, për reklamat e pijeve të gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të sheqerit, falë ndërgjegjësimit të operatorëve audio dhe audiovizivë.

AMA u investua, edhe gjatë vitit 2019, në çështjen e rregullimit ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive. Tryeza e Dytë ku ishin të ftuar të gjitha grupet e interesit, kishte si objektiv nxitjen për hedhjen e hapave konkretë në konceptimin dhe realizimin e një praktike ligjore dhe administrative që garanton siguri dhe kushte më të mira në redaksitë audiovizive, duke u bazuar në marrëdhënie të qëndrueshme mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, në trajtimin dinjitoz dhe

konform kuadrit ligjor shqiptar por dhe atij ndërkombëtar. AMA ka vlerësuar dhe vlerëson se në ushtrimin e profesionit nga gazetarët, redaktorët, reporterët a bashkëpunëtorët merr një rëndësi shumë të madhe respektimi i standardeve të marrëdhënieve të punës, duke i lidhur këto drejtpërdrejt me nivelin e lirisë, pavarësisë dhe integritetit të medias.

9.2.1 Monitorimi i përmbajtjeve audio/audiovizive


Për monitorimin e transmetimeve digjitale në Studion e Monitorimit dhe Arkivës së AMA-s në periudhën janar – maj kanë qenë në funksion 16 njësi regjistrimi (regjistrimi kryhet pa ndërprerje 24 orë), dhe për periudhën qershor – dhjetor kanë qenë në regjistrim 48 njësi regjistrimi, ku përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor dhe Abcom.

Në terma statistikorë, në total gjatë këtij viti, janë regjistruar:

- në transmetimet digjitale në total janë regjistruar **299,500** orë transmetime audiovizive dhe rreth **26,200** orë transmetime audio

që krahasuar me vitet e mëparshme janë si më poshtë :

Vite	2015	2016	2017	2018	2019
Orë regjistrime televizione	69,000	70,000	142,000	178,000	299,500
Orë regjistrime radio	5,000	5,000	5,650	15,700	26,200



Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, puna në Studion e Monitorimit fokusohet në monitorimin e:

A. Edicioneve informative;

*Edicione informative në subjektet audio dhe audiovizivë kombëtarë janë monitoruar rreth **2,600 edicione informative** (1,500 edicione të subjekteve audioviziv kombëtarë dhe 1100 edicione të subjekteve audio kombëtare).*

B. Reklamave;

*Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizivë kombëtarë janë rreth **17,500 orë** programe të monitoruara*

Sa i takon monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, nga AMA realizohet vlerësimi i një edicioni në ditë, si bartës i linjës editorial. Të dhënat sasiore të proporcionalitetit kohor në edicionet informative kryesore publikohen rregullisht çdo muaj në ëëbsite-n e institucionit, në një rubrikë të veçantë.

C. Shqyrtimin e ankesave nga publiku dhe operatorët;

Gjatë vitit 2019 në Studion e Monitorimit dhe Arkivës kanë ardhur për ndjekje 27 kërkesa/ ankesa nga subjekte të ndryshme dhe nga operatorë.

Gjatë vitit 2019 janë kryer në Studion e Monitorimit dhe Arkivës 870 orë regjistrime për subjektet OSHMA audio, me kërkesë të Drejtorisë së Programacionit.


Krahasuar me vitet e mëparshme, të dhënat janë si më poshtë :

A. Monitorime edicione lajmesh

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Televizione	900	900	1,340	1500	1500
2	Radio	600	600	770	1000	1100

B. Monitorime reklamash

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Subjekte audiovizive kombëtarë	14,000	14,000	16,000	17,500	17,500



Në fokus të monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të është dhe nxjerrja e publikimi i të dhënave nga edicionet kryesore të lajmeve për televizionet dhe radiot me licencë kombëtare. Konkretisht bëhet vlerësimi i një edicioni kryesor lajmesh në ditë për televizionet RTSH1, Top Channel, Klan dhe Vizion Plus, si dhe për Radio Tirana, Top Albanian Radio dhe Club FM. Të dhënat e përfutuara janë sasiore dhe publikohen nga AMA në versionin virtual, çdo muaj, në një rubrikë të veçantë të faqes zyrtare online, si dhe përfshihen në Buletin Periodik vjetor.

Në vijim po ju paraqesim përmbledhtazi të dhënat për vitin 2019. Duke qenë se muaji qershor 2019 ishte periudha e zhvillimit të fushatës elektorale për zgjedhjet e pushtetit vendor dhe infrastruktura e Studios së Monitorimit në AMA kalon në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për këtë arsye mungojnë dhënat përkatëse.³

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore - Qershor 2019

Gjatë muajit qershor 2019, Studio e Monitorimit dhe Arkivës në AMA ka ofruar shërbim vetëm për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit AMA - KQZ.

Angazhimi i AMA-s ishte maksimal në përshtatjen e metodologjisë së monitorimit, trajnimin e personelit të monitoruesve, përgatitjen e teknikës së nevojshme dhe infrastrukturës përkatëse në Studion e Monitorimit dhe Arkivës së AMA-s.

Me qëllim për të realizuar me sukses monitorimin e fushatës zgjedhore 2019, nga AMA u bënë investime të konsiderueshme në ristrukturimin e Studios së Monitorimit dhe Arkivës. Monitorimi i pasqyrimin nga media elektronike i fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 ka qenë një nga detyrat shumë të rëndësishme të AMA-s gjatë vitit 2019.

Ky proces u krye në bashkëpunim me Bordin e Monitorimit të Medias i ngritur nga KQZ-ja, i cili, në bazë të Kodit Zgjedhor, për kryerjen e monitorimit shfrytëzoi kapacitetet teknike dhe njerëzore të AMA-s.

9.2.2 Ndjekja e zbatimit të kontratës AMA-RTSH

Në zbatim të standardit të monitorimit dhe vlerësimit të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik nga ana e RTSH-së, bazuar në vendimin nr. 18, datë 02.03.2017, AMA, gjatë vitit 2019, realizoi dy shqyrtime, një në fund të 6-mujorit të parë dhe një në fund të vitit, ku kishte si fokus buketën programore, mbulimin me sinjal transmetimi të territorit të vendit, si dhe ndryshimet në Kontratë për plotësimin e anekseve teknike. Procesi vijues i monitorimit dhe vlerësimit ka si objektiv kryesor angazhimin maksimal dhe profesional të Autoritetit në përmbushjen e kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht: nenet 18 dhe

³ Tw dhwnat e detajuara gjenden nw Aneksin nr.1

19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e AMA-s; nenin 33 mbi detyrimet e OSHMA-ve; Kreun 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH-së, ku përfshihen nenet 90-126; por dhe në dispozita të tjera të ligjit. Materiali dërgohet si informacion për drejtuesit e RTSH-së, anëtarët e Këshillit Drejtues, si dhe për Komisionin e Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë. Nga monitorimi dhe vlerësimi i realizuar në fund të vitit 2019 janë evidentuar këto aspekte:

Buketa programore

Monitorimi është realizuar për transmetimet në gjysmën e dytë të muajit nëntor 2019, duke përfshirë të gjitha kanalet e vetë RTSH-së në platformën digjitale tokësore, konkretisht: RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3, RTSH FËMIJË, RTSH SHQIP, RTSH 24, RTSH MUZIKË, RTSH FILM, RTSH SPORT, RTSH PLUS, RTSH KUVENDI, RTSH GJIROKASTRA dhe RTSH KORÇA.

Është evidentim i përsëritur që, në buketën programore të vetë transmetuesit publik, vijon të mungojë kanali RTSH FËMIJË 2, bazuar në termat e Kontratës së Shërbimit (neni 6, pika 8). AMA mbetet me qëndrimin e shprehur në disa shkresa zyrtare që i janë përcjellë operatorit publik, se është domosdoshmëri prezenca e dy kanaleve për fëmijë në buketën e RTSH-së, si një hapësirë pozitive dhe tejet e dobishme për përmbushjen e angazhimeve të Transmetuesit Publik. Dy kanalet janë garanci dhe për segmentin moshor të tyre, duke adresuar përmbajtje që plotësojnë kushtet e zhvillimit psikosocial të ndjekësve, në favor të informimit, edukimit dhe argëtimit të tyre sipas standardeve mediatike profesionale, me programe cilësore dhe të shumëllojshme.

-Në kanalin ekzistues RTSH Fëmijë 1, transmetohen përmbajtje me vlera artistike, kulturore, argëtuese e edukuese. Ky kanal vijon të ketë një vëmendje e kujdes të konsiderueshëm për përmbajtjen e larmishme dhe etikën e programeve, për gjuhën shqipe, për drejtshkrimin e drejtshqiptimin e saj, si në promocion, në dublime dhe në përkthimet me titra. Por përsërisim nevojën e rritjes së numrit dhe llojeve të emisioneve me dhe për fëmijë dhe shtimin e programeve të reja, të cilat do të shmangnin ritransmetimet e shpeshta, do ta bënin edhe më të dobishëm e tërheqës për teleshikuesit e mitur, fëmijë e të rinj.

-Bazuar në nenin 7 të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, duhet që, në dy kanale gjeneraliste të transmetuesit publik, të transmetohet të paktën një edicion informativ brenda 24 orëve, ku të ketë shpjegime përmes një kuadrati të vogël në ekran me gjuhën e shenjave. Deri më tani një transmetim të tillë e ka periodikisht kanali gjeneralist RTSH 1, ndërkohë që në kanalin RTSH 2 transmetohet me gjuhën e shenjave vetëm një edicion informativ në javë. Përmes shkresave të përsëritura AMA ka kërkuar nga RTSH që të respektojë plotësisht këtë pikë të Kontratës së Shërbimit.

-Ka reflektim nga RTSH për përdorimin e shenjave paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në ato fasha orare kur ata mendohet se janë para ekranit. Por ky problem ende nuk ka marrë zgjidhje në kanalin gjeneralist rajonal RTSH KORÇA, i cili duhet të angazhohet për të

plotësuar sa më shpejt dhe në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi për këtë aspekt.

-Buketa programore e vetë RTSH-së, duhet të përmbushë kërkesat e ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Në nenin 1 të ligjit të sipërcituar theksohet se, RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08.00 deri në orën 22.00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash transmetohet detyrimisht nga ora 17.00 deri në orën 22.00.”

Mbulimi me sinjal i territorit

Bazuar në monitorimin dhe vlerësimin e AMA-s, për nivelin e mbulimit me sinjal transmetimi, ishin këto të dhëna nga terreni: sa i përket *allotmenteve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit* (Berat, Korçë, Fier, Tiranë dhe Durrës), RTSH ka ndezur transmetuesit numerikë sipas përcaktimeve të Planit Numerik Frekuencor dhe mbulon pjesën më të madhe të territorit me sinjal, duke mbartur kanalet sipas zonave të licencimit. Megjithatë, është evidentuar se ka ende disa zona në të cilat, sipas matjeve të kryera nga AMA, vijon të mos ketë mbulim me sinjal numerik dhe analog.

ALLOTMENTI BERAT

Lagjet mbas Kalasë së Beratit
Njësia administrative Roshnik
Njësia administrative Sinjë
Njësia administrative Potom
Njësia administrative Çepan

ALLOTMENTI KORÇË

Disa fshatra të njësive administrative të mëposhtme:

Voskopojë
Dardhë
Çërravë (qendër)
Mokër (pjesërisht)
Gorë
Barmash

ALLOTMENTI TIRANË - DURRËS

Njësia administrative Zall Bastar
Njësia administrative Shëngjergj
Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
Njësia administrative Krujë (pjesërisht)
Njësia administrative Cudhi

ALLOTMENTET KU NUK KA PËRFUNDUAR DIGJITALIZIMI

Procesi i digjitalizimit nuk ka përfunduar në disa qarqe të vendit dhe konkretisht në qarqet Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës. Ndërkohë operatori publik shqiptar ka shtruar infrastrukturën numerike në të gjithë vendin dhe bazuar në aktet ligjore në fuqi, ka detyrimin që në qarqet ku ende nuk ka përfunduar procesi të ofrojë transmetimet televizive përmes teknologjisë analoge dhe digjitale deri në mbylljen e transmetimeve analoge në këto qarqe. Nga monitorimet e kryera konstatohet se në zona të caktuara të këtyre qarqe ka mungesë sinjali analog dhe/ose mungesë të sinjalit numerik.

Konkretisht, konstatimet e gjetura janë si më poshtë:

ALLOTMENTI ELBASAN

Zona të pambuluara me sinjal analog (disa zona në njësitë administrative)	Zona të pambuluara me sinjal numerik (disa zona në njësitë administrative)
Qukës	Qukës
Gramsh	Labinot Mal
Labinot Fushë (Xibrakë)	Labinot (Fushë –Xibrakë)
Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë)	Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë)
Prrenjas	

ALLOTMENTI VLORË

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Himarë (Qeparo)	Himarë (pjesërisht)
Fshatrat e Lumit të Vlorës (Drashovicë, Kot, Brat, Tërbac, Velishtë, Vranisht, Tërbac, Kuc.etj)	Fshatrat e Lumit të Vlorës (Drashovicë, Kot, Brat, Tërbac, Velishtë, Vranisht, Tërbac, Kuc.etj)
Lukovë (Borsh)	Borsh (pjesërisht)
Delvinë	

ALLOTMENTI GJIROKASTËR

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Njësia administrative Cepo (pjesërisht analog)	Njësia administrative Picar
Njësia administrative Kurvelesh	Njësia administrative Zagorie

Njësia administrative Memaliaj (Damës, Kallëmb)	Njësia administrative Kurvelesh
Njësia administrative Krahës	Njësia administrative Krahës
Njësia administrative Qesarat (pjesërisht)	Njësia administrative Qesarat (pjesërisht)
Njësia administrative Dropull i sipërm (fshatrat Selo, Likomil, Llovine, Krioner, Sotirë)	Njësia administrative Dropull i sipërm. (fshatrat Selo, Likomil, Llovine, Krioner, Sotirë)
Njësia administrative Pogon	Njësia administrative Pogon

ALLOTMENTI SHKODËR

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Njësia administrative Vau i Dejes	Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht)
Njësia administrative Ana e Malit	Njësia administrative Kelmend (pjesërisht)
Njësia administrative Kelmend	
Njësia administrative Bushat	
Njësia administrative Kastrat (Bratosh)	

ALLOTMENTI LEZHË

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Bashkia Lezhë	Njësia administrative Rrëshen (pjesërisht)
Njësia administrative Rrëshen	Njësia administrative Rubik (pjesërisht)
Njësia administrative Rubik	
Njësia administrative Selitë	
Njësia administrative Kthellë	
Njësia administrative Fan	
Njësia administrative Orosh	
Njësia administrative Kaçinar	

ALLOTMENTI DIBËR

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)	Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
Njësia administrative Sllovë (Kala e Dodës)	Njësia administrative Sllovë (Kala e Dodës)
Bashkia Klos	

ALLOTMENTI KUKËS

Zona të pambuluara me sinjal analog	Zona të pambuluara me sinjal numerik
Njësia administrative Lek Bibaj	Njësia administrative Lek Bibaj

Lidhur me konstatimet e mësipërme, sa i takon mbulimit të territorit me sinjal analog dhe numerik, iu kërkua në material RTSH-së, që të marrë të gjitha masat për mbulimin me sinjal numerik të zonave në qarqet ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit (Berat, Korçë, Tiranë dhe Durrës), si dhe duhet të sigurojë me sinjal analog të gjitha zonat e qarqeve ku ende nuk ka përfunduar procesi i digjitalizimit. RTSH duhet të mbajë të informuar AMA-n mbi situatën aktuale të mbulimit të territorit me sinjal analog dhe numerik, në mënyrë të veçantë për zonat e sipërcituara.

Ndryshimet në Kontratë për plotësimin e anekseve teknike

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, konkretisht, neneve 54, 117 dhe 125 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, AMA dhe RTSH kanë nënshkruar, në vitin 2017, Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik, e cila, ndër të tjera, rregullon aspekte të natyrës teknike. Kontrata në nenin 10 “Pikat e transmetimit”, parashikon se: “Pikat e transmetimit, frekuencat dhe karakteristikat e tjera teknike të rrjetit numerik dhe të rrjetit analog për transmetim audio, që do të shfrytëzohen nga RTSH, përcaktohen saktësisht në Aneksin nr.1, që do t’i bashkëlidhet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.”

Në mungesë të informacionit teknik nga ana e RTSH-së, ky aneks nuk është plotësuar në momentin e miratimit të Kontratës dhe vijon ende të jetë i paplotësuar. Ndërkohë, me informacionin e përcjellë nga RTSH, në qershor të vitit 2019, lidhur me frekuencat audio që RTSH ka në përdorim si dhe bazuar në të dhënat teknike të RTSH-së lidhur me transmetimet audiovizive numerike, gjithashtu të depozituara në AMA, konsiderojmë se dokumentacioni teknik i cili duhet të jetë në përmbajtje të Aneksit 1 është i plotë.

Duke qenë se Aneksi Nr.1 është pjesë përbërëse e Kontratës së Shërbimit, ky aneks duhet të miratohet prej Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe më pas AMA në cilësinë e organit kolegjal do të vijojë me miratimin e tij (miratimin e karakteristikave teknike të transmetimeve audio/audiovizive të RTSH-së.

9.3 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Gjatë vitit 2019, pas një procesi të koordinuar ngushtë me operatorët audiovizivë kombëtarë e lokalë, u arrit mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë-Durrës, në të cilët, së bashku me qarqet Fier, Korçë e Berat, ofrohen vetëm transmetime digjitale drejt rreth 80% të popullsisë në vend. Nga këto rrjete numerike, të konfiguruar në teknologjinë DVB-T2, ofrohen dy deri në tre herë më shumë programe falas në krahasim me teknologjinë e mëparshme analoge.

Gjatë këtij procesi është arritur, gjithashtu, ndezja e të gjitha stacioneve numerike të operatorit publik në gjithë territorin, si dhe ndezja e rrjeteve të operatorëve privatë edhe në zona ku

transmetimet analoge nuk janë fikur ende. Kjo ka mundësuar aksesimin e transmetimeve numerike nga e gjithë popullsia në rang vendi.

Mbas një procesi intensiv koordinimi me operatorët audiovizivë, si dhe me autoritetet homologe të vendeve fqinjë është arritur eliminimi tërësor i interferencave në brezin audio dhe audioviziv. Në këtë rezultat ka ndikuar ndjeshëm lirimi tërësor i brezit të Dividendit Digjital si dhe fikja e të gjitha transmetimeve të paligjshme audiovizive, në të gjithë territorin e vendit.

9.3.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Brezi i frekuencave, i përcaktuar për shërbimet audiovizive, aktualisht, është në përdorim për transmetime analoge dhe numerike në qarqet ku nuk ka përfunduar procesi i digjitalizimit si dhe për transmetime numerike në qarqet ku ka përfunduar ky proces (Berat, Fier, Korçë, Tiranë dhe Durrës).

Bazuar në planin kombëtar numerik, operatori publik shqiptar (RTSH) disponon frekuenca për dy rrjete numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuenca për 1 rrjet numerik secili prej tyre.

Në këtë plan është parashikuar gjithashtu një rrjet kombëtar numerik në brezin VHF si dhe disa frekuenca të lira në brezin UHF për licencimin e operatorëve lokalë/rajonalë.

Në tabelën më poshtë paraqitet Plani Kombëtar Numerik:

Plani Frekuencor Numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të RTSH-së në Rep.Shqiperise (i miratuar nga AMA me V. nr. 27, datë 01.02.2013).

Rrjetet Shqiperia	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkoder	Kukes	Diber	Lezhe	Tirane	Elbasan	Fier	Berat	Korce	Gjirokaster	Vlore
RTSH (MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
RTSH (MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Plani Frekuencor Numerikë për 5 rrjetet kombëtarë private në brezin UHF në R.SH

Rrjetet Kombetare Private	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkoder	Kukes	Diber	Lezhe	Tirane	Elbasan	Fier	Berat	Korce	Gjirokaster	Vlore
KLAN (MUX-3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
DIGITALB (MUX-4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
TOP CHANNEL (MUX-5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
MEDIA VIZION (MUX-6)	22	36	54	22	57	46	29	24	21	48	53
ADTN (MUX-7)	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	51

Kanalet frekuencore te lira ne brezin VHF dhe UHF

	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D	AL-012D
	Shkoder	Kukes	Diber	Lezhe	Tirane	Elbasan	Fier	Berat	Korce	Gjirokaster	Vlore	Sub. Tirane
Kanalet e lira ne VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
Kanalet e lira ne UHF		56				56		52	28	38		26
						58			59	56		44
										58		50
										60		60

Numri i frekuencave të lira reduktohet duke pasur parasysh lirimin e brezit 694-790 MHz i njohur si brezi DD2. Konkretisht mbeten: 1 frekuencë në qarkun e Korcës (Ch28), 1 frekuencë në qarkun e Gjirokastrës (Ch38) dhe 2 frekuencë në suballotmentin e Tiranës (Ch 26 dhe Ch44).

Gjatë vitit 2019, në kuadër të administrimit dhe menaxhimit të frekuencave audiovizive AMA ka lëshuar 1 licencë private lokale transmetimit audioviziv numerik për qarkun Elbasan.

Konkretisht me Vendimin nr.120, datë 30.09.2019 “Për celjen e procedurës të dhënies së 1 licence private lokale transmetimi audioviziv numerik për qarkun Elbasan ka çelur garën për dhënien e licencës lokale për transmetime tokësore digjitale audiovizive.

Bazuar në këtë procedurë ka rezultuar fitues dhe është licencuar shoqëria “Era Digital” sh.p.k., me vendim nr. 186, datë 19.12.2019 “Për dhënien e licencës lokale transmetimi audioviziv numerik shoqërisë “Era Digital” sh.p.k., për qarkun Elbasan”.

Informojmë gjithashtu se bazuar në Planin Kombëtar numerik, rezulton se rreth 30.9 % e kanaleve të frekuencave të përcaktuara nga AMA për 5 rrjetet UHF private kombëtare i përkasin brezit DD2. Kjo do të thotë që procesi i lirimit të brezit DD2 do të jetë sfida e radhës për autoritetin.

9.3.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Sa i takon planifikimit dhe administrimit të spektrit audio FM 87.5-108 MHz, AMA ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të frekuencave për këto shërbime.

Zonat që identifikohen problematike në lidhje me disponueshmërinë e frekuencave të lira mbeten qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier, ndërkohë për të gjithë zonat e tjera disponohen resurset e nevojshme.

AMA gjatë vitit 2019 ka çelur dy (2) gara për dhënien e licencave të transmetimit audio analogë:

- Vendimi nr.22, datë 15.02.2019 “Për çeljen e garës për dhënien e licencës private të transmetimit audio analoge dhe miratimin e dokumentacionit të licencimit”.
- Vendimi nr.84, datë 07.06.2019 “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge”.

Në përfundim të procedurave të sipërpërmendura me vendim nr.121, datë 30.09.2019, AMA shpalli fitues subjektin audio privat vendor Radio Sol.

Gjithashtu me vendim nr. 64, datë 17.04.2019, AMA vendosi “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio të komunitetit”. Fitues u shpall “Radio Maria”, duke zgjeruar zonën e tij të shërbimit edhe në Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Vlorë.

Në funksion të detyrave që ka AMA, ka kryer gjithashtu studime mbi kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit, si Radio Club FM. Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2019 janë kryer gjithashtu procedurat e koordinimit, në përputhje me:

- aktet finale të Konferencës Rajonale GE-75 “Për transmetimet audio në brezat frekuencor LF/MF (Rajoni 1 dhe 3)”, në zbatim të notifikimeve të ardhura, kryesisht nga administrata e Italisë, si dhe
- aktet finale të Konferencës Rajonale GE-84 “Për planifikimin e transmetimeve audio në bandën VHF (Rajoni 1 dhe disa pjesë të Rajonit 3)”, në zbatim të notifikimeve të ardhura nga administratat e Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, si dhe Bullgarisë.

9.3.3 Koordinimi i frekuencave audio/audiovizive

Në zbatim të Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s 2017-2019, ku një ndër veprimtaritë e planifikuara është edhe koordinimi me vendet nënshkruese të Marrëveshjes së GE06 mbi riorganizimin e frekuencave të planeve frekuencore përkatëse për evidentimin e hapësirave të

optimizimit dhe të shtimit të kapaciteteve transmetuese, AMA, gjatë vitit 2019, ka vijuar procesin e koordinimit me vendet fqinjë.

Bazuar në kërkesat e ardhura për koordinim nga vendet fqinjë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në Planin GE06. Administratat e Maqedonisë dhe Bosnje Hercegovinës kanë kërkuar miratimin e AMA-s lidhur me caktime frekuencore, sipas të cilave Shqipëria është konsideruar e prekur nga ndryshimet e këtij Plani.

Nga këto kërkesa vihet re se këto shtete kanë filluar të lirojnë brezin DD2, duke ndryshuar allotmentet dhe caktimet frekuencore të tyre.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, në kuadër të koordinimit të frekuencave të bandës VHF për transmetimet audio/audiovizive digjitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe DAB), AMA është angazhuar në takime multilaterale me vendet që lagen nga ujerat e detit Adriatik dhe Jon (si Itali, Kroaci, Slloveni, Mali i Zi, Bosnje Hercegovinë dhe Greqi), me qëllim përdorimin sa më eficient të spektrit, si dhe shmangien e interferencave të dëmshme midis administratave kufitare.

Këto takime do të vijojnë dhe gjatë vitit 2020, me qëllim dakordësimin e përdorimeve të kanaleve frekuencore të bandës VHF nga secila administratë palë e diskutimeve, si dhe finalizimin e propozimeve me firmosjen e një marrëveshjeje multilaterale midis Shqipërisë, Italisë, Kroacisë, Sllovenisë, Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës dhe Greqisë.

9.3.4 Shmangia e interferencave të dëmshme

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre, gjatë vitit 2019, AMA ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e spektrit audio FM në të gjithë territorin e vendit me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen në kohë të shpejtë të interferencave që shkaktohen nga sinjalet e emetuara nga transmetuesit e vendeve fqinje. Në këtë kuadër, AMA ka implementuar gjatë vitit 2019 sistemin e qendërzuar të monitorimit të spektrit audio FM. Ky sistem, monitoron on-line spektrin audio FM përkatësisht në qytetet Kukës, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë. Krahas identifikimit të menjëhershëm të interferencave, sistemi bën të mundur:

- a. identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët në treg ndryshojnë frekuencat;
- b. Identifikimin e menjëhershëm të përdorimit në mënyrë ilegale të spektrit audio;
- c. Kontrollin e gjendjes reale të transmetimit të subjekteve audio të licencuar (janë transmetim apo jo).
- d. Kontrollin e parametrave teknik të transmetimit të subjekteve audio.

Në qytetet e tjera monitorimi i spektrit audio është kryer në mënyrë periodike nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLKF).

1. Adresimi i interferencave të shkaktuara brenda vendit

Për sa u përket interferencave të shkaktuara brenda vendit, gjatë vitit 2019 nuk janë konstatuar si dhe nuk janë raportuar nga ana e subjekteve audio dhe audiovizivë.

2. *Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje.*

Për sa u përket interferencave të shkaktuara në vendet fqinje, gjatë vitit 2019 AMA nuk ka administruar asnjë ankesë nga administratat fqinje, lidhur me eliminimin e interferencave të dëmshme të shkaktuara nga subjektet tona OSHMA.

Ndërkohë bazuar në monitorimin e shfrytëzimit të frekuencave të kryera periodikisht nga AMA, gjatë vitit 2019 janë identifikuar sinjale televizive italiane në allotmentin e Vlorës dhe Tiranës, përkatësisht në kanalet Ch 46 dhe Ch 57. Këto kanale bazuar në marrëveshjen GE06 janë të përcaktuara për administratën shqiptare.

Lidhur me këtë shqetësim, AMA, me shkresë nr. 2453 prot, datë 13.06.2019, si dhe me anë të e-mail të datës 08.07.2019, ka vendosur korrespondencë me palën italiane, duke e informuar mbi identifikimin e interferencave të dëmshme në kanalin Ch 46 (në Himarë dhe Sarandë) dhe kanalin Ch 57 (në Durrës, Kavajë dhe Krujë), si dhe duke i kërkuar lirimin e këtyre kanaleve në një kohë sa më të shkurtër.

Në përgjigje të korrespondencave tona, Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë, me shkresë me referencë U.0045279, datë 18.07.2019 (dërguar me e-mail), ka përcjellë komentet e saj, lidhur me problematikën në fjalë, duke propozuar dhe një takim multilateral me përfaqësues nga pala Italiane, Shqiptare si dhe Malazeze, me qëllim diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve, lidhur me procesin e koordinimit të frekuencave të brezit DD2.

Në këtë kuadër, më 16-17 tetor 2019, u organizua në Romë takimi me përfaqësues të vendeve të Adriatikut dhe Jonit (Shqipëri, Kroaci, Mali i Zi, Slloveni, Bosnje Hercegovinë, Itali) me qëllim koordinimin e frekuencave të brezit VHF, ku ndër të tjera u diskutua dhe shmangia e interferencave në kanalin Ch 46, si dhe nënshkrimi i marrëveshjes së Jonit&Adriatikut nga ana e Shqipërisë. Shqipëria u përfaqësua nga zv. Ministri i MIE, si dhe ekspertë të MIE dhe AMAs.

Në këtë takim Shqipëria u shpreh e gatshme se do të bëjë të gjitha përpjekjet për të respektuar vendimin e BE-së 2017/899 sa i takon lirimit të DD2 dhe se do të nënshkruajë marrëveshjen midis vendeve të Jonit dhe Adriatikut sa më shpejt të jetë e mundur. Deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje administrata e shqiptare i kërkoj Italisë të merrte në konsideratë shmangien e interferencës së shkaktuar nga ana e saj në transmetimet audiovizive shqiptare në kanalin Ch46. Ndërkohë Italia u angazhua se do të marrë të gjitha masat për eliminimin e interferencës gjatë periudhës tranzitore deri në lirimin e brezit DD2.

9.3.5 *Lirimi i brezit të Dividentit Digjital II.*

Bazuar në vendimin e Këshillit dhe Parlamentit të Evropës BE 2017/899, datë 17 Maj 2017 “Mbi përdorimin e brezit frekuencor 470-790 MHz në vendet e Bashkimit Evropian”, edhe një pjesë tjetër e brezit audiovizivë do të lirohet dhe do të kalojë për përdorim për shërbimet e lëvizshme (brezi 694 790 MHz, i njohur si brezi DD2). Ky brez duhet të lirohet brenda vitit 2020 dhe në raste të justifikuara brenda vitit 2022.

Procesi i lirimit të brezit DD2 do të këtë impakt të ndjeshëm në tregun audiovizive, duke qenë se ky brez aktualisht është në përdorim nga operatorët privatë kombëtarë numerikë të licencuar nga AMA.

Gjatë viteve 2018 dhe 2019 janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të AMA-s, AKEP-it dhe MIE-s. Në takimet e zhvilluara AMA ka propozuar që procesi të fillojë me një konsultim të gjerë publik, në përfundim të të cilit do të përcaktohen edhe rrugët që duhet të ndjekë ky proces si dhe nevojat për ndryshime ligjore dhe nënligjore. Konkluzionet që do të dalin nga konsultimi publik do të shërbejnë edhe për hartimin e Planit të Veprimit që duhet ndjekur nga institucionet që do të përfshihen në këtë Plan. AMA ka propozuar ngritjen e një grupi teknik pune për ndjekjen e procesit të lirim të brezit DD2 deri në përfundimin e plotë të tij, i cili të udhëhiqet dhe koordinohet nga MIE.

Deri më tani, ky proces ka mbetur pezull, ndërkohë që vendet e rajonit kanë ndërmarrë disa iniciativa për të koordinuar mbi përdorimin e frekuencave të brezit audioviziv të mbetur (pa përfshirë brezin DD2) dhe pjesa më e madhe e tyre parashikojnë që të lirojnë këtë brez brenda vitit 2020.

Referuar edhe rekomandimeve të fundit të Komisioni Evropian ku ndër të tjera Shqipëria inkurajohet për lirin e brezit 700 MHz (brezi DD2) dhe dhënien në përdorim të tij për rrjetet e lëvizshme deri në vitin 2020, si dhe finalizimin e marrëveshjes ndërkufitare me Italinë, me qëllim shmangien e interferencave midis vendeve, AMA duke e konsideruar këtë çështje të një rëndësie të veçantë, ka bërë me dije edhe Kryeministrinë lidhur me këtë fakt.

9.4 Mbikqyrja e tregut audio/audiovizivë

Autoriteti i Mediave Audiovizive, për vitin 2019, është fokusuar më së shumti në shumëllojshmërinë dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve prodhues të kontentit audioviziv në Shqipëri. Krahëuar me vitin 2014, kur kishte vetëm dy operatorë në treg (DigitAlb dhe Tring), sot tregu audioviziv në Shqipëri ka 6 (gjashtë) operatorë, të cilët ofrojnë këtë shërbim (Tring, Digitalb, RTSH, Abcom, Klan dhe RTL). Kjo larmi i krijon mundësi publikut të ketë një gamë më të madhe zgjedhjeje në programe, si dhe rrit konkurrencën në treg, duke i ardhur në ndihmë qytetarëve të kenë më shumë mundësi zgjedhjeje.

Autoriteti ndërmori veprimet e nevojshme duke rritur bashkëpunimin me operatorët e interesuar si dhe duke hartuar në sërë rregulloresh, për të lehtësuar aplikimet dhe shqyrtimet e dosjeve të subjekteve, që ishin të interesuar për shtimin e numrit të kanaleve. Gjithashtu, dhënia e autorizime të subjekteve që do të operojnë nëpërmjet internetit (OTT), bëri të mundur që subjekte të reja të aplikojnë për të marrë autorizimin për këtë shërbim. Kjo situatë solli si pasojë rritjen dhe diversifikimin e operatorëve në tregun e kontentit audioviziv.

Autoriteti i Mediave Audiovizive është i vetmi institucion zyrtar për monitorimin e programeve/kanaleve televizive në periudhë zgjedhore, qofshin ato zgjedhje lokale apo qendrore, përta përket respektimit të Kodit të Transmetimit për periudhat zgjedhore. Si i tillë, nisur dhe nga rekomandimet e lëna nga OSBE/ODIHR, për shtimin e kapaciteteve të Studios së Monitorimit në AMA, Autoriteti mori masa të menjëhershme për plotësimin e këtij rekomandimi. Në vitin 2019 u bë një investim i konsiderueshëm në teknologji, në Studion e Monitorimit të AMA-s, duke shtuar kapacitetet monitoruese si dhe ndryshimin rrënjësor të programit të monitorimit, duke futur teknologji bashkëkohore. Nëse në vitin 2018 Studioja e Monitorimit kishte kapacitet monitorues 18 programe televizive dhe 2 programe radio njëkohësisht, në vitin 2019, me modernizimin e teknologjisë, kapacitetet janë rritur ndjeshëm, duke kaluar në 48 programe televizive dhe në 12 programe radio FM

njëkohësisht. Në vitin 2019 u bënë investime edhe në kapacitet ruajtëse/arkivuese të monitorimeve të kryera. Nga 12 muaj kapacitet arkivues, sot AMA ka mundësi ruajtje të monitorimit deri në 5 vjet.

Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive gjatë viteve 2018 dhe 2019, ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh në terren, për parandalimin e piraterisë nga subjektet kabllore në vend. Nga verifikimet tona konstatohet se fenomeni i piraterisë televizive ka ardhur në rënie, falë punës së kryer nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Një situatë e tillë është përkthyer në reduktimin ndjeshëm të numrit të ankesave nga operatorët prodhues të kontentit. Nëse në vitin 2018 kishim 16 ankesa për 40 subjekte që piratonin, për vitin vitin 2019 kemi 8 ankesa për 16 subjekte në total. Kjo është një situatë e mirë për sa i përket subjekteve kabllore.

9.4.1 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Gjatë vitit 2019, AMA ka kryer në mënyrë periodike monitorimin e spektrit të frekuencave 174 - 230 MHz dhe 470 -862 MHz për shërbimet audiovizive dhe 88 -108 MHz për shërbimet audio në të gjitha pikat transmetuese të Republikës. Për pikën transmetuese Fushë-Dajt, monitorimi është kryer cdo ditë nga qendra fikse e monitorimit në AMA.

Në kuadër të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetime numerike janë kryer monitorime intensive në të gjithë Shqipërinë. Monitorime janë kryer në qarqet ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit me qëllim garantimin e vijimësisë së transmetimeve audiovizive gjatë dhe pas periudhës tranzitore të kalimit në transmetime digjitale si dhe për të garantuar mbulimin me sinjal cilësor të qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit nga operatori publik shqiptar dhe operatorët privatë kombëtarë numerike.

Gjithashtu, fokusi i monitorimeve ka qenë edhe verifikimi i mbylljes së transmetimeve analoge, mbartja e operatoreve lokale/rajonale në rrjetet kombëtare dhe përmbushja e kërkesave/kushteve të licencës nga operatorët kombëtarë numerik (realizimi i mbulimit të territorit me sinjal numerik, cilësia e sinjalit, respektimi i numrit logjik të programit etj).

Nga monitorimet e kryera në qarqet Berat, Korçë, Fier, Tiranë dhe Durrës ku tashmë janë mbyllur transmetimet analoge, ka rezultuar se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerike nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara si më poshtë:

1. SUBJEKTI RTSH

• QARKU BERAT

- Lagjet mbas kalasë së Beratit,
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë.
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çepan

• QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë

- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash

- **QARQET TIRANË - DURREËS**

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë (pjesërisht)
- Njësia administrative Cudhi

2. *SUBJEKTI “VIZION +”*

- **QARKU BERAT**

- Njësia administrative Kuçovë.
- Njësia administrative Polican.
- Njësia administrative Çorovodë

- **QARKU KORÇË**

- Njësia administrative Voskopojë.
- Njësia administrative Dardhë.
- Njësia administrative Cërravë.
- Njësia administrative Mokër.

- **QARKU TIRANË**

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë

- **QARKU DURREËS**

- Njësia administrative Krujë (pjesërisht)
- Njësia administrative Cudhi
-

3. *SUBJEKTI TV “KLAN”*

- **QARKU KORÇË**

- Njësia administrative Voskopojë.
- Njësia administrative Dardhë.
- Njësia administrative Cërravë.
- Njësia administrative Mokër.

- **QARKU TIRANË**

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)

- Njësia administrative Krrabë
 - **QARKU DURRËS**
 - Njësia administrative Krujë (pjesërisht)
 - Njësia administrative Cudhi
4. *SUBJETET TV “TOP –CHANNEL”, “DIGJITALB” DHE “ADTN”*
- **QARKU BERAT**
 - Njësia administrative Kuçovë.
 - Njësia administrative Polican.
 - Njësia administrative Çorovodë
 - **QARKU KORÇË**
 - Njësia administrative Ersekë.
 - Njësia administrative Leskovik.
 - Njësia administrative Voskopojë.
 - Njësia administrative Dardhë.
 - Njësia administrative Cërravë.
 - Njësia administrative Mokër.
 - **QARKU FIER**
 - Pjesërisht Bashkia Divjakë.
 - **QARKU TIRANË**
 - Pjesërisht Bashkia Kavajë
 - Njësia administrative Zall Bastar
 - Njësia administrative Shëngjergj
 - Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
 - Njësia administrative Krrabë
 - **QARKU DURRËS**
 - Njësia administrative Krujë (pjesërisht)
 - Njësia administrative Cudhi

Sa më sipër, AMA ka bashkëpunuar ngushtë dhe vijon bashkëpunimin me operatorët numerikë dhe në mënyrë të vecantë me operatorin publik shqiptar (RTSH) për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe të shpejta për realizimin e mbulimit të plotë të këtyre qarqeve me transmetime numerike.

Gjatë monitorime të kryera në të gjithë teritorin e vendit gjatë vitit 2019, ka rezultuar se subjektet private kombëtare TV “Top-Channel”, TV “Klan” TV “Vizion +”, Digjitalb dhe ADTN kanë filluar implementimin e rrjeteve numerike edhe në qarqet ku akoma nuk ka përfunduar procesi i

digjitalizimit. Kryesisht janë instaluar stacionet e transmetimit në Bashkitë kryesore të këtyre qarqeve dhe mbulohen me sinjal numerik edhe zonat përreth tyre.

Në qarqet ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit është kryer në menyrë periodike edhe verifikimi i subjekteve lokale/rajonale të mbartura në rrjetet numerike kombëtare (publik dhe privat). Me konkretisht rezultat e verifikimeve janë si më poshtë.

ALLOTMENTI	SUBJEKTE ANALOGE	RRJETI KU MBARTET (MUX-I)
TIRANE – DURRES	UTV	RTSH
	CLUB TV	RTSH
	SYRI TV	RTSH
	FAX NEWS	RTSH, VIZION +
	BBF	RTSH
	TV ORA NEWS	DIGJITALB
	ABC NEWS	TV KLAN
	REPORT TV	RTSH, DIGJITALB
	TV SHIJAK	RTSH
	TV KUKESI	NUK MBARTET
	TV SCAN	RTSH, KLAN
	IN TV	TOP -CHANNEL
	NEWS 24	RTSH, DIGJITALB
	TV ORA	ADTN
	A2	RTSH, TOP-CHANNEL
	PREMIUM CHANNEL	RTSH
KORCË	UTV	RTSH
	TV SOT 7	RTSH
	TV LOBI	NUK MBARTET
	CLUB TV	RTSH
	REPORT TV	RTSH, DIGJITALB
BERAT	TV BERATI	RTSH
	GLOB TV	NUK MBARTET
	TV KOMBI	NUK MBARTET
	REPORT TV	RTSH, DIGJITALB
FIER	ABC NEWS	RTSH, TV KLAN
	TV SCAN	RTSH
	NEWS 24	RTSH, DIGJITALB
	TV APOLLON	NUK MBARTET
	TV ORA NEWS	ADTN
	TV JUG	NUK MBARTET
	TV PREMIUM CHANNEL	NUK MBARTET
	TV KOMBI	NUK MBARTET
	TV ORA NEWS	DIGJITALB
	TV SHIJAK	NUK MBARTET

	IN TV	RTSH
--	-------	------

9.4.2 Inspektimi i veprimtarisë së subjekteve të licencuar/autorizuar nga AMA

Gjithashtu, Autoriteti i Mediave Audiovizive gjatë viteve 2017-2018 dhe 2019, ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh në terren për parandalimin e piraterisë nga subjektet kabllore në vend. Nga verifikimet tona konstaton se fenomeni i Piraterisë televizive ka ardhur në rënie, falë punës së kryer nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Kjo situatë reflektohet dhe nga numrin e ankesave të drejtuar institucionit. Ky numër nga viti në vit ka qënë gjithnjë e në rënie dhe konkretisht:

- viti 2017 kemi 30 ankesa për 81 subjekte
- viti 2018 kemi 16 ankesa për 40 subjekte
- viti 2019 kemi 8 ankesa për 12 subjekte

Siç shihet dhe më sipër, situata ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit.

Gjatë vitit 2019 AMA ka investuar në rritjen e kapaciteteve të studios së monitorimit dhe arkivimit të përmbajtjeve. Nëse në vitin 2018 kishim aftësi monitoruese 18 programe njëkohësisht si dhe mbajtje në arkiv të këtyre materialeve deri në 12 muaj. Ndërsa këtë vit me modernizimin e studios së monitorimit kapacitetet janë rritur në 48 programe njëkohësisht, si dhe arkivim të tyre deri në 5 vite. Ky investim ka sjellë një situatë të shkëlqyer përse i përket kthimit të përgjigjeve në kohë ndaj të gjithë subjekteve që kanë kërkuar regjistrime pranë AMA-s. Gjithashtu janë rritur dhe kapacitetet manitoruese të radio FM, nga 2 që ishin numri i tyre ka shkuar në 12 në total. Kjo në sajë të investimeve të kryera në studion e monitorimit pranë AMA-s.

Një fokus të vëçantë ka marrë dhe respektimi i të dejtës së autorit, ku AMA në rolin e këshilltarit ka informuar të gjitha subjektet e liçensuara/autorizuara pranë autoritetit, për lidhjen e marrëveshjeve me S.U.A.D.A për të drejtën e autorit. Gjithashtu AMA ka bërë një sërë takimesh me subjekte të ndryshme si dhe me entet kryesore që merren me këto të drejta si me S.U.A.D.A, Forumin e Mrojtjes së Autorëve Audiovizual, Qëndren Kombëtare të Knematografisë etj. Nga problematikat e shfaqura në këto takime, AMA vendosi që e drejta e autorit të jetë pjesë e strategjisë së ardhshme 3 vjeçare të saj, si dhe të organizojë një tryezë të përbashkët me të gjitha palet e interesuara brenda muajit mars 2020.

Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2019, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 162 kontrolle të aktivitetit audioviziv në vend, ndaj subjekteve ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA).

Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

- **19** vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, prej të cilave:

- **19** sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve (kablurë, iptv, ott); prej të cilave 5 gjoba janë shfuqizuar nga Bordi i AMA-s, pas ankimeve.
- Për **22** raste është vendosur tërheqja e vëmendjes së subjekteve OSHMA.

Përveç sa më sipër, AMA, pas verifikimeve dhe shqyrtimeve pëkatëse, ka kryer sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të **9** subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet audioviziv pa licencimin ose autorizimin e AMA-s.

Siç vihet re, në krahasim me vitet e mëparshme, aktivitet e paligjshme audiovizive, pa licencimin ose autorizimin e AMA-s janë gjithnjë në rënie.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:

VITI	INSPEKTIMET	GJOBA TOTAL (SHFUQIZUAR)	TËRHEQJE VËMENDJE	SEKUESTRIME
2016	257	58 (32)	-	23
2017	488	64 (29)	25	19
2018	224	27 (10)	49	11
2019	162	19 (5)	22	9

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit të raportimit është fokusuar në monitorimin e programeve mbi tematikën e tyre dhe respektimin e parashikimeve ligjore për transmetimin e reklamave dhe për evidentimin e volumit të reklamave në televizionet kombëtare, sikurse edhe në monitorimin e programeve të lira në platformat numerike tokësore.

Autoriteti i Mediave Audiovizive gjatë viteve 2017-2018 dhe 2019, ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh në terren për parandalimin e piraterisë nga subjektet kabllore në vend. Ankesat e drejtura autoritetit të AMA-s nga subjektet prodhues të kontentit televiziv (Digitalb dhe Tring), për vitet 2017-2018 dhe 2019 kanë qënë si më poshtë:

Viti 2017

Kompania Digitalb për vitin 2017 ka bërë **19 ankesa për 45 subjekte** në total.

Kompania Tring për vitin 2017 ka bërë **11 ankesa për 36 subjekte** në total

Viti 2018

Kompania Digitalb për vitin 2018 ka bërë **11 ankesa për 28 subjekte** në total.

Kompania Tring për vitin 2018 ka bërë **5 ankesa për 12 subjekte** në total.

Viti 2019

Kompania Digitalb për vitin 2019 ka bërë **6 ankesa për 10 subjekte** në total.

Kompania Tring për vitin 2019 ka bërë **2 ankesa për 2 subjekte** në total.

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme, fenomeni i Piraterisë televizive ka ardhur në rënie, falë punës së kryer nga Drejtoria e Mbikëqyrjes. Një tjetër dimension i rëndësishëm i punës tonë për vitin 2019 ka qenë pirateria përmes internetit. Kjo është një sfidë e re për autoritetin, duke qenë se kjo lloj teknologjie e përdorur nga ISP (internet service provider) është shumë e sofistikur dhe kërkon investime në teknologji dhe në burime njerzore të kualifikuara. Megjithatë, bashkëpunimi me institucione të tjera si AKEP, Polici e Shtetit etj, ka sjelle në bllokimin dhe sekuestrimin e 3 operatoreve ISP, si dhe vendosjen e 2 (dy) masave administrative gjobë me vlerën 5 milion lekë të reja. Megjithatë, kjo mbetet një sfidë e vazhdueshme dhe Autoriteti i Mediave ka marrë masat për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera si dhe për ta vendosur si objektiv strategjik për tre vitet e ardhshme. Në vitin e ardhshëm falë dhe memorandumit të bashkëpunimit që do të lidhet midis AMA-s dhe AKEP, ky fenomen do të ketë një qasje tjetër, duke I dhënë një impuls të ri, luftës kundër fenomeniot të piraterisë.

9.5 Autoriteti si nxitës i zhvillimit të sektorit audio/audioviziv

9.5.1 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore

Për vitin 2019, që përkonte me 20 vjetorin e institucionit, u realizuan 2 konferenca ndërkombëtare, si dhe studime e analiza mbi përshtatjen e legjislacionit shqiptar me ndryshimet e Direktivës Evropiane për Shërbimet Audiovizive, për respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar, si dhe për barazinë ligjore.

- Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, partneri strategjik i AMA-s, realizoi projektin mbi fluksin e përmbajtjeve audiovizive, nevojat e informimit të publikut, roli dhe sfidat e autoritetit rregullator. Studimi dhe analiza përfshiu prezantimin në planin mikro të aspekteve të tilla, si struktura e treguat audioviziv, diversiteti dhe pluraliteti i informacionit, kuadri legjislativ, pozicioni i mediave lokale dhe raportet e saj me median globale, transformimi i audiencave në kushtet e ndryshimeve teknologjike dhe përhapjes në shkallë të gjerë të internetit, roli dhe sfidat e transmetuesit publik etj. Produkti kryesor i projektit ishte organizimi i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, më 3 maj 2019, me rastin dhe të Ditës së Shtypit, me pjesëmarrje të studiuesve dhe kërkuesve nga vende të ndryshme, por dhe të studentëve, përfaqësuesve nga OSHMA-të, shoqatat e medias, deputetë, gazetarë etj. Studimi dhe diskutimet e Konferencës

janë përmbledhur në një botim të veçantë, që u promovua me studentët dhe pedagogët e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

- Instituti Shqiptar i Medias, ISHM, realizoi me mbështetjen dhe të AMA-s projektin me titull “Fëmijët dhe edukimi mediatik”, i cili, në bosht, kishte dy aspekte: së pari, për të vlerësuar nivelin e mbrojtjes së fëmijëve në produktet audiovizive dhe si trajtohen problematikat e tyre, dhe së dyti, të ndikojë në procesin e edukimit mediatik të gjenerata e re, temë e ndjeshme kjo ku janë të angazhuara dhe institucionet rregullatore të tregut audioviziv në vende të ndryshme. Në mes të muajit maj 2019, ISHM, në kuadër të këtij projekti, organizoi, në Tiranë, një konferencë ndërkombëtare mbi fëmijët në median audiovizive si dhe edukimin mediatik, me pjesëmarrje të ekspertëve vendas dhe të huaj. Studimi i ISHM-së, në kuadër të projektit, është publikuar si botim më vete; gjithashtu, subjekti ka publikuar dhe një botim në formën e udhëzuesit mbi këto aspekte për t’ua shpërndarë redaksive audiovizive.

9.5.2 Aktivitetet e zhvilluara nga Autoriteti

i) Në muajin korrik 2019, grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve” në Kuvendin e Shqipërisë, në bashkëpunim me AMA-n, organizuan tryezën me temë “Fëmijët në median audiovizive”. Në këtë tryezë, Këshilli i Ankesave, pasi prezantoi studimin me temë “*Mbrojtja e fëmijëve, në fokusin kryesor të AMA-s*”, shpjegoi arsyet pse fëmijët, mbrojtja dhe interesi më i lartë i tyre janë prioritet i punës së Autoritetit dhe Këshillit. Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ishte krijimi i një hapësire të dobishme për të diskutuar me të gjithë grupet e interesit, mbi aspekte të mbulimit të problematikave që lidhen me raportimin e fëmijëve në median audiovizive.

ii) Në fillim të muajit tetor 2019, AMA zhvilloi konferencën mediatike “Radiot fetare në gjuhën shqipe”, ku ishin ftuar rreth 100 përfaqësues nga radiot fetare, ekspertë dhe studiues të medias, deputetë dhe drejtues të institucioneve publike, klerikë të religjioneve, gazetarë etj. Të pranishmit kanë vlerësuar kontributin e radiove fetare të komunitetit, të cilat përbëjnë një segment të tregut audioviziv, që dallon nga pjesa tjetër, për qëndrueshmërinë e aktivitetit, vullnetarizmin e angazhimit të stafit në redaksi dhe për sasinë dhe larminë e temave që përgatiten nga vetë radioja. Këto radio janë refleksion i tolerancës dhe bashkëjetesës mes besimeve të ndryshme në vendin tonë dhe konferenca shërbeu si prezantim i rolit dhe ndikimit të tyre pozitiv në shoqërinë tonë multifetare, angazhimin për produkte cilësore dhe pasurimin me më shumë pozitivitet të besimit fetar brenda dhe jashtë objekteve të kultit.

Për herë të parë, transmetimet me përmbajtje fetare, nga publiku shqiptar, janë ndjekur prej 3 tetorit të vitit 1951, me fillimin nga puna të seksionit shqip të Radio Vatikanit. Megjithëse aktiviteti fetar dhe liria e ushtrimit të besimit kanë qenë të ndaluara në Shqipërinë komuniste, sërish ka pasur shumë dëgjues të Radio Vatikanit që ndiqnin fshehurazi programet e saj.

Pas miratimit të ligjit për mediat audiovizive, të vitit 2013, AMA ka miratuar akte nënligjore që kanë bërë të mundur qartësimin e procedurave të licencimit të tyre, duke e konsoliduar këtë pjesë të tregut audioviziv, në shërbim të komuniteteve fetare dhe ndjekësve të transmetimeve të tyre. Aktualisht, operojnë katër subjekte, radio Spektrum e komunitetit mysliman, Radio Maria e besimit katolik, Radio Ngjallja e kishës ortodokse dhe Radio Dodona e Kryegjyshit Bektashian.

iii) Autoriteti i Mediave Audiovizive, në kooperim me Fondacionin gjerman “Konrad Adenauer”, zyra për Shqipërinë dhe Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, kanë realizuar projektin “Mediat dhe fushata për zgjedhjet vendore 2019”. Në 9 takime që u zhvilluan në qarqet Shkodër, Gjirokastër, Elbasan, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Kukës dhe Peshkopi u përfshinë rreth 150 gazetarë, pjesa më e madhe e tyre nga redaksitë audiovizive. Në Tryezat e Diskutimit që u zhvilluan u trajtuan aspekte të tilla si specifikat e zgjedhjeve vendore 2019, në një kontekst të veçantë të zhvillimeve politike në vend; mbulimi mediatik i fushatave vendore - raportimi vs. marrëdhëniet me publikun; kërkesat ligjore dhe roli i rregullatorit audioviziv në mbulimin e procesit zgjedhor nga radiot dhe televizionet; redaksitë audiovizive, si dhe kultura, politika dhe media vendore.

iiii) Në muajin mars 2019, Këshilli i Ankesave organizoi tryezën e diskutimit “Zbatimi i Kodit të Transmetimit dhe roli i Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave”, me mbështetjen e Zyrës së Evropës në Tiranë. Pjesë e kësaj Tryeze ishin vetë Bordet e Shqyrtimit të Ankesave në televizionet kombëtare dhe lokale, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, të Institutit Shqiptar të Medias, studentë të gazetarisë etj. Për të ndarë përvojën e një procesi të gjerë, si ai i trajtimit të ankesave dhe marrjen e një vendimi, e ftuar në këtë aktivitet ishte edhe zonja Asja Zuzevic, një nga drejtueset e Autoritetit Rregullator të Bosnje Hercegovinës. Qëllimi i këtij diskutimi, që pasonte miratimin e rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, si dhe të udhëzimit përkatës “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv” (hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2018), ishte njohja me këto dy akte të rëndësishme, zbatimin e tyre, problemet e hasura dhe zgjidhjet e tyre, në bashkëpunimin me Këshillin e Ankesave. Gjatë diskutimeve, u vlerësua praktika e deritanishme e trajtimit të ankesave, fakt që Këshilli e evidentoi si një zhvillim pozitiv, përfshirë dhe reagimin e OSHMA-ve për zbatimin sa më të mirë të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

10 DIGJITALIZIMI I TRANSMETIMEVE AUDIOVIZIVE

Fokusi, gjatë vitit 2019, sa i takon procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, ka qenë finalizimi i këtij procesi në dy qarqet me popullsi më të madhe në vend, në qarqet Tiranë dhe Durrës. AMA e konsideron sfidë dhe arritje finalizimin e këtij procesi më 1 tetor 2019, duke pasur parasysh problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar si dhe impaktin që do të sillte ky proces te publiku shqiptar. Aktualisht për qytetarët e këtyre qarqeve ofrohen 39 kanale të lira (pa pagesë), më shumë se në çdo vend tjetër të rajonit.

Operatori publik shqiptar (RTSH) ka shtruar infrastrukturën digjitale në të gjithë vendin dhe operatorët privatë numerikë kanë implementuar rrjetet e tyre në pjesën më të madhe të qarqeve të mbetura.

Si rezultat, mbi 80% e popullsisë në vend, tashmë akseson transmetimet televizive digjitale, të cilat sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër më të madh programesh televizive pa pagesë.

Në mbështetje të operatorëve lokalë/rajonale audiovizive është miratuar ligji 34/2017 për kompensimin e pjesshëm të tyre, lidhur me tarifën e mbështetjes në një nga rrjetet kombëtare numerike. AMA ka vijuar zbatimin e këtij ligji për operatorët, që ofrojnë shërbime audiovizive në zonat ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit, duke lehtësuar në këtë mënyrë tranzicionin e tyre në teknologjinë e re.

Rëndësi të veçantë, lidhur me këtë proces, i është dhënë edhe organizimit të fushatës së informimit të publikut. Gjatë vitit 2019, në zbatim edhe të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës, fushata e ndërgjegjësimit është diversifikuar me qëllim që të jetë sa më e qartë dhe më e kuptueshme për qytetarët (spot i publikuar në 14 portale online, spote publicitare në radio dhe TV, City Lights, Billboard).

10.1 Administrimi i procesit të kalimit në transmetimet numerike

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s të përcaktuara në ligjin 97/2013, Strategjinë për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik të AMA-s, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2019, AMA është angazhuar maksimalisht dhe ka ndërmarrë një sërë veprimtarish lidhur me procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.

Koordinimi i vazhdueshëm, në kuadër të implementimit të dy rrjeteve numerike të operatorit publik shqiptar (RTSH) dhe 5 rrjeteve numerike të operatorëve privatë kombëtarë të licencuar nga AMA, ka zënë një vend të rëndësishëm në këto aktivitete. Janë zhvilluar takime dhe vendosur korrespondenca të vazhdueshme me këta operatorë lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve, sipas grafikut të “ishujve numerike”, mbi përcaktimin e kushteve dhe kritereve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonale, mbi mbulimin me sinjal numerik cilësor të territorit, mbi respektimin e numrit logjik të programeve të tyre etj.

AMA ka koordinuar punën edhe me operatorët analogë lokalë/rajonale, në kuadër të përmbushjes së afateve për mbështetjen e programeve të tyre audiovizive në rrjetet kombëtare numerike, si dhe gjetjen e zgjidhjeve teknike efektive për të realizuar këtë mbështetje.

Në zbatim të kuadrit rregullator, Autoriteti duhet të sigurojë vijimësinë e transmetimeve televizive nga operatorët ekzistues analogë, në zonat respektive të mbulimit. Në dispozitat kalimtare të ligjit nr.

97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet edhe vlefshmëria e licencave ekzistuese, me qëllim harmonizimin e të drejtave dhe detyrimeve të këtyre subjekteve me dispozitat e ligjit, pas mbylljes së transmetimeve analoge.

Një nga mundësitë që i njeh ligji kësaj kategorie subjektsh është mbështetja e programeve analoge ekzistues vendorë në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike. Zëvendësimi i licencave të transmetimit mbështetur në rrjet analog me licencë shërbimi programi audioviziv ndërvaret me datën e mbylljes së transmetimeve analoge, në qarqet ku këto subjekte ushtrojnë aktivitet.

AMA, pas depozitimit të kontratave të mbështetjes dhe fillimit të ofrimit të shërbimit në teknologjinë numerike, ka zëvendësuar licencat për 13 subjekte audiovizivë. Licencat e shërbimit të programit audioviziv janë lëshuar me afat 8-vjeçar, duke qenë në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të procesit të digjitalizimit kanë sjellë progres në procesin e implementimit të rrjeteve numerike, si dhe në procesin e mbylljes së transmetimeve analoge, në të gjithë vendin.

Operatori publik shqiptar (RTSH) ka shtruar infrastrukturën digjitale në të gjithë vendin dhe operatorët privatë numerikë kanë implementuar rrjetet e tyre në pjesën më të madhe të allotmenteve të mbetura. Tashmë rreth 80% e popullsisë ka mundësi të aksesojë transmetimet digjitale audiovizive.

Sa i takon mbylljes së transmetimeve analoge, bazuar në strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në transmetime digjitale, procesi i digjitalizimit zhvillohet me faza. Çdo fazë parashikon mbylljen e transmetimeve analoge në një allotment (çdo allotment përkon me një qark të vendit, me përjashtim vetëm të allotmentit të Tiranës i cili përmban qarqet Tiranë dhe Durrës). Aktualisht procesi ka përfunduar në 5 qarqe: Berat, Korçë, Fier, Tiranë dhe Durrës përkatësisht në datat 15 gusht 2017, 08 janar 2018, 31 mars 2018 dhe 01 tetor 2019. Në këto qarqe, operatorët lokalë/rajonale kanë mbështetur programet e tyre, kryesisht, te rrjeti numerik i RTSH-së. Procesi i digjitalizimit po vijon me qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë, ku afati i mbylljes së transmetimeve analoge është përcaktuar, me vendim të bordit të AMA-s, më 31 mars 2020.

Ndërkohë, theksojmë se procesi i mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, ka qenë një sfidë dhe arritje për AMAn, duke qenë se në këto qarqe ishte përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë.

Gjatë vitit 2019, duke mbajtur parasysh situatën e krijuar në datën 10 shtator 2018 kur u mbyllën transmetimet analoge në këto qarqe si dhe me qëllim finalizimin e procesit të digjitalizimit në qarqet Tiranë, Durrës, AMA ka ndërmarrë aktivitetet si më poshtë:

- Ka kryer sondazhe periodike nëpërmjet qendrës Call Center, duke intervistuar, përmes telefonave fiks, afërsisht 1600 familje, në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, me qëllim identifikimin e nevojave për pajisje marrëse në treg. Janë zhvilluar 2 sondazhe me qëllim krahasimin e të dhënave statistikore të marra gjatë muajve të anketimit. Në bazë të sondazheve ka rezultuar se, në korrik 2019, rreth 16 % e popullsisë nuk ishte e pajisur me dekoder DVB-T2 (shifër pothuajse e njëjtë në të dy sondazhet). Ndarja e kampionit është kryer duke konsideruar peshën e popullsisë në qarqet përkatëse. Kjo shifër konsiderohej të ishte akoma më e lartë, pasi qytetarët e pajisur me telefoni fikse janë më të shumtë në zonat urbane se ato rurale. Ndërkohë zonat rurale janë më të ekspozuara ndaj mbylljes së transmetimeve analoge pasi, përveç faktorëve ekonomiko-socialë, aksesit në programet televizive është kryesisht nëpërmjet teknologjisë tokësore.
- Ka kërkuar, në rrugë zyrtare (me shkresën e datës 4 janar 2019) informacion nga disa operatorë tregtarë, lidhur me numrin e aparateve televizive dhe dekoderave të sistemit DVB-T2, të importuar gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2018 dhe numrin gjendje të tyre. Informacioni i është kërkuar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Gjithashtu i ka kërkuar informacion edhe operatorëve audiovizivë që tregtojnë dekodera, lidhur me numrin e dekoderave të shitur dhe gjendjen në magazinat e tyre.
- Në zbatim të rekomandimit të Autoritetit të Konkurrencës, dhënë me vendimin nr. 547, datë 24.09.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës gjatë procesit për digjitalizimin e transmetimeve audiovizive”, AMA angazhoi një ekspert të jashtëm për ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit, etj. në mënyrë që procesi i mbylljes së programeve (kanaleve) analoge dhe kalimi në transmetimet numerike të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët.
- Bazuar në Strategjinë e Komunikimit për fushatën e kalimit në transmetimet numerike, të hartuar nga eksperti i kontraktuar, përveçse u përgatitën spote të reja, fushata e informimit u diversifikua duke u kryer edhe outdoor nëpërmjet vendosjes së billboard-eve dhe City lights në pika kyce të qyteteve Tiranë, Durrës.

Në sajë të aktiviteteve të sipërpërmendura, u bë e mundur mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës ku ndodhet rreth 1/3 e popullsisë së vendit, më datë 1 tetor 2019. Aktualisht në këto qarqe ofrohen 39 kanale televizive të lira (pa pagesë).

Ndërkohë, AMA, me Vendim nr.179, datë 25.11.2019, ka përcaktuar vijimin e procesit të digjitalizimit në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë, duke marrë në konsideratë që infrastruktura digjitale është shtruar në bashkitë kryesore të këtyre qarqeve. Afati i përcaktuar për mbylljen e transmetimeve analoge në këto qarqe është data 31 mars 2020.

Në përmbushje të këtij afati dhe në zbatim të vendimit të sipërcituar AMA ka vijuar:

- Koordinimin me operatorët audiovizivë kombëtarë, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për instalimin e pikave të mbetura të transmetimit në këto allotmente dhe mbulimin e plotë të territorit të këtyre qarqeve me sinjal numerik;
- Koordinimin me operatorët audiovizivë lokalë/rajonale, me qëllim mbështetjen e programeve të tyre në rrjetet kombëtare numerike.
- Vlerësimin mbi pajisjen e banorëve të këtyre qarqeve me pajisje marrëse DVB-T2.
- Organizimin dhe vijimin e fushatës së informimit të publikut në këto allotmente.
- Monitorimin në terren për verifikimin e mbulimit me sinjal numerik të këtyre qarqeve.

Në lidhje me këtë proces, AMA, me shkresën nr. 3128 prot., datë 04.09.2019, ka përcjellë zyrtarisht pranë Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së linjës, shqetësimin lidhur me mosfunksionimin e Komitetit Ndërinstitucional, si dhe Sekretariatit Teknik, struktura, që sipas VKM nr. 292/2012, janë të ngarkuara për implementimin e strategjisë dhe ndjekjen e të gjithë procesit të digjitalizimit, deri në kalimin e plotë në transmetimet numerike.

Në vijim të shkresës së AMA-s, Kryeministria është duke koordinuar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për përgatitjen e urdhrat për riaktivizimin e këtyre strukturave.

10.2 Mbështetje nga projekti i Bankës Botërore

Lidhur me procesin e digjitalizimit, shënojmë se Banka Botërore ka ofruar mbështetje për AMA-n nëpërmjet projektit “Mbi mbështetjen në procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, për vendet në zhvillim”.

Ky projekt përfshinte tre komponentë të rëndësishëm:

- Vlerësimi i situatës aktuale të tregut audioviziv në Shqipëri;
- Ofrimi i asistencës teknike (hartimi i një plani për vijimin e procesit të digjitalizimit, asistencë lidhur me menaxhimin e frekuencave, dividendin digjital etj.);

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore.

Projekti do të financohej nga Banka Botërore sa i takon dy pikave të para dhe do të bashkëfinancohej nga Banka Botërore dhe Institucioni për Programin e Shpërndarjes së Njohurive të Qeverisë Koreane (KSP) sa i takon ngritjes së kapaciteteve njerëzore.

Në kuadër të këtij projekti, AMA priti në ambientet e saj, në mars 2019, misionin e parë të angazhuar për realizimin e tij. Misioni përbëhej nga përfaqësues të Bankës Botërore, Institucionit për Programin e Shpërndarjes së Njohurive të Qeverisë Koreane (KSP) dhe Shoqatës së Promovimit të Radio-s së Koresë (RAPA).

AMA informoi misionin mbi situatën aktuale të tregut audioviziv në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë mbi procesin e digjitalizimit, sfidat nëpër të cilat ka kaluar ky proces. Mes palëve u shkëmbye informacioni bazë, si dhe u paraqitën nevojat lidhur me ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe asistencën teknike që pritet të përfitohet nga ky projekt. Në fund të takimit palët firmosën dhe një memorandum mirëkuptimi.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, përfaqësuesit e Bankës Botërore, KSP-së dhe RAPA-s zhvilluan takime me Ministrinë e linjës dhe me operatorët numerikë kombëtarë publikë dhe privatë.

Në kuadër të këtij projekti, në datat 1- 5 korrik 2019, si dhe 23-27 shtator, u organizuan, në Seul, trajnimi i parë dhe i dytë mbi ngritjen e kapaciteteve njerëzore të tre shteteve palë të këtij projekt, Shqipëri, Kosovë dhe Senegal. Gjithashtu u konsultua draft raporti i përgatitur nga përfaqësuesit e BB dhe RAPA, ku pala shqiptare sugjeroi ndryshime dhe përmirësime të tij mbi vlerësimin e situatës aktuale të procesit të digjitalizimit të vendin tonë, problematikat e lindura nga ky proces dhe propozimin e disa opsioneve për zgjidhjen e tyre. Disa nga çështjet për të cilat u kërkuan rekomandime ishin: organizimi në mënyrë sa më efektive i fushatës së informimit publik, identifikimi i nevojave për dekodera në treg dhe sigurimi i tyre nga ana e operatorëve ekonomikë, zgjidhje teknike për lirim të brezit DD2 etj. Lidhur me procesin e lirim të brezit DD2, u kërkua që konsulentët të përgatisin edhe një udhëzues (roadmap) me detyra të përcaktuara qartë për çdo institucion të përfshirë në këtë proces, si dhe ky dokument të shoqërohet me elementët që mund të përfshihen në të, si p.sh., modele mbi skemën e kompensimit financiar; negociim me operatorët për gjetjen e zgjidhjeve më të mira teknike/ligjore; sugjerime mbi ndryshimet në paketën ligjore në fuqi etj.

AMA, pasi është njohur me draftin final të dokumentit “Mbi mbështetjen në procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, për vendet në zhvillim”, të përgatitur nga ekspertët e BB dhe RAPA, ka përcjellë komentet dhe sugjerimet e saj lidhur me gjetjet dhe propozimet e këtij dokumenti. Jemi në pritje të raportit final që do të paraqitet nga konsulentët.

10.3 Fushata e informimit të publikut

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike përcakton AMA-n si autoritetin përgjegjës për realizimin e fushatës së informimit të publikut. Duke qenë se procesi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është jo vetëm një proces prioritar, për të gjitha vendet evropiane, pjesë e BE ose jo, por mbi të gjitha është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare, AMA, prej muajit prill të vitit 2016, por edhe gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 ka vënë në dispozicion numrin e Call Center (04-410-44-55 dhe 04-410-44-56).

Këto dy numra janë në dispozicion të të gjitha pyetjeve të qytetarëve apo operatorëve nga ora 9.00 deri në orën 21.00, nga e hëna në të shtunë.

Gjithashtu, në rubrikën “Digjitalizimi” në faqen zyrtare online të institucionit, gjatë vitit raportues, AMA ka vijuar me publikimin e njoftimeve dhe ka mbajtur të informuar në kohë reale të gjitha palët e interesuara në lidhje me kuadrin rregullator, planin numerik frekuencor, të dhëna të përgjithshme mbi procesin, broshurën dhe fletëpalosjen e përgatitur nga AMA për digjitalizimin, kontaktet e strukturës Call Center, linkun që të çon direkt në faqen e rrjetit social facebook të AMA-s, reklamat dhe të gjitha intervistat e emisioneve speciale mbi digjitalizimin e transmetimeve audiovizive të realizuara nga stafi i AMA-s.

Në adresën zyrtare të Autoritetit info@ama.gov.al kanë ardhur kërkesa të ndryshme nga qytetarë në lidhje me digjitalizimin e transmetimeve. Sipas specifikës së pyetjes, stafi AMA-s është munduar t’i asistojë dhe t’u japë përgjigje në kohë reale.

Në kuadër të fushatës informuese, AMA ka vijuar duke mbajtur të informuar publikun edhe nëpërmjet llogarisë së saj në *facebook* “Autoriteti i Mediave Audiovizive – Digjitalizimi”, ku publikohen të gjitha informacionet në lidhje me procesin, si për kuadrin ligjor, ashtu edhe për informacione praktike në lidhje me procesin.

Gjithashtu, bazuar në planin e shtrirjes së transmetimeve digjitale, AMA njofton me spote televizive për shtrirjen e procesit dhe masat që duhet të marrin përdoruesit e mediave audiovizive për të vijuar shikimin e transmetimeve audiovizive.

AMA, gjatë muajit shkurt 2019, ka realizuar gjashtë spote të reja (ku njëri prej spoteve është nëndarë në 4 spote të ngjashme në përcjelljen e mesazhit) me karakter informativ, të cilat përthithen më thjesht nga publiku. Ato janë ndërtuar me gjuhë të thjeshtë, ilustrime praktike, imazhe mbi teknologjinë që duhet përdorur, me grupmosha të caktuara fëmijë/të rritur dhe aktorë. Këto spote janë të vendosura në faqen zyrtare dhe në rrjetin social të AMA-s, si dhe janë transmetuar në televizionet/radiot kombëtare dhe lokale për një muaj (shkurt – mars 2019) me fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit në vitin 2018. Ndërkohë, me fondin e dytë të akorduar nga Buxheti i Shtetit prej 40 milion lekë në vitin 2018, AMA ka zhvilluar fushatën e informimit të publikut sipas Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike, për periudhën dhjetor 2018 – mars 2019 (3 muaj).

Duke filluar nga data 1 mars 2019, AMA, bazuar në projekt buxhetin e saj për vitin 2019, ka publikuar në 14 portale *online*, banerin reklamues, i cili informon qytetarët mbi afatin e kalimit në transmetimet analoge (për qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë) *linku* i së cilës të lidh direkt me faqen zyrtare të AMA, pjesa e Digjitalizimit, ku qytetarët gjejnë të gjithë informacionin mbi procesin. Kjo fushatë nëpër portalet *online* ka vijuar për një periudhë 6 mujore.

Në vijim të kësaj fushate, AMA, prej datës 1 qershor 2019, ndërmori edhe fushatën “outdoor”, siç është përdorimi i hapësirave të reklamimit/vizibilitetit të jashtëm përmes platformave “City lights” në qarqet Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë, dhe përmes BillBoards në qarkun Tiranë, qarqe ku ende nuk kishte përfunduar procesi i digjitalizimit. Kjo fushatë u krye me qëllim për të informuar banorët mbi afatin e kalimit në transmetimet analoge në qarkun përkatës ku priten të mbyllen këto transmetime, si dhe paraqitjen e kontakteve për të gjithë banorët e këtyre 6 qarqeve mbi procesin e digjitalizimit, ku mundet të drejtohen për të marrë informacion më të detajuar dhe praktik mbi procesin.

AMA ka kërkuar akordim fondesh në vitin 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për vijimin e fushatës së informimit të publikut sipas strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetime numerike, pra përmes blerjes së kohës televizive dhe radiofonike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson se procesi duhet të ndiqet dhe trajtohet prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si ministria përgjegjëse. MFE ka dërguar shkresë në MIE dhe për dijeni AMA-n për kryerjen e një analize juridike dhe financiare, ku MIE i kërkohet të iniciojë dhe shqyrtojë tejkalimin e afateve të përcaktuara për përmbylljen e transmetimeve analoge dhe të zhvillimit të fushatës së informimit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e datës 14 qershor 2019, drejtuar MFE dhe, për dijeni, Kryeministrisë dhe AMA-s, propozon që në kuadër të shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjes së financimit të fushatës, por dhe të gjithë procesit të digjitalizimit në tërësi të organizohet një tryezë e përbashkët MFE, AMA dhe MIE.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, më datë 19 qershor 2019, i është drejtuar MIE dhe AMA-s, ku shprehet se Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit, nuk mundëson dot mbulimin e efektit financiar të kërkuar nga AMA për vijim e fushatës së informimit të publikut. MFE sugjeron që fushata të vijojë përmes fondeve të AMA-s, fondeve të miratuara për MIE, në buxhetin e vitit 2019.

AMA, në kushtet e mosfinansimit nga buxheti i shtetit për vitin 2019, vijoi fushatën e informimit të publikut sipas Strategjisë së mbylljes së transmetimeve analoge dhe kalimin në transmetime numerike, pas datës 15 mars 2019.

Për sa më sipër, AMA, në qershor 2019, ndërmori një ndryshim në vendimin nr. 202, datë 24.12.2018 “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2019”, duke bërë rialokim fondesh të parashikuara për disa zëra shpenzime dhe investime. Me ndryshimin e bërë në projektbuxhet, u caktua një fond për të kryer

fushatën e informimit sipas Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetime numerike, përmes transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike (të realizuara në shkurt 2019), për periudhën 16 korrik–31 gusht 2019, mbi procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, më datën 1 shtator 2019.

Pas shtyrjes së afatit të mbylljes së transmetimeve analoge me 30 ditë, në qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, me vendimin nr. 118, datë 29.08.2019, AMA vijoi fushatën përmes faqes zyrtare të AMA-s, rrjetit social *facebook*, strukturës call center, si dhe ka qenë në gatishmëri për çdo ankesë/shqetësim të ardhur pranë AMA-s, në lidhje me procesin.

Ndërkohë, AMA, me vendimin nr. 179, datë 25.11.2019, ka përcaktuar si afat për kalimin në transmetimet numerike në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë, datën 31 mars 2020. Në kushtet e mosfinancimit nga buxheti i shtetit, AMA ka parashikuar të kryejë fushatë të informimit të publikut me fondet e veta, për periudhën deri në mbylljen e transmetimeve analoge në këto qarqe.

Bazuar në Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, si dhe Strategjinë e Komunikimit, AMA ka parashikuar që fushata e informimit të publikut të realizohet përmes transmetimit të spoteve në televizionet dhe radiot kombëtare si dhe në website-et kryesore në vend (në portalet online).

Theksojmë se AMA do të vijojë me informimin e publikut mbi procesin dhe zhvillimet e tij, deri në momentin kur transmetimet analoge të mbyllen në të gjithë territorin e vendit.

10.4 Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit

Gjatë vitit 2019, u bë i mundur plotësimi i kuadrit nënligjor të nevojshëm, duke bërë të mundur zbatimin e ligjit nr. 34/2017 “Për lirim të frekuencave të Digjital Dividendit”, të ndryshuar.

Ky ligj zbatohet për mbulimin e pjesshëm të kostove neto shtesë, që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike dhe që përfshijnë:

1. tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues analogë lokalë/rajonale në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit për median audiovizive;
2. investime të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji për mediat audiovizive;
3. investime të kryera nga operatorët privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analog në numerik, siç kërkohet nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve TV, transmetuar nëpërmjet rrjeteve tokësore edhe pas kalimit të plotë në transmetimet numerike, nëpërmjet kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë që shkakton kalimi nga transmetimet

analoge në ato numerike. Gjithashtu, synon të krijojë kushtet lehtësuese për operatorët privatë historikë kombëtare, operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike, si dhe operatorët ekzistues analogë për shkak të kalimit në transmetimet numerike.

Referuar parashikimeve të ligjit nr. 34/2017, cituar më sipër, AMA me përfundimin e procesit të dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave të Dividendit Numerik 1, procedoi me miratimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor, për të vënë në zbatim këtë ligj. Konkretisht:

- Vendimin nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Digjital-Dividendit” të ndryshuar”.
- Vendimin nr. 39, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorëve privatë historikë kombëtarë që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Digjital-Dividendit” të ndryshuar”.
- Vendimin nr. 40, datë 07.03.2019 “Për miratimin e kritereve për ndarjen e kompensimit financiar të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorëve privatë historikë kombëtarë”, i cili u pasua me miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit nr. 240, datë 04.04.2019.

AMA, për të bërë të mundur zbatimin e plotë të ligjit, ka mbajtur komunikim shkresor edhe me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si autoriteti i ngarkuar për organizimin e procedurës së tenderit për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) për shfrytëzim nga rrjetet numerike të lëvizshme.

Po ashtu, AMA, në cilësinë e autoritetit zbatues të ligjit nr. 34/2017, ka ndjekur procedurat ligjore për marrjen e autorizimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, i cili me Vendimin nr. 89, datë 23.04.2019, ka vendosur: autorizimin e zbatimit të skemës së ndihmës shtetërore.

AMA-s, në vitin 2019, në zbatim të ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Digjital Dividendit”, të ndryshuar, si dhe kuadrit nënligjor të mësipërm, iu kalua fondi prej 5,000,000 euro për mbulimin e pjesshëm të kostove neto shtesë që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike.

AMA, gjatë vitit 2019, ka realizuar kompensimin financiar për 2 operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike dhe 2 operatorët privatë historikë kombëtarë.

Gjithashtu, filloi kompensimin financiar për operatorët ekzistues analogë lokalë/rajonale, që janë mbështetur në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara sipas ligjit për median audiovizive, për allotmentet Berat, Korçë, Fier dhe Tiranë (qarqet Tiranë-Durrës), në masën 53,87% të pagesave të kryera për 1 vit. Deri në fund të vitit 2019, kanë paraqitur dokumentacion e

kërkuar, kanë përmbushur kërkesat ligjore për përfitimin e kompensimit financiar, dhe më tej janë kompensuar nga AMA, 8 subjekte audiovizive analoge lokale/rajonale.

11 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2019, si dhe në mbështetje të funksioneve të tij për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të misionit, ka ndërmarrë disa iniciativa për të rritur bashkëpunimin dhe komunikimin me institucione të tjera shtetërore. Duke konsideruar se bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes AMA-s dhe këtyre institucioneve do të përmirësojë standardet dhe kushtet për një treg audioviziv të lirë dhe efektiv në përputhje me standardet evropiane, AMA ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi. Këtij qëllimi i ka shërbyer marrëveshja e bashkëpunimit me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e veprimtarisë së institucionit, përsa i përket reklamave si dhe përmirësimit të standardeve për një treg audioviziv të lirë, në përputhje me standardet evropiane.

Një bashkëpunim i frytshëm i Autoritetit të Mediave dhe Inspektoriatit të Punës ka konsistuar në finalizimin e një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore për kushtet e punës, për mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat si dhe sigurimin e mirëqenien në sektorin e mediave audiovizive.

Gjithashtu, marrëveshja e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për krijimin e “Aleancës kundër urrejtjes”, me objekt të veprimtarisë së saj ngritjen e vetëdijes, informimin dhe kontribuimin në dialogun, veçanërisht midis të rinjve, për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes dhe krijimin e urave të dialogut dhe bashkëveprimit me shoqërinë civile dhe organet publike do të promovojë lirinë e shprehjes në shoqërinë demokratike, duke lehtësuar një debat të hapur dhe sensibilizues për publikun, për promovimin e lajmit në mënyrë korrekte dhe të drejtë.

Bashkëpunimi i AMA-s me autoritete homologe në kuadër të shkëmbimit të informacionit në fushën e komunikimeve elektronike dhe mediave audiovizive ka bërë të mundur nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi me Agjencinë për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Malit të Zi (EKIP).

Digjitalizimi i bazës së të dhënave të ofruesve të shërbimeve mediatike dhe audiovizive.

AMA ka krijuar një sistem të dhënash me informacion të detajuar rreth operatorëve audio dhe audiovizivë, të dhënat e tyre, që prej kohës së krijimit të tyre si dhe vendimit e Autoritetit, duke i përmbledhur ato në një mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm ky informacion, nga punonjësit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale. Krijimi i këtij sistemi digjital përbën një ndryshim në shkëmbimin e informacionit ndërmjet njësisë organizative brenda institucionit, duke lehtësuar komunikimin, dhe siguruar vërtetësinë e informacionit në kohë reale.

11.1 Organizimi i brendshëm i institucionit

AMA, në zbatim të detyrimeve të saj ligjore mbi konfliktin e interesave, ka zbatuar Kodin e Etikës të Punonjësve të Administratës së AMA-s dhe gjithashtu, Kodin e Sjelljes së AMA-s, i cili përcakton procedurat dhe parimet e përmbledhura me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 si dhe parimeve që zbatohen dhe udhëheqin veprimtarinë e anëtarësisë, zëvendëskryetarit dhe Kryetarit të AMA-s, gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksioneve, që u njeh ligji.

Gjatë periudhës raportuese janë ndjekur dhe zbatuar detyrimet ligjore, që lidhen me identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave. AMA ka vënë në dijeni Kuvendin e Republikës së

Shqipërisë, Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e organit kompetent për emërimin dhe lirimin e anëtarëve të AMA-s, mbi rastin e një prej anëtarëve të AMA-s, i cili mendohej se ishte në kushtet e papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 82/2019 ka liruar nga detyra anëtarin.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar në total 19 mbledhje. Deri në muajin shtator 2019 mbledhjet kanë qenë me pjesëmarrje të plotë të të gjithë anëtarëve të mandatuar të AMA-s. Në muajin tetor 2019, njëri prej anëtarëve z. Piro Misha dha dorëheqjen nga pozicioni i anëtarit. Ndërsa në muajin korrik 2019, Kuvendi shkarkoi nga detyra anëtarin e AMA-s, z. Zylyftar Bregu. Prej muajit korrik mbledhjet e Autoritetit janë zhvilluar me pjesëmarrjen e pesë anëtarëve.

Në aktivitetin e AMA-s, në vitin raportues, elementet si kuadri institucional, vendimmarrja dhe zbatueshmëria e vendimmarrjes janë tashmë të rregulluara dhe të përcaktuara në ligjin për mediat, duke siguruar kështu pavarësi institucionale të Autoritetit në qeverisjen e tij.

Ndjekja me rigoroze të udhëzimeve, që kanë të bëjnë me vendosjen e rregullave të brendshme të institucionit, miratuar me aktet nënligjore respektive dhe zbatimi efektiv i tyre, kanë rritur dukshëm përgjegjësinë për dhënien e kontributit në mbarëvajtjen sa më të mirë të institucionit, me qëllim final zbatimin me sukses të misionit të AMA-s.

Autoriteti, si institucion rregullator në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, është në angazhim të plotë për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe akteve nënligjore, të cilat garantojnë një treg të qëndrueshëm, të shumëllojshëm, në plotësim të nevojave të qytetarëve për t'u informuar.

11.2 Programi i transparencës

Si një institucion i pavarur publik Autoriteti i Mediave Audiovizive funksionon në përputhje me standardin e transparencës, duke siguruar gjatë veprimtarisë së saj zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit 119/2014, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ushtrimi i të drejtës së paraqitjes së padisë, si mjet juridik që i mundëson subjektit të së drejtës, të drejtën e garantuar me ligj, ta mbrojë përmes rrugës gjyqësore, ka bërë që autoriteti të jetë palë në procese gjyqësore si në cilësinë e palës së paditur ashtu edhe të palës paditëse. Po ashtu, referuar mjeteve procedurale ligjore, AMA është paraqitur pranë gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

Vendimet administrative të kundërshtuara kryesisht lidhen me miratimin e sanksioneve administrative (gjoba), mosdhënien/mos rinovimin e licencave/autorizimeve, heqjen apo pavlefshmërinë e tyre etj. AMA, si person juridik publik, ka investuar në disa raste organet gjyqësore duke kërkuar gjyqësisht shlyerjen e detyrimeve financiare të subjekteve që rezultojnë debitorë ndaj AMA-s ose buxhetit të shtetit.

Si në vitet e kaluara edhe gjatë këtij viti, ekzekutimi i vendimeve të AMA-s të shndërruara në tituj ekzekutive, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbartimor. Për vitin 2019, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 25 titujve ekzekutivë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

AMA, gjatë kësaj periudhe, përveç ndjekjes së proceseve të iniciuara gjatë vitit raportues, ka vijuar ndjekjen e proceseve gjyqësore të mbartura prej viteve të kaluara, të cilat, për shkak të ushtrimit të ankimeve apo rekurseve prej palëve ndërgjygjëse, janë në proces gjykimi në Gjykatat e Apelit apo Gjykatën e Lartë.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur:

Gjatë vitit 2019, në vijim të Rekomandimit nr. 43 dt.14/10/2019, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA ka kryer rishikim të Programit të Transparencës.

Në procedurën e rishikimit janë vlerësuar të gjitha problematikat e shfaqura prej miratimit dhe publikimit për herë të parë të programit të transparencës duke pasur në fokus se:

- Informacioni i bërë publik në faqen zyrtare tashmë është i ndërlidhur në programin model të transparencës;
- Informacioni për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit është i publikuar në faqe dhe i ndërlidhur në programin model të transparencës;
- Është publikuar çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
 - Janë publikuar, në një nënmenu të veçantë, vendimet e anëtarëve të AMA-s.

Bazuar në shkresën e ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale nr. 2897 prot., datë 30.07.2019 në lidhje me “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve për të drejtën e informimit”, si dhe bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili funksionon si një bazë shtetërore të dhënash sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 13.03.2018 është kryer sigurimi i instalimit të “Regjistrit elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve për të drejtën e informimit” bazuar në platformën PyetShtetin.al.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë bërë në përputhje e në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Kjo mënyrë vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti rrit transparencën nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit të sipërcituar.

11.3 Botime të autoritetit

a) Botimet me partneret

Instituti Politik i Studimeve Humane realizoi projektin “Pushteti i medias dhe media ndër pushtete”, ku zgjodhi të sjellë në gjuhën shqipe dy libra: “Culture, médias, pouvoirs aux États-Unis et en Europe occidentale, 1945-1991”, të autorëve Christian Delporte dhe Caroline Moine, botim i vitit 2017, si dhe “From Media Systems to Media Cultures: Understanding Socialist Television”, të autorëve Mihelj, S., dhe Huxtable, S, botim i vitit 2018. Dy librat janë kontribut për të pasuruar stendën e librarisë profesionale të komunitetit të gazetarëve, të studentëve të gazetarisë e komunikimit, apo studjuesve e kërkuësve të fushës, si dhe të interesuarve të tjerë. Ato ndihmojnë në nxitjen e debatit mbi zhvillimin dhe trendet e medias, karakterin e saj social, politik, kulturor etj., përshtatja në një kontekst kur teknologjia nuk ka të ndalur dhe përhapja e internetit zgjerohet dita ditës.

b) Buletini vjetor

Gjatë vitit 2019 AMA realizoi publikimin në hard copy dhe soft copy të Edicionit nr 5 të Buletinit Periodik me risinë e përfshirjes së treguesve jo 6 mujore por vjetore. Kalimi i procesit të mbledhjes, përpunimit dhe nxjerrjes së treguesve ekonomikë, teknologjikë, pronësorë, përmbajtësorë, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., nga një herë në 6 muaj në një herë në vit nuk ka qenë një zgjidhje thjesht kursimtare, por është përshtatje e kushtëzuar nga vetë natyra e funksionalitetit dhe madhësia e tregut audio/audioviziv shqiptar, masa e ndryshimeve të herëpashershme të parametrave të mësipërm. Buletini Periodik i AMA-s përbën një dosje faktike me shumë vlerë, për të kuptuar qartazi dinamikën në tregun audio/audioviziv të vendit tonë. Fakti që lënda e Buletinit në mënyrë sistematike është shfrytëzuar dhe po shfrytëzohet gjithnjë e më shumë si referencë në punime shkencore, kumtesa, vëzhgime, në tema diplome, detyra kursi e prezantime – këto tregojnë për dobishmërinë dhe qëndrueshmërinë e interesit për të dhënat përbërës.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave publikoi Buletinin nr. 5, që përmban ankesat e ardhura deri në muajin dhjetor 2018, ndërkohë që ka përfunduar hartimi dhe pritjet publikimi i Buletinit nr. 6, që reflekton të gjitha rastet e shqyrtuara për periudhën janar - qershor 2019. Në to janë publikuar shqyrtimet dhe masat përkatëse mbi ankesat e adresuara në AMA, kryesisht për cenim dinjiteti, shkelje të të drejtave të fëmijëve, reklamat e ndaluara etj. Mendojmë se ky Buletin, por edhe të tjerët, shërbejnë si udhërrëfyes për çdo OSHMA që mund të përballet në të ardhmen me raste të ngjashme.

Këshilli i Ankesave çmon se, publikimi i çdo ankese të trajtuar ka nxitur ndërgjegjësimin e OSHMA-ve në përmirësimin e standardeve mbi zbatimin e Kodit të Transmetimit, por dhe të individëve, agjencive, institucioneve dhe organizatave të ndryshme për të referuar në AMA shkelje të pretenduara të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

11.4 Bashkëpunimi me institucionet dhe partnerët

Prej vitit 2015 Autoriteti bashkëpunon me organizata dhe institucione të ndryshme që angazhohen në fushën e medias, duke mbështetur projekte që kanë në fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, studime dhe analiza të fenomeneve dhe trendeve të zhvillimit, përmirësimi i raportimit dhe trajtimit të temave në programet e transmetuara, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median etj.

- Qendra “New Policy Group” realizoi projektin “Shqip dhe Qartë: Hulumtim mbi Gjyhen informative të televizioneve”, që iu dedikua respektimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar nga redaksitë audiovizive. Qendra kreu një monitorim profesional të përmbajtjeve që transmetojnë dy televizione kombëtare dhe dy informative dhe mbi problematikat dhe gjetjet e rezultuara i përmbledhoi në një publikim, duke vënë atë në qendër të diskutimit me redaksitë audiovizive, jo vetëm në Tiranë, por dhe në Shkodër, Durrës, Korçë dhe Vlorë. Ky ishte një kontribut konkret për të vlerësuar situatën, por dhe pasuroi vlerësimet dhe ekspertizat që ka realizuar edhe vetë AMA në tri vitet e fundit, të cilat dhe i ka ndarë me OSHMA-të në shërbim të përmirësimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në transmetimet audiovizive.
- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim” u angazhua në kryerjen e projektit “Studim dhe analizë performance në tregun audioviziv shqiptar, bazuar në vlerësimet e ndjekësve të përmbajtjeve të transmetuara, për të eliminuar diskriminimin me bazë gjimore dhe dhunën e çdo forme ndaj grave e vajzave.” Qëllimi ishte që jo vetëm të kryej një vlerësim mbi nivelin e mbulimit të tematikës gjimore në programacionin audioviziv, por dhe rreth problematikave dhe gjetjeve të analizohen aspekte të shkeljes së barazisë gjimore në transmetime. Referuar këtyre, projekti ofroi dhe një paketë me rekomandime, se si mund të përshtatet/amendohet ligji nr 97/2013, i ndryshuar, me ligjin mbi barazinë ligjore.
- Gjatë vitit 2019, Këshilli i Ankesave ka organizuar tryeza tematike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga OSHMA-të dhe kontributin e partnerëve tanë që veprojnë në fushën e

medias. Gjithashtu, Këshilli i Ankesave mbështeti dhe ndoqi disa projekte të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, për tema të ndryshme si mbrojtja e fëmijëve, barazia gjinore dhe imazhi gjinor në ekran etj. Qëllimi i këtyre projekteve, të përmbyllura tashmë, ishte studimi i detajuar i situatës dhe rekomandimet për përmirësimin e saj. Këshilli i Ankesave i ka projektuar këto aktivitete si një platformë efektive për komunikim dhe shkëmbim informacioni mes institucioneve e organizatave të ndryshme, që fokus kryesor kanë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, e në veçanti interesin më të lartë të fëmijëve. Këto aktivitete dhe tryeza diskutimi, kryesisht me tema për fëmijët dhe mbrojtjen e tyre nga transmetimet e dëmshme audiovizive, për respektimin e normave ligjore dhe etike, kanë ndikuar në sensibilizimin jo vetëm të operatorëve audiovizivë, por edhe të publikut, institucioneve dhe organizatave të ndryshme për të shtuar vëmendjen ndaj problematikave në përmbytjet audiovizive.

- Gjatë vitit të kaluar, Këshilli i Ankesave monitoroi disa projekte të përbashkëta me organizata të shoqërisë civile, një prej të cilëve kishte si temë: *“Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve”*. Projekti është përmbyllur me sukses dhe në fund të tij pati disa rekomandime, thelbi i të cilave është ngritja e një instrumenti monitorues për të analizuar mesazhet që përcillen nëpërmjet artit muzikor (nëpërmjet teksteve apo klipeve të këngëve) të transmetuar në mediat audiovizive shqiptare, me qëllim identifikimin e problematikave që lidhen me çështjet e etikës dhe ndikimin në edukimin dhe botëkuptimin psikologjik/social/kulturor të adoleshentëve.
- Projektet e tjera, të përmbyllura gjithashtu, trajtuan tema mbi barazinë =gjinore dhe rolet gjinore në median audiovizive. Projektet, në përfundim të tyre, sollën studime për temat përkatëse, rekomandime dhe botime të ndryshme, të cilat janë publikuar në faqet zyrtare në internet të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa botimet si broshura do t’u shpërndahen operatorëve audiovizivë dhe grupeve të interesit.

Gjatë vitit 2019, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë disa iniciativa për të rritur bashkëpunimin mes institucioneve të tjera shtetërore. Duke konsideruar se bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes AMA-s dhe këtyre institucioneve do të përmirësojë standardet dhe kushtet për një treg audioviziv të lirë dhe efektiv në përputhje me standardet evropiane, AMA ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione:

- Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit)
- Inspektoriatin Shtetëror të Punës
- Avokatin e Popullit
- Memorandum bashkëpunimi me Agjencinë për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Malit të Zi (EKIP) për *“Mirëkuptim dhe Shkëmbim të Informacionit në fushat e Komunikimeve Elektronike dhe Mediave Audiovizive”*.
- **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit)**

Ka vijuar bashkëpunimi që prej nënshkrimit të marrëveshjes. Bashkëpunimi do të vijoj edhe në vitet në vijim për garantimin e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave audio dhe audiovizive, në rastin e praktikave të pa drejta tregëtare, në mbrojtje të interesave ekonomike të konsumatorit. Në vitet në vijim do të vijoj bashkëpunimi dhe korrespondenca mes dy institucioneve në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit (raste të cështjet e komunikimeve me natyrë tregtare, praktikat e padrejta të OSHMA-ve)

- **Inspektoriati shtetëror i punës dhe shërbimeve shoqërore**

AMA dhe ISHPSHSH do të bashkëpunojnë në zbatim të ligjit 97/2013 dhe ligjit 9634/2006 “Për inspektimin e punës”, në hartimin e akteve ligjore nënligjore, rregulloreve dhe udhëzuesve lidhur me mbrojtjen e punëmarrësev të punësuar në fushën e mediave audio dhe /ose audiovizive. Për vetë natyrën specifike të fushës audiovizive, rregullimi ligjor i marrëdhënies së punës të të punësuarve në transmetimet audiovizive, është i veçantë.

AMA angazhohet në:

- organizim takimesh/shkëmbim informacioni në lidhje me të dhëna për numrin e të punësuarve që oshma-të kanë deklaruar në AMA,
- sigurimin shoqëror dhe shëndetësor që oshma-të deklarojnë për stafin e punësuar.
- pjesëmarrje në takime dhe seminare të organizuara nga Inspektoriati mbi gjetjet dhe treguesit e këtij institucioni për punësimin në sektorin mediatik.

- **Avokatin e Popullit**

Marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e “Aleancës kundër urrejtjes”. Kjo marrëveshje ka për objekt të veprimtarisë së saj ngritjen e vetëdijes, informimin dhe kontributin në dialogun, veçanërisht midis të rinjve, për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes dhe krijimin e urave të dialogut dhe bashkëveprimit me shoqërinë civile dhe organet publike. Nëpërmjet kësaj aleance do të promovohet liria e shprehjes në shoqërinë demokratike duke lehtësuar një debat të hapur dhe sensibilizues për publikun për promovimin e lajmit në mënyrë korrekte dhe të drejtë.

- **Agjencinë për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Malit të Zi (EKIP)**

Memorandum bashkëpunimi për “Mirëkuptim dhe Shkëmbim të Informacionit në fushat e Komunikimeve Elektronike dhe Mediave Audiovizive”. Ky Memorandum do të kontribuojë në zhvillimin e mëtijshëm të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë dhe do të ofrojë mbështetje në lidhje me zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe medias audiovizive.

Gjatë vitit raportues janë bërë përpjekje të vazhdueshme për realizimin e një marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), qëllimi i të cilit është realizimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet palëve për forcimin e luftës kundër piraterisë në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë si dhe koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për parandalimin dhe/ose ndalimin e piraterisë audiovizive në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarive dhe funksioneve të të dy palëve.

- **Rreth bashkëpunimit AMA – KPM**

Autoritetet rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës kanë zhvilluar më 6 mars 2019 një takim pune mbi monitorimin dhe vlerësimin e programeve audiovizive. Takimi u realizua në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive në Tiranë, ku ishin prezentë përfaqësues nga njësitë e programacionit dhe monitorimit të dy autoriteteve rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës.

Përfaqësuesit e AMA-s dhe Komisionit të Pavarur të Medias, KPM, u fokusuan më shumë tek problematikat e përmbajtjeve të emetuara, si dhe procedimin e vlerësimit të tyre në përputhje me kuadrin legjislativ në fuqi. Kjo, duke u parë në funksion të garantimit të pluralitetit në transmetimet audiovizive, të shumëllojshmërisë dhe cilësisë së programeve që emetojnë televizionet, radiot, platformat digjitale, kabllorët etj. Takimi ishte konceptuar si një shkëmbim përvoja nga dy rregullatorët, në angazhimin e tyre për të respektuar standardet e transmetimeve në lidhje me mbrojtjen e të miturve, të evitimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit të çdo forme, për reklamat e komunikimet tregtare, për ndjekjen e të drejtave autoriale të prodhimeve audio dhe audiovizuale, nivelin e veprave evropiane etj.

AMA dhe KPM po shohin mundësinë e përmirësimit të aplikimeve dhe programeve kompjuterike në dobi të monitorimit sa më cilësor dhe publikimit sistematik të të dhënave nga përfomanca e tregut audioviziv. Këto pritet të jenë objekt për takime të tilla pune që do të vijnë të organizohen dhe në të ardhmen në Tiranë dhe Prishtinë, për shkëmbimin e eksperiencave dhe gjetjen e modeleve më efikase në monitorimin dhe vlerësimin e programeve audiovizive, si dhe nevojës për të ndërhyrë në përmirësimin e akteve nënligjore për këtë aspekt.

11.5 Menaxhimi i performances së burimeve njerëzore

Një nga objektivat e Planit Strategjik të Veprimit 2017-2019, të AMA-s, ka qenë zhvillimi i mëtejshëm i organizatës, duke pasur angazhim maksimal në realizimin dhe funksionimin e një organizate të shërbimit publik të zhdërvjellët, efikase, që evoluon vazhdimisht.

Në kuadër të përmirësimit të funksionit organizativ e institucional të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe objektivave të vendosura për vitin 2019, si dhe mbështetur në mundësitë e reja të trajnimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka ndërtuar një kalendar të qartë trajnimesh. Pranë ASPA-s, gjatë 2019 janë trajnuar 35 nëpunës civil në programe të ndryshme gjithëpërfshirëse apo të orientuara nga nevojat e institucionit.

AMA i ka kushtuar një rëndësi të madhe bashkëpunimit me ekspertë të organizatave të ndryshme ndërkombëtare në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve profesionale, teknike dhe administrative të stafit. Në këtë kontekst përmendim trajnimet e kryera në zbatim të projektit « Mbi mbështetjen e procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, për vendet në zhvillim » projekt i bashkëfinancuar nga Banka Botërore dhe Institucioni për shpërndarjen e njohurive të Qeverisë Koreane si dhe mbështetur nga Shoqata e Promovimit të Radios së Koresë në Seul, në datat 1-5 korrik u zhvillua trajnimi i parë, ndërsa në datat 25-29 shtator 2019, u zhvillua trajnimi i dytë mbi ngritjen e kapacitetetve njerëzore, të tre shteteve të përfshira në këtë projekt.

AMA gjithashtu u ka mundësuar studentëve, të cilët janë diplomuar apo janë në proces diplomimi, një praktikë mësimore, e cila ka për qëllim të sigurojë një këndvështrim praktik si dhe rritje profesionale të studentëve të cilët, falë formimit akademik dhe më pas njohjes me praktikën do të rrisin mundësitë për t'u punësuar më shpejt dhe për të qenë më të përgatitur për punën apo për interesat e tyre në punë kërkimore.

12 TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

Falë realizimit të të ardhurave të pritshme në masën 97%, arritën të mbulohen me fondet e veta, të institucionit, përveç shpenzimeve të parashikuara për kryerjen e detyrave funksionale të tij, shpenzime për vijim e fushatës së informimit të publikut sipas Strategjisë së Kalimit nga Transmetime Analoge në ato Numerike për mbylljen e tyre në qarqet Tiranë dhe Durrës, si dhe të akordohet ndihmë ekonomike në masën 5 milion lekë për dëmet e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve, ka qenë një ndër objektivat e realizuara të strategjisë së AMA-s dhe planit të saj të veprimit 3-vjeçar, gjatë vitit 2019.

Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 97/2013, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin agjentit tatimor;
- d) financime nga buxheti i shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin nr. 202, datë 24.12.2018, ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2019 për **“Të ardhura totale”** (Të ardhura korente të pritshme; Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar; Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar; Financim nga buxheti i shtetit (viti 2018); Financim i mundshëm nga buxheti i shtetit dhe **“Shpenzime totale”** (Paga, kontribute dhe shpërblime; Mallra dhe shërbime; Investime korente; Shpenzim për t’u mbuluar nga buxheti i shtetit; Shpenzim i mundshëm me fonde nga buxheti i shtetit për detyrim të lindur ndaj shoqërisë “Media +” sh.a.).

12.1 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2019

Ecuria e arkëtueshmërisë të burimeve të vetfinancimit për **“Të Ardhurat korente të periudhës”** dhe **“Të ardhura nga debitorët e vitit kaluar”**

000 lekë

Nr.	Emërtimi	Parashikimi i të ardhurave për vitin 2019	Detyrimeve financiare të lindura OSHMA-ve të licencuara/autorizuara në vitin 2019 (Faturime gjatë vitit 2019)	Hequr/shpallur të pavlefshme licenca/autorizime/sistemime faturash gjatë vitit 2019	Totali i të ardhurave të realizuara viti 2019	Realizimi në % (sipas projekt buxhetit)	Realizimi në % (sipas faktit)
		1	2	3	4	$5=4/(1-3)*100\%$	$5=4/(2-3)*100\%$
1	Të Ardhura nga Licenca/autorizim + pagesat per rinovimet	199.328	199.325	11.133	183.229	97	97
	a) Realizimi i pagesave nga subjektet televiziv privat vendor analog		11.452	169	10.567		
	b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombetare tokesore dhe satelitore		55.680	0	55.680		
	c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA per OTT, IPTV, Internet TV		46.896	556	44.506		
	d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonik privat vendor analog		18.771	120	17.175		
	e) Realizimi i pagesave nga subjektet të marrë autorizim nga AMA (kabllor)		66.526	10.289	55.301		
2	Te ardhura si agjent tatimor	739	897	8	881	121	99


	- Nga subjektet e licencuar/autorizuar - Nga subjektet hequr licenca/autorizimi		897	8	879		
3	Të ardhura nga perpunimi administrativ	1.950	3.233		2	166	100
4	Të ardhura nga interesat bankare	150			95	63	63
5	Te ardhura te tjera (leshim DVD, fotokopje materialesh, kthim pagash)	60			154	256	256
6	Të ardhura të tjera:	25.733		617	24.264	97	97
	-Nga kamatvonesat	5.328		617	10.340		
	-Nga gjobat	1.852		0	1.767		
	-Nga debitor e viteve të kaluara	16.553		0	10.733		
	-Të ardhura nga debitorët hequr licenca/autorizimi	2.000		0	1.424		
	Totali i të ardhurave	227.959	203.455	11.759	211.855,15	98	111

AMA në përmbushje të një prej objektivave të strategjisë dhe planit të tij të veprimit për vitet 2017-2019, pati rritje të arkëtueshmërisë së të ardhurave duke ndjekur kryerjen e pagesave të detyrime financiare të lindura në vitin 2019 të subjekteve të licencuara/autorizuara, përmes rrugës shkresore, postës elektronike dhe komunikimit telefonik. AMA gjatë vitit raportues ka investuar organet gjyqësore për vjeljen e detyrime financiare të lindura ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit nga subjektet hequr/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve gjatë viteve 2015-2019.

Burimi kryesor i vetfinancimit të AMA-s janë **“Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”**. AMA gjatë vitit 2019 ka vazhduar me trendin rritës të arkëtueshmërisë së burimeve të saj të financimit, ku zëri **“Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”**, për periudhën 2014-2019 paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Vitet	Të ardhura vjetore të pritshme	Të ardhura vjetore të realizuara	Realizimi në %
2014	102.413	61.526	60%
2015	140.278	111.769	80%
2016	160.610	140.242	87%
2017	166.773	156.661	94%
2018	190.052	177.352	93%
2019	188.192	183.229	95%



Nënzëri **“Të ardhura nga gjobat”** bazuar në pikën 13, të nenit 133, të ligjit nr. 97/2013, ku përcatohet se: *“..Gjoba është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbartimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s”*, u parashikuan të ardhura për AMA-n për vitin 2019 në masën 1,851,641 lekë (9,258,203 lekë x 20% = 1,851,641 lekë).

Në fund të vitit 2019, si rezultat i pagesave nga vetë subjektet apo si rezultat i kontratave të lidhura me përmbartues privatë gjyqësor, AMA arkëtoi 8,832,887 lekë, prej të cilave 1,776,577 lekë i përkasin të ardhurave të institucionit.

Ecuria e ekzekutimit të titujve ekzekutiv për sanksione me gjobë gjatë viteve 2014-2019 për arkëtimet e kryera dhe të ardhurat të cilat i takojnë institucionit, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Titujt ekzekutiv me sanksion gjobë/vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Arkëtimet në total (100%)	929	5.431	4.085	11.326	12.977	8.832
Të ardhura për AMA-n (20%)	186	1.086	817	2.265	2.595	1.766

12.2 Detyrimet financiare të OSHMA-ve

a. OSHMA të licencuara/autorizuara gjatë vitit 2019

Pasqyra përmblledhëse e OSHMA-ve të licencuara/autorizuara që rezultojnë me detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit deri në fund të vitit 2019, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Kategorizimi i subjekteve	Licencë/ autorizim	Tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive RTV	Kamatëvonesa	Totali
Televizione analogë	1.155	858	486	2.499

Rjetet numerike kombëtare tokësore dhe satelitore	1	1.608	1.202	2.811
Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT)	1.824	0	929	2.754
Radio analoge	1.548	210	715	2.473
Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor	2.207	0	1.823	4.030
Shuma totale	6.735	2.676	5.156	14.566

AMA, në zbatim të Vendimit nr.220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/ autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, për subjektet që nuk kanë likuiduar dhe subjektet që kanë likuiduar pagesat vjetore për licenca/autorizime pas tremujorit të parë të vitit 2019, ka përllogaritur kamatëvonesat përkatëse. Vlera e mbetur e kamatëvonesave të lindura gjatë vitit 2019, rezulton në masën 5,155,785 lekë në fund të vitit.

b. OSHMA me licenca/autorizime të hequra/konstatim pavlefshmërie, në vitet 2015-2019

AMA gjatë vitit 2019 ka marrë vendime për heqje/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve për 8 (tetë) OSHMA në masën totale 3,511,797 lekë, prej të cilave 5 subjekte të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, 2 (dy) subjekte të licencuar për televizion privat vendor dhe 1(një) subjekt i licencuar për audio privat vendor. Nga kjo shumë është mbyllur detyrimi në masën 1,021,720 lekë (masa e shlyer për 2 subjekte ish të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor).

AMA ka vijuar të investojë organet gjyqësore gjatë vitit 2019, për vjeljen e detyrimeve financiare subjekteve të cilave iu është hequr licenca/autorizimi apo iu është bërë konstatim pavlefshmërie e tyre, në vitet 2015 – 2019. Situata e detyrimeve financiare paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Kategorizi mi i subjekteve/ vitet	Televizione analoge		Ripërsëritës programi		Ofrues programi		Radio analoge	
	Nr. subjek	Masa detyrimit financiar	Nr. subjek	Masa detyrimit financiar	Nr. subjek	Masa detyrimit financiar	Nr. subjek	Masa detyrimit financiar
2015	-	-	5	10.405	-	-	-	-
2016	4	5.388	14	59.077	2	25.042	4	1.939

2017	3	415	7	2.754	1	162	3	1.105
2018	6	3.179	7	689	-	-	1	106
2019	2	199	3	2.186			1	105
TOTALI	112.752							

c. Ecuria e financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 nga AMA janë vendosur 26 sanksione me gjobë, si më poshtë:

- Me propozim të Drejtorisë së Mbikqyrjes, u vendosën 19 sanksione gjobë;
- Me propozim të Këshilli i Ankesave, u vendosën ka vendosur 5 sanksione me gjobë;
- Me propozim të Drejtorisë Juridike dhe Licencave, u vendos 1 sanksion me gjobë;
- Me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, u vendos 1 sanksion me gjobë.

Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, në vitin 2019, vetëm **1** subjekt i autorizuar, nuk depozitoi bilancin për vitin 2018, subjekt për të cilin AMA mori vendimin e sanksionimit me gjobë, të propozuar nga Drejtoria e Shërbime të Brendshme.

lekë

Celja në fillim të vitit 2019	310,779,178
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2019	35,030,000
+ Kamatë vonesa të lindura në vitin 2019	275,097
- Detyrime të shlyera nga vendime të denimeve me gjobë (vitet 2010 - 2019) dhe kamatëvonesat e lindura	8,832,887
- Vendime të denimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	29,500,000
Detyrimi në fund të vitit 2019	307,751,388

Masa e detyrimeve të lindura prej 26 sanksioneve me gjobë në vitin 2019 është në vlerën 35.030.000 lekë.

Masa e uljes në vlerën 29,500,000 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të AMA-s është ulur masa e detyrimit për 1 vendim të sanksionit me gjobë të vitit 2019;
- Me vendime të AMA-s të vitit 2019, janë shfuqizuar 8 vendime të sanksione me gjobë të vitit 2018 dhe 6 vendime të sanksione me gjobë të vitit 2019.
- 1 vendim të sanksionit me gjobë I vitit 2015 është shfuqizuar me vendim gjykatë.

12.3 Financime nga Buxheti i Shtetit

Në zbatim të vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe në vijim të projektbuxhetit për vitin 2019 të miratuar me vendimin nr. 202, datë 24.12.2018, AMA kërkoi fonde në rrugë shkresore edhe nga Buxheti i Shtetit për financimin e detyrimit të lindur ndaj shoqërisë “Media+” sh.a. (Tv Shijak) në masën e mbetur në masën **36,547,871 lekë**, në zbatim të vendimit nr. 2819, datë 22.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Buxheti i Shtetit nuk akordoi fonde gjatë vitit 2019, për mbylljen e këtij detyrimi.

Gjatë vitit 2019, Buxheti i Shtetit nuk akordoi fonde për AMA-n për vijimin e fushatës së informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve analoge.

Me fondin e akorduar me Aktin Normativ nr. 1, datë 26.07.2018, si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.17297/1 prot., datë 24.10.2018 dhe shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.12202/3 prot., datë 25.10.2018, u akordua fondi 40,000,000 lekë për vazhdimin e fushatës së informimit të publikut për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës dhe vijimin e tij në qarqet e tjera. Me fondin e akorduar u zhvillua fushatë e informimit të publikut për periudhën 17 dhjetor - 17 mars 2019 (3 muaj).

12.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2019

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projektbuxhetin për vitin 2019, në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, të ndryshuar, si dhe fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit.

Shpenzimet dhe investimet të mbuluara me vetfinancim:

000 lekë

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve/Investimeve	Plani	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2019	Fakti	% e realizimit
		1	2	3	=3/(1+2)*100
I	Shpenzime korente (a+b)	215.271	5.002	187.746	85
	<i>a) Paga, kontribute për sig shoq dhe shënd, shpërblime</i>	84.129	4.661	80.325	
	<i>b) Shpenzime për mallra dhe shërbime</i>	131.142	341	107.421	
II	Shpenzime për investime (a+b+c)				
	<i>a) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara</i>	31.892	- 9.270	17.012	75

- Studime, kërkim, anketim, programe/aplikacione	31.892	- 9.270	17.012	
b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	26.554	4.254	22.424	73
- Blerje pajisje elektronike (Server, kompjutera, printera, fotokopje)	3.077	- 120	1.460	
- Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike, automjete	11.917	4.374	9.917	
- Sistemi i qendëruar i monitorimit dhe regjistrimit të shfrytëzimit të spektrit audio FM	10.000		9.552	
- Sistemi 8 kamerash IP me NVR dhe sistem telefonik i brendshëm	1.560		1.495	
c) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme	240	-	28	12
- Projekte	120			
- FV. Derë midis zyrës së Drejtorit të DPFTIK dhe stafit DPFTIK	120		28	

Referuar tabelës së mësipërme kemi:

1. Me fondet e veta AMA realizoi:

- shpenzimet për paga e shpërblyes, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas strukturës organizative, si dhe shpenzimet e nevojshme për mallra dhe shërbime të kërkuara nga drejtoritë/njësitë e saj.

- Bazuar në projektbuxhetin për vitin 2019 të miratuar me vendimin nr. 202, datë 24.12.2018, AMA lidhi aktmarrëveshjen nr. 416/2 prot., datë 25.01.2019 me shoqërinë “Media +” sh.a., për të parandaluar bllokimin e llogarive bankare të institucionit nga shoqëria përmbarimore dhe ekzekutimin e menjëhershëm të detyrimit. Me këtë aktmarrëveshje, me afat deri më 01.01.2020, AMA uli masën e detyrimit me 25,805,236 lekë (25.000.000 lekë të likuiduara nga të ardhurat e AMA-s dhe kompesimin reciprok prej 805,236 lekë për detyrimin vjetor për licencë dhe tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të vitit 2019). Në fund të vitit 2019, detyrimi i AMA-s ndaj shoqërisë “Media +” sh.a. është në masën 36,496,405 lekë.

Me vendimin e AMA-s, nr. 182, datë 28.12.2019 “Mbi një ndryshim në vendimin e AMA-s nr. 202, datë 24.12.2018, “Për miratimin projektbuxhetin të vitit 2019”, të ndryshuar, për një akordim ndihme për dëmet e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” u akordua nga AMA ndihma në masën 5,000,000 lekë.

AMA realizoi në vitin 2019, event për 20 vjetorin e krijimit të AMA-s. Gjithashtu AMA ka kryer në vitin 2019 shpenzime sponsorizimi për veprimtari sociale e publike (ekologjike).

12.5 Ecuria e Investimeve:

Në zërin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara” (pjesë e Investime korente), u realizuan:

- Zëri “Studime dhe kërkime” i parashikuar në masën 23,500,000, i ndyshuar në masën 18,282,000 lekë, u realizuan financime për disa projekte në fushën mediatike.

- Me kërkesë të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u realizua blerje për liçencë “Smart processe Site Licence” për Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.

Në zërin “*Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*” u realizuan shpenzime për:

- “Blerje pajisje elektronike/kompjuterike”,
- “Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike”, konkretisht për Sistem për monitorimin e subjekteve numerikë”, levizorë DVB-T2 43”, dekodera DVB T2, HDD të jashtme për regjistrime analoge, HDD të jashtme për DVR, kufje profesionale për monitorim dhe kronometra, telefon, makina për grirjen e shkresave, blerje serviseshe (pjata, filxhanë, lugë, pirunj), shkallë, tabela sinjalistike për ambientet e koridoreve të AMA-s, mobilje zyre, rafta metalikë, perde për ambientet e AMA-s, vegla pune për punëtorin e mirëmbajtjes, antena UHF dhe antenë VHF+UHF, kondicioner 12 BTU.
- Blerje 2 automjete tip 1/2 fuoristrade.

Në zërin “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme*” u realizuan shpenzime për FV derë midis zyrës së Drejtorit të DPFTIK dhe stafit DPFTIK.

Zëri “Analizator Spektri” nuk u realizua brenda vitit 2019, pasi procedura e prokurimit ishte në shqyrtim në Komisionin e Prokurimit Publik.

12.6 Pasqyrat financiare

<i>Pasqyra të ardhura dhe shpenzime në datë 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019</i>			
<i>lekë</i>			
Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2018
A	Të Ardhurat korente të periudhës	211.169.731	218.439.969
1	Të Ardhura nga Licenca/autorizim	192.235.625	195.389.004
2	Të ardhura si agjent tatimor	893.933	925.224
4	Të ardhura nga përpunimi administrativ	3.243.700	3.840.000
5	Të ardhura nga interesat bankare	99.870	161.020
6	Të ardhura të tjera nga gjolat, kamatëvonesa për licenca/autorizime/gjola	11.069.447	18.124.721
7	Rimarrje shumash të njohura si shpenzim në vitet e kaluara	3.627.156	-
B	Shpenzime Operative	108.510.431	96.609.777
1	Materiale zyre kancelari	2.829.080	3.966.390
2	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	86.261.767	81.070.733
3	Shpenzime mirëmbajtje të godinës	1.159.408	518.764
4	Shpenzime për shërbime furnizuese	15.138.416	6.129.449
5	Shpenzime transporti dhe mirëmbajtje të makinave	3.105.760	3.763.047
6	Taksa Vendore	15.000	15.000
7	Shpenzime gjyq, legale	1.000	1.146.394
C	Shpenzime të Veprimtarisë funksionale të AMA-s	49.800.952	7.900.686
1	Konsulenca, trajnime, studime tregu	822.008	1.946.999
2	Shpenzime përfaqësimi	8.730.608	5.953.687

3	Shpenzime për digjitalizimin	40.248.336	-
D	Shpenzime nga Fond i akorduar nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut	39.950.997	119.959.801
E	Shpenzime për akordimin e ndihmës për dëmet e tërmetit të datës 26 nëntor 2019	5.000.000	
F	Humbje të vitit	4.252.212	5.765.168
	Shfuqizim gjobash	3.860.000	2.784.000
	Heqje licence/autorizimi, sistemime	392.212	2.981.168
G	Amortizime dhe zhvlerësime të aktiveve të trupëzuara	-917.907	-1.819.663
H	Transferta nga/për organizatat e huaja/buxheti shtetit	-	120.000.000
Rezultati ekonomik (A-B-C-D-E-F-G+H)		4.573.046	110.024.200

Pasqyra e aktivitetit dhe pasivit për vitet 2018 - 2019

lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2018
A.	Aktivet Afatshkurtëra (I - IV)	614.067.805	561.685.013
I.	Gjendje Inventari imët	5.104.625	4.186.718
II.	Kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve (1 - 4)	438.522.979	450.116.978
1	-Klientë për licencë (Klientë të arkëtueshëm)	118.772.468 11.504.089	121.138.198 15.848.447
	(Klientë hequr licenca)	107.268.379	105.289.751
2	-Klientë për tarifën shërbime RTV (Klientë të arkëtueshëm)	9.227.917 3.744.043	8.976.192 3.546.151
	(Klientë hequr licenca)	5.483.874	5.430.041
3	-Klientë për gjoba	285.098.916	287.935.081
4	-Klientë për kamatë vonesa (Klientë për kamatvonesa për autorizime/licenca)	25.423.678 2.771.206	32.067.507 9.223.410
	(Klientë për kamatvonesa për gjoba)	22.652.472	22.844.097
III.	Të tjera kërkesa ndaj të tretëve	6.213.452	2.994.408
	- Detyrim për kthim shumash nga ish punonjës	3.525.156	-
	-Diferenca nga shteti për tatime dhe taksa	6.283	6.283
	-Parapagime ndaj të tretëve, gjoba personale etj	2.682.013	2.988.125
IV.	Arka dhe Banka	164.226.749	104.386.909
B.	Aktivet Afatgjata (I - II)	172.633.146	158.828.847
I.	Studime dhe kërkime neto	30.649.264	18.621.365
II.	Aktive të qëndrueshme neto	141.983.882	140.207.482
	- Inventar ekonomik	11.433.880	14.803.107
	- Instalime teknike, pajisje, vegla pune	29.596.202	23.973.869
	- Mjete transporti	8.604.282	4.118.636

	- Shpenzime per ndertesa administrative	92.349.518	97.311.870
C.	Pasivet (I-IV)	786.700.952	720.513.769
I.	Fondet e veta	222.179.641	137.820.934
II.	Transferta nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut për Digjitalizimin	105.000.000	105.000.000
III.	Rezultati ushtrimor i vitit	4.573.046	110.024.200
IV.	Detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve (1 - 6)	454.948.265	367.668.635
1	-Personeli, deficite dhe gjoba	-	425.000
2	-Detyrime mbi klientë për shtetin, për tatime, gjoba dhe kamatëvonesa	303.851.043	302.720.224
3	-Detyrime ndaj Furnitorëve	408.134	698.712
4	-Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe kontribute	848.080	1.292.308
5	-Kreditorë të viteve të mëparshme (procese gjyqësore me përmbarues)	149.841.008	62.532.391
AKTIVE - PASIVE ((A+B)-C)		-	-

13 ANEKSE

ÇESHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË				
Nr.	Paditës/I paditur	Objekti	Faza gjyqësore në të cilën ndodhet procesi	Fituar/Humbur në fazën aktuale
1	Subjekti privat Sevi Mediu, për subjektin “TV Kabllor Anfab”	- Anulimin e vendimit nr. 7, datë 17.04.2019 të Grupit të Inspektimit të AMA për dënimin me gjobë në shumën 1.000.000 lekë. - Anulimin e vendimit nr. 8, datë 19.04.2019 të Grupit të Inspektimit të AMA për dënimin me gjobë në shumën 1.000.000 lekë.	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
2.	Subjekti privat Gerantina Zylo	- Shfuqizimin e vendimit nr. 156, datë 11.10.2019 të AMA-s “Për shqyrtimin e ankimit administrativ kundër vendimit nr. 14, datë 10.05.2019 për ofrimin e shërbimit të programeve audiovizive mbështetur në internet (IPTV/OTT) pa autorizim” si të pambështetur në ligj dhe në prova.	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
3	Subjekti privat Albi Kreci, për subjektin “TV Kabllor Alb Vito Peqin”	Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendim nr. 157, datë 11.10.2019, , i cili ka lënë në fuqi Vendimin nr. 16, datë 07.08.2019	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
4	Shoqëria “Beqaj Kabllor 2014” sh.p.k., për	Shfuqizimi i akteve administrative të dala nga autoriteti AMA:	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim

	subjektin “TV Kabllor Beqaj”	-Procesverbal për inspektimin e veprimtarisë audiovizive, datë 28.09.2019; -Vendimin AMA-s nr. 19, datë 15.10.2019 për dënimin me gjobë.		
5	Subjekti privat Altin Sharka, për subjektin “TV Kabllor Hysgjokaj”	Shfuqizimi tërësisht i vendimit nr. 114, datë 11.07.2019 dhe vendimit nr. 4, datë 15.04.2019 të Autoritetit të Mediave Audiovizive	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
6	Subjekti privat Altin Sharka, për subjektin “TV Kabllor Hysgjokaj”	Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s në shumën prej 2,118,040 lekë	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
7	Shoqëria “Teknomedia” sh.p.k., për subjektin “Nesër TV”	Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s, në shumën prej 1,825,600 lekë	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pezulluar (deri në përfundim të themelit)
8	Shoqëria “Ora” sh.a.	Konstatim pavlefshmërie absolute e vendimit të revokimit të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016. Detyrimin e AMA-s për të shfuqizuar vendimin e revokimit nr. 286, datë 29.12.2016	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pezulluar gjykimi (deri në përfundim të themelit)
9	Shoqëria “Alba_Tra_Net Scu” sh.p.k.	Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s në shumën prej 1,000,000 lekë	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër	Në gjykim
10	Shoqëria “Fokus TV” sh.p.k., për subjektin “TV Fokus”	Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s në shumën prej 250,250 lekë	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Në gjykim
ÇËSHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATËN E APELIT				

1	Shoqëria “G NET” sh.p.k.	Shfuqizimin e vendimit nr. 83, datë 16.5.2019 I Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe të vendimit nr. 2 datë 11.04.2019	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga AMA	Humbur
2	Subjekti privat Gëzim Cake, për subjektin “TV Kabllor Zargoçan”	Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 10, datë 25.04.2019 dhe të aktit administrativ, vendimit nr. 115, datë 11.07.2019 të Autoritetit të Mediave Audiovizive	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
3	Subjekti privat Elion Boriçi, për subjektin “TV Kabllor Brado”	1.Shfuqizimin e aktit administrativ Vendimi Nr. 3 datë 12.04.2019 të aktit administrativ Vendimi Nr. 95 datë 07.06.2019 të Autoritetit të Mediave Audiovizive	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
4	Shoqëria “DEVI-E.R.I.” sh.p.k., për subjektin “TV Kabllor Devi-Eri”	Deklarim i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, vendimit Gjobë nr. 47, datë 18.11.2015 për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit Nr. 2233/3/2 Akti Dt. 20.06.2018 nga Gjykata Adm. e Shk. I Tiranë, për shkak se detyrimi është shuar.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
5	Subjekti privat Sevi Mediu, për subjektin “TV Kabllor Anfab”	Anulimin e Vendimit nr. 16, datë 08.06.2018, të AMA për dënimin me gjobë të subjektit person fizik Audioviziv (OSHMA) “TV Kabllor Anfab”, në shumën 1.000.000 lekë.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga AMA	Humbur
6	Subjekti privat Ismail Buçpapaj,	Kundërshtimin dhe shpalljen e pavlefshëm të vendimit datë	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar

	për subjektin “TV Bajram Curri”	31.01.2019 “Për ushtrimin e veprimtarisë së transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe proces verbaleve “Për inspektimin e veprimtarisë audiovizive të datës 31.01.2019 të lëshuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, grupi i inspektimit kundrejt personit fizik Ismail Buçpapaj.		
7	Subjekti privat Guri Meko, për subjektin “TV Kabllor Delta”	Konstatim i parashkrimit të sanksioneve gjobë nr. 303 dt. 16.12.2010, lënë në fuqi me vendimin nr. 26 datë 20.01.2011 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), gjoba nr. 449, dt. 29.02.2012 dhe gjoba nr. 479, dt. 19.07.2012 lënë në fuqi me vendimin nr. 119, datë 31.08.2012 të Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit për shkak se janë parashkruar.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga AMA	Humbur
8	Subjekti privat Guri Meko, për subjektin “TV Kabllor Aral”	Shfuqizimin e Vendimit nr. 181, datë 05.11.2018, të AMA si vendim i marre ne kushtet e shkeljes se ligjit.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
9	Ermal Marinaj, i paautorizuar	Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, Vendim nr. 22, datë 06.07.2018 i grupit të inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Vendimin Nr. Rregj. Them	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar

		1860-31134-06219-80 Akti, datë 23.10.2018 ka vendosur “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”.		
10	Subjekti privat Dritan Memushi, për subjektin “TV Kabllor Tepelena Sat”	Anulimi i Vendimit përfundimtar nr. 186 të datës 05.11.2018, për subjektin OSHMA “TV Kabllor Tepelena”, i cili ka lënë në fuqi pjesërisht Vendimin nr. 20 të datës 03.07.2018 të grupit të inspektorëve të AMA-s	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
11	Shoqëria “AVN” sh.p.k.	Shfuqizimin tërësisht të Vendimit Nr. 169, datë 12.09.2018 të AMA-s.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
12	Shoqëria “Tring” sh.a.	Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe anulimin e Shkresës Urdhër “Për vënien e sekuestros” Nr. 215/2 prot., Nr. 215 Regj., datë 26.11.2018, të Shoqërisë Përmbarimore “Tirana Execution Office” (TEO) sh.p.k.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga AMA	Humbur
13	Shoqëria “New Media Vizion” sh.p.k.	Shfuqizimi i vendimit nr. 160, dt 12.09.2018 për rrezimin e kërkeses për zgjerimin e zones së licencimit të “Radio 1”.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga AMA	Humbur
14	Subjekti privat Spiro Zguri, për subjektin “TV Magic Channel”	Pavlefshmëri tituli, për vendimin nr. 104, datë 12.07.2017 të AMA-s, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare.	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
15	Lartment Mato, i paautorizuar	Shfuqizim i vendimit nr. 10 për dënimin me gjobë në	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar

		masën 5,000,000 lekë, datë 29.05.2018		
16	Shoqëria “Fokus TV” sh.p.k.	Kundërshtimi i veprimeve përmbareme: -Gjoha nr. 509, datë 23.10.2012 të vendosur nga Grupi i Inspektimit të AMA-s (ish-KKRT) -Gjoha nr. 13, datë 22.05.2015 të vendosur nga Grupi i Inspektimit të AMA-s (ish-KKRT)	Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ushtruar ankim nga pala paditëse	Fituar
